

85H-32

98



**ROJET  
E  
FORTESES**

NEVRUZ TURHANI

SH-32

T 98

NEVRUS TURHANI

S

R

# ROJET E FORTESËS

(Përshkrime, reportazhe nga jeta e ushtrisë)

~~1975~~

ALBERTA E SHIETI  
GJYKIMET

31322

1969



## RRITJA

Ne ecnim pa e ndjerë rrugën. Komisari fliste për njerëzit. Për njerëzit që e çojnë përpara, e thellojnë revolucionin. Ai, për të qenë sa më i saktë në mendimet e shprehura, për t'u dhënë, si të thuash, jetë atyre, mori si shembull kolektivin e një nën-reparti, ushtarët që e përbëjnë atë.

— Ata po ngrihen, po rriten, rritet ndërgjegja e tyre, sepse brenda atij kolektivi zjen revolucioni ideologjik, revolucioni që çrrënjos çdo gjë të huaj e i hap rrugë së resë. Dhe kjo përbën forcën, madhështinë, bukurinë e atyre njerëzve të rinj. Ju duhet të njiheni me ata ushtarë, para së gjithash me luftën e tyre për t'u kalitur si revolucionarë, për t'u pajisur me ndërgjegjen revolucionare të klasës...

Pas pak u ndamë. Unë me Namikun u futëm në një klasë përballë fjetores. Aty ishin pjesëtarët e atij kolektivi të vogël, për të cilët foli komisari. Namiku u dha lajmin se do të përfaqësonin njësinë në garat që do të organizonte komanda eprorë dhe shkoi në stërvitje. Unë qëndrova gjatë me ta.

## 1. PORTRETI

Ata ishin ulur dhe secili merrej me diçka. Ademi vizatonte portretin e Ahmetit, që lexonte dhe nxirrte shënime nga libri «Shoku Enver Hoxha për rininë». Sotiraqi po i kthente përgjigje një shoku nga Korça; Domeniku përgatitej për stërvitjen e nesërme, kurse Xhezmiu lexonte dhe nënvizonte pjesë nga fjalimi i shokut Mehmet Shehu mbajtur në aktivin kombëtar për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë. Mbeteshin dhe pak minuta nga koha e lirë. Ademi pyeti:

— Dhe tani më thoni, shokë, ç'vërejtje kini për «Ahmetin»?

— E mbarove?

Të gjithë u grumbulluan te tryeza e Ademit dhe po shikonin në heshtje portretin e shokut. Një fytyrë pak e hequr, me sy të përqëndruar në librin që mbante në dorë, — ja ç'mund të thuhej me pak fjalë për atë portret. Dhe shokët këto i thanë, por Ademi nuk u kënaq:

— Në qoftë se në këtë portret ju dalloni vetëm këto, kjo do të thotë se s'ja kam arritur qëllimit. Unë dua që ai të jetë Ahmeti.

— Sa i çuditshëm që bëhesh dhe ti, Adem. Portreti është portret dhe pikë.

— Atë them dhe unë. Portreti duhet të flasë, të jetë shprehës i ndjenjave, mendimeve.

— Pse, pak shprehës janë sytë e Ahmetit? Ai duket sikur po i përpin rreshtat e atij libri që mban në dorë, — tha me zjarr Domeniku.

— Po ju, shoku Ahmet, ç'mund të thoni për veten tuaj? — e pyeti Sotiraqi.



— Për veten time?! Do të ishte mirë që Ademi të mos e kishte bërë këtë portret.

— S'të pëlqen? — pyeti Ademi pak i fyer dhe i shqetësuar, se ndoshta duhej pyetur para se t'i futej kësaj pune.

— Do të më pëlqente më tepër portreti i kolektivit tonë. A mund ta bësh këtë? Secili nga ne kalitet në kudhrën e kolektivit, dhe është pjesë e këtij kolektivi, pra vendi i parë i takon këtij.

— Sidoqoftë portretin e secilit do ta ruaj. M'i kanë kërkuar — foli pasi u mendua Ademi.

— Kush?

— Është një i gazetës. Interesohet për kolektivin tonë, ndoshta dhe do të shkruajë.

Në qetësinë që u vendos pas këtyre fjalëve, sinjali për t'u rreshtuar u dëgjua më qartë.

\* \* \*

Në krye të disa ditëve mbaja në dorë portretet e tyre dhe një blok me shënime. I shikoja fytyrat e atyre ushtarëve, lexoja gjithshka që kisha mundur të shënoja nga ato që më treguan ata dhe shokë të tjerë dhe mundohesha të vizatoja me fjalë portretin e madh të një kolektivi të vogël.

## 2. ISHTE NJË DITË E FTOHTË

Nuk e harrojnë atë ditë. Ajo ka hyrë në jetën e tyre si një kujtim i bukur. Ishte, pra, një ditë e ftohtë janari. Dëborë kishte mbuluar gjithshka. Acari të priste. Sotiraqi dhe Xhezmiu qëndronin në klasë. Bënte shumë ftohët, dhe ata herë pas here lëviznin këmbët në çimento dhe fërkonin duart që të nxeheshin. Flisnin në të rrallë. Kur vështrimet e tyre kryqëzoheshin, buzëqeshnin:



— Pa, pa ç'dimër!

— I tmerrshëm! Në Korçë bie vërtet dëborë, po sikur s'bën kaq ftohtë...

Ata s'kishin shumë që ishin njohur. «Duket i urtë» — thoshte Sotiraqi për shokun. Ndërsa Xhezmiu kishte arritur në këtë përfundim: «Është i mbyllur. I ka fjalët të numëruara». Dhe, si për të vërtetuar këtë mendim, pasi i rrahu edhe një herë thembrat në çimento, tha:

— Ata po vonohen.

Tjetri mblodhi supet. Xhezmiut nuk i erdhi mirë. «Ndoshta s'më përfill, — mendoj. Harron që do jemi shokë, kemi një jetë të tërë përpara». Përsëri foli:

— Mësues ke qenë?

— Po.

— E ke universitetin?

— Jo, dyvjeçarin.

— Sidoqoftë... ty të kemi me arësim të lartë. Bukur fort.

Sotiraqi, që deri në atë kohë përgjigjej pa e kthyer kokën, u tërhoq nga dritarja dhe ju afrua më pranë Xhezmiut. I hodhi dorën në sup.

— Po ju, me ç'punë jini marrë, Xhezmi?

— Kam qenë teknik në naftë.

— Edhe ai shkodrani, ai djali i gjatë, në mos gabohem, ka qenë mekanik. Edhe shoku që presim sot, Ahmeti, me sa më zuri veshi, po ashtu, mekanik. Ademi, eh, ç'djalë që është, më duket se është piktor. Kështu më vjen se tha mbrëmë. Tani folë, shok i dashur, ç'rëndësi ka që unë kam kryer dyvjeçarin? Mua më gëzon ajo, që do jemi shokë

me tre teknikë, me tre punëtorë. Unë do të kem ç'të mësoj nga ju.

— Edhe ne nga ti.

— Po, po, ashtu është, reciprokisht. Sidoqoftë, unë jam i gëzuar që më hodhën në këtë nënrepart. Me sa kuptoj, kolektivin do ta kemi të mirë.

— Ajo varet nga ne, ne mund ta forcojmë, ne...

— Varet edhe nga shokët më të vjetër, — shtoi Sotiraqi.

— Unë nuk e ndaj kolektivin më dysh. Kam parasysh si ata, si ne të dy.

— Megjithatë, ata duhet të na ndihmojnë.

— Kështu them dhe unë.

Në çast të dy heshtën dhe shikuan nga dritarja. Disa ushtarë ecnin me vrap.

— Dalim dhe ne? — foli Sotiraqi.

— Domeniku tha që të presim këtu.

— Mirë, ashtu bëjmë...

Xhezmiu desh të thoshte edhe diçka, po s'arriti. Dera u çel me rrëmbim dhe u dha Domeniku me Ademin. Nga të nxituarit ata mezi merrnin frymë, pothuaj gulçonin. Folën në një gojë:

— Po vjen Ahmeti. Të dalim ta presim së bashku... Si thoni? E si të mos dilte Sotiraqi me Xhezmiun, kur ndaj edhe po prisnin në klasë, kur për Ahmetin kishin dëgjuar të flitej para se ta njihnin, kur edhe ai ishte një shok i tyre, pjesëtar i kolektivit, që do të ecnin, do të rriteshin, do të kaliteshin, do të ndanin gëzimet e hidhërimet së bashku?

— Fjalë është kjo, — tha Xhezmiu.

Dolën të katër. Dëborë u rrahu fytyrat, Soti-



raqi me Xhezmiun i harruan këmbët dhe duart që u mbërdhinin. Ata sikur i përshkonte tani një afsh i nxehtë. Ky ishte ai afsh, ajo ngrohtësia që të ngjallin shokët, dashuria, kujdesi i tyre.

Rrugës takuan dhe të tjerë. U bënë shumë. Katërshja u nda më dysh, pastaj më trish. Domeniku eci më përpara. Ademi shkoi te çesmja për të pas-truar këpucët. Sotiraqi me Xhezmiun, pranë njëri-tjetrit, arritën te vendi dhe nuk pritën shumë. Maqina erdhi. Ajo ndaloi disa metra më tej. Zëri i Domenikut tingëlloi i fortë:

— Ahmet, ç'u bane? Eh, eh...

Ashtu të veshur me peliçe, me ato kokore të rrasura deri te veshët, duke mbajtur në duar puschkët e çantat e shpinës, ushtarët e porsaardhur filluan të zbrisnin. Sa u ciknin këmbët në tokë, hidheshin në krahët e shokëve. Sotiraqi me Xhezmiun edhe pse u afruan, s'po e dallonin dot kush ishte Ahmeti. Edhe Domeniku me Ademin u shpëtuan nga sytë.

— Cili do jetë?

Sotiraqi mblodhi supet. Ndërsa me vete mendonte: «Sa e duan njëri-tjetrin këta shokët e vjetër. Po unë, a do të mund ta justifikoj shoqërinë e tyre, të bëhem si ata?.. «Eci përpara. Xhezmiu e ndoqi pas, duke shikuar gjithmonë në drejtim të maqinës. Kur ja, një ushtar, me atë kokore që i rrinte pak si e madhe, po përqafohej me Domenikun dhe Ademin.

— Ja cili qenka, Sotiraq, të shkojmë dhe ne — foli Xhezmiu.

Ju afruan Ahmetit, si t'i afroheshin një të njohuri të vjetër. U përqafuan, ashtu siç dinë të



rroken ushtarët, kur takojnë shokun e pozicionit, edhe pse mund të dinë pak ose hiç fare për njëri-tjetrin. Mjafton që të jenë ushtarë.

Në klasën e mbushur plot, atë mbrëmje janari që dëborë s'pushoi së rëni asnjë çast dhe të ftohtët ishte i madh, ata njohën Ahmetin dhe Ahmeti ata...

### 3. U PREKE?

Kaluan ditë. Kolektivi po hidhte hapat e para. Ata, ushtarët, po e njihnin më mirë njëri-tjetrin në punë, në jetë.

Atë pasdite, Sotiraqi, pasi la shërbimin u fut në klasë duke menduar se s'do të gjente njeri brenda. U habit kur pa aty Ahmetin dhe Domenikun. Ata s'kishin dalë në qytet.

— Ju shqetësoj gjë? — foli Sotiraqi kur pa se shokët diç bisedonin me njëri-tjetrin.

— Ç'ka po thue kështu? A të kena shok?.. Atëhere, pra, mos fol si njeri i huej, — u përgjigj Domeniku dhe u kthye nga Ahmeti. Sotiraqi zuri vend dhe nisi të lexojë një libër që e kishte sjellë Ahmeti nga biblioteka e qytetit. Dy të tjerët vazhduan bisedën.

— Më duket se edhe herë tjetër je rrëmbyer — i thoshte Ahmeti, mund t'i flisje më ndryshe, më i qetë. Edhe ashtu do të të kuptonte.

— Ishte hera e dytë që e përsëriste një veprim të tillë.

— E pastaj? Qoftë edhe se e përsëriti. Ti s'ke të drejtë të flasësh ashtu. Rreptësia (dhe duhet

të jesh i rreptë, se të kanë caktuar komandant) nuk tregohet me të bërtitur. Të kujtohet, vjet, kur ishim dhe ne të rinj si këta? Sa përshtypje të keqe na bënte sjellja e ndonjë shoku të vjetër, sjellje prej kapadaiu, mendjemadhi, mospërfillësi. «Ju jini të rinj, ku dini ju», ose «ngrihuni e bëni gjimnastikë, të forcoheni, se ne...» I mban mend këto shprehje? ...Ne s'i honëshim dot ato. Bile, po të të kujtohet, një mbrëmje më pate thënë: «Kur ne të jemi të vjetër, e të vijnë shokët e rinj, do të mbajmë një qëndrim tjetër, s'do të hiqemi sikur dimë gjithshka». Kështu është, Domenik? Dhe ja, ku erdhi ajo kohë. Ne duhet t'i trajtojmë me ngrohtësi, bile edhe të mësojmë prej tyre.

— Si shumë je tue e zgjatë këtë histori, — tha Domeniku me një ton mërzitjeje.

— Pse diskutojmë s'është keq.

— Ndoshta do të ishte ma mirë t'i binim shkurt.

— U preke?!

— Jo, po s'bana ndonjë gja të madhe.

— Sidoqoftë ne bëjmë mirë që po e diskutojmë këtë çështje, ndoshta do bënim akoma më mirë sikur të ishin gjithë shokët.

— Fundja...

Kishte ndodhur kështu: Domeniku ishte nevrikosur pak me Sotiraqin atë ditë. Dhe me të drejtë. Urdhëri ishte i prerë dhe i qartë: në gjimnastikë të dilnin pa këmishë. Po ai ç'bëri, si e zbatoi këtë urdhër? Këmishën e mbështolli rreth belit. Sa doli përjashta, meqë ndjeu shumë të ftohët, pa i marrë leje asnjëriu, e veshi. Kur ndeshi në vështrimin e Domenikut, sikur dëgjoi fjalët e tij: «Po shokët s'janë tue mbërdhi? Keq, shoku Sotiraq!» Vendosi



që të nesërmen të mos e përsëriste më atë që bëri. Por... Përsëri bënte ftohët, bile frynte edhe erë. «Po e marr», tha dhe e rrotulloi këmishën rreth belit. Kur u rreshtuan, ju duk sikur u mpi. Të ftohtët sikur po i futej në zemër. Nisën vrapin. Era sikur e shponte. S'e zgjati. E veshi. Domeniku këtë herë s'u mjaftua vetëm me një vështrim.

— «Ushtar Sotiraqi, dilni nga rreshti dhe shkoni në fjetore», i tha.

Sotiraqi i zënë në faj ju bind. Eci pak e ndaloi. «Ç'më shikon ashtu? Marrsh në fjetore! Apo s'të pëlqen?...» Meqë e ndjeu veten fajtor, aty për aty nuk i erdhi rëndë nga këto fjalë. Por më pas ato ju dukën si një peshë që i rënduan në ndërgjegje, dhe nisi të arësyetojë me vete.

«Për atë që bëra sigurisht Domeniku s'do të më ledhatonte, por ama, ai harronte një gjë: për vete kishte më tepër se një vit që e bënte gjimnastikën, dimër e verë pa këmishë, ndërsa unë, pse ta fsheh, kishte qëlluar, atje në shkollë, që edhe të mos bënim fare. Kur ishte ftohët, xhaketat s'i hiqnim asnjëherë. Po të tjerët, psh Xhezmiu, si bënte? Eh, po fundja ai është më i shëndoshë se unë. Pastaj, sa herë i ka qëlluar atij të rrijë edhe natën pranë pusit të naftës, në mes të erës, shiut, të ftohtit?»

Kështu gjykonte sa herë i kujtoheshin fjalët e Domenikut. Të nesërmen s'doli në gjimnastikë, se ishte me shërbim. Të pasnesërmen mungonte Domeniku. Gjimnastikën e drejtonte një tjetër. Këtë herë nuk e mori këmishën. Ndjeu të ftohët, por... Kështu nisi të mësohej.



#### 4. SHQETËSIM

Te Andrea ata shikonin të mishëruara cilësitë e komunistit dhe të oficerit, të komandantit dhe të shokut, të kërkuesit të rreptë dhe të drejtë, të edukatorit dhe organizatorit nga mund të merrej shembull. Sa herë e kishin midis kolektivit zëvendëssekretarin e organizatës bazë të partisë, sikur gjallëroheshin më tepër, sikur merrnin forca të reja; ndjenin një rritje në vetëvete. Andrea i njihte mirë ata, por edhe ata jo më pak. Ai nuk i ledhatonte me fjalë të «ëmblla», por as dhe ata s'merrnin poza, nuk shtreshin. Midis tyre çdo gjë ishte e hapur, e sinqertë.

— Klasa juaj ka më tepër një pamje teknike se politike — u tha ai një ditë. — Duhet të mendojmë që ta ndryshojmë, në radhë të parë përmbajtjen e saj.

— Kjo s'është dhomë kulture, kështu që vendin më të madh do ta zënë skemat — u përgjigj njëri.

— E keqja është se syri të zë vetëm skema.

— Po ç'mund të bëjmë?

— Kështu po. Kjo është tjetër çështje. Dhe nuk duhet harruar se për ju kjo është edhe klasë, edhe dhomë kulture. Ku i mbani librat? Ku i bëni mbledhjet e organizatës? Ku e zhvillonin punën politike?..

Kujt ja priste mendja se, duke e filluar nga kjo «vogëlimë», shoku Andrea do të zhvillonte me ta një bisedë interesante, që lidhej me punën, jetën, shoqërinë e tyre, si duhet ta kuptonin dhe ta zbatonin ata në praktikën e përditshme parimin e vën-

jes së politikës në plan të parë. Dhe, ndërsa zëvendëssekretari fliste, në ndërgjegjen e Sotiraqit filloi të shoshitej tërë qëndrimi i tij kohët e fundit.

... Stërvitja kishte qenë e lodhshme. Pasi ishin kthyer e kishin ngrënë drekë, Sotiraqit i dukej sikur në sup akoma i varej rripi i instrumentit. E lehtësonte pak gjendjen e tij vetëm kur kujtonte fjalët e Domenikut, që i kishte thënë pas një kodore: «Sot ke vepruar mirë. Ec me këtë ritëm dhe ke për me pa, do bahesh një zbulues i shkëlqyeshëm». Sotiraqi mendonte: «Mësues s'ka qenë, por di të sillet si i tillë me nxënësit. E qartë: ai m'i tha ato për të më dhënë kurajo. Po a kam nevojë unë për një gjë të tillë?..» Kishte një copë herë që vriste mendjen të gjente nëse kishte ose jo nevojë për inkurajimin e shokut, kur dëgjoi që po e thërrisnin. Ishte Domeniku.

— Sotiraq, ç'ke, pse mri mendueshëm?

— Ashtu, kot.

— Thash mos kishe gjësendi. Bukur fort. Shiko tash: duhet ba pastrimi i parkut. Atje janë edhe dy ushtarë të baterisë. Bisedova me ta dhe të kanë nda pjesën që do të pastros.

— U dashka të shkoj unë patjetër?

Domeniku e shikoi i habitur.

— Po pse duhet të shkojë një tjetër?

— Sepse unë..., unë nuk mundem të pastroj me fshesë.

— Po të tjerët?

— Ndoshta janë mësuar.

— Shko mëso dhe ti. Këtu në ushtri duhet t'i bajmë të gjitha vetë.

— Jam i lodhur.



— S'të kanë hije këto gjana. Ky asht urdhën, prandaj nisu, shoku ushtar!

Sotiraqi nuk i ishte përgjigjur. Ai kishte ulur kokën dhe rrëmonte dheun me majën e këpucës. Ju kujtua shkolla, pastaj nxënësit. Një ditë edhe atij i kishte ndodhur diçka e tillë me një djalë. Bënin pastrimin e oborrit të shkollës. Nxënësi jo vetëm s'e ulte mesin të fshinte me fshesë ose të hiqte ndonjë gur, por tallej dhe me të tjerët.

«— Pa merr lopatën dhe largoje atë dheun aty!» — i kishte thënë Sotiraqi.

«Nuk mundem, — i ishte përgjigjur ai — s'di ta përdor lopatën».

«Atëhere merr fshesën!»

«Edhe për të fshirë s'di».

«Po ç'mund të bësh atëhere, të mbash duart në xhepa, të shikosh të tjerët?»

«Më ndoten rrobot... mua më qorton mamaja të merrem me pislleqe».

Sotiraqi ishte nevikosur, i kishte bërtitur nxënësit, po s'kishte nxjerrë gjë në shesh. Ju desh të punonte shumë me të, që t'i thyente mendimet e gabuara.

Dhe ja, tani, në rol të nxënësit. Si ju përgjigj Domenikut: «Unë s'jam mësuar të pastroj me fshesë». Kur i kujtoi këto fjalë, gjatë kohës që i binte dheut me majën e këpucës dhe i ballafaqoi me ato të nxënësit të tij, u skuq, i erdhi turp nga vetja. Desh të fliste, po ishte vonë. Domeniku ishte larguar. Kjo e dëshpëroi akoma më tepër. Dikur pat thënë: «Mua më gëzon ajo, që do të jem shok me tre teknikë, tre punëtorë...» Sa fallco i dukeshin tani këto fjalë. Mendoi: «Mos ndoshta



qëndrimi im bie erë intelektualizmi? Ndoshta, pa e kuptuar, te unë nxjerrë kokën kjo mbeturinë dhe bëhet shkak të ngurroj, t'i mat gjërat me kutin e njeriut «që lodhet shpejt», që «s'mund të bëjë çdo gjë», që «në fund të fundit edhe unë diç di, s'jam pa shkollë!», që «unë kë të mësoj, kujt t'i jap mend e jo të më mësojnë?» Duke menduar kështu, ai përfytyroi Ahmetin e shkathët e aq të sinqertë, të gatshëm për çdo gjë, Xhezmiun e urtë, fjalëpak, por aq të gjërë nga zemra, aq punëtor; Domenikun e rrëmbyer, por të drejtë, të gëzuar, të palodhur, gjithnjë në lëvizje; përfytyroi Ahmetin e qetë e të mendueshëm, që s'di të thotë «kjo s'bëhet». I dukej sikur ata, shokët e tij, ja kishin ngulur vështrimin me reptësi dhe i thonin: «Mëso, pra, nga ne, nga punëtorët!..»

U çapit drejt parkut i zhytur në mendime... Sa do të dëshironte ta takonte Domenikun në ato çaste!

Ushtarët e baterisë e pritën me fjalë të mira.

— Fillo! Sa të mbarojmë pjesën tonë, do të të ndihmojmë dhe ty.

— Jo, e pastroj vetë — u përgjigj, por aq ngadalë, sa ata nuk e morën vesh çfarë tha.

... Ja, këto kujtoi Sotiraqi, kur u fliste zëvendëssekretari i organizatës bazë të partisë, këto kujtoi edhe kur e mori fjalën Domeniku në një rast për të ilustruar një mendim të shokut Andrea. Dhe Sotiraqi ndjeu në ato çaste një si të dridhur në trup: priste që shoku i tij të merrte si shembull atë, veprimin e tij, që nuk e kishte shikuar me syrin politik detyrën që i ishte ngarkuar. Por Domeniku ishte ndalur në veten e vet, ai tregoi

se si një ditë e kishte gjetur komandanti të përgatitur, duke zhvilluar mësim pa konspekt. Për këtë bëri autokritikë. Sotiraqit ky veprim i Domenikut i bëri tepër përshtypje, dhe ndoshta ky ishte shkaku që, fill pas tij, u ngrit, mori fjalën dhe tha gjithshka që ndjente në zemër.

## 5. PËR SHOKUN, VËLLANË E TYRE

Për herë të parë punën politike e drejtonte një shoku i tyre, Ahmeti. Por, si sekretari i organizatës bazë të partisë, që kishte qenë në një stërvitje me ta, ashtu dhe zëvendëssekretari, Andrea, u kishin thënë se e mira ishte që në këtë drejtim të aktivizoheshin të gjithë. Këtë këshillë ata e vlerësuan me tërë seriozitetin. Sapo u kthyen nga stërvitja, duke patur gjithnjë ndihmën dhe përkrahjen e Andresë, diskutuan dhe caktuan temën që do të zhvillonte secili. Zëvendëssekretari u tha:

«Çështja është që të përpiqeni t'i lidhni sa më ngushtë temat e punës politike me jetën tuaj, të kolektivit, të merrni pjesë gjallërisht në diskutimin e çdo problemi!»

Ata nuk e harruan këtë këshillë. Dhe ja, ngrihet Ademi dhe diskuton rreth temës, që kishte referuar Ahmeti:

— Këtu u fol për shoqërinë ushtarake. Shoku Ahmet ishte përgatitur mjaft me kujdes, por kam një vërejtje: pak u lidh tema e punës politike me jetën e kolektivit tonë, me shoqërinë tonë ushtarake. A nuk kemi ne se çfarë të themi për



veten tonë? Unë, nga ky kolektiv, ruaj një kujtim të bukur, të paharruar, që ka të bëjë pikërisht me temën që po diskutojmë, me shoqërinë ushtarake.

Dhe ai tregoi:

Lashë shërbimin dhe u futa në krevat. U mblodha sa një grusht. Ndjeja të ftohët. Gjumi s'po më zinte. Shoku që më ndërroi, m'u afrua me kujdes dhe më foli me zë të ulët:

— Ç'ke, vëllaçko, mos je gjë paqejf!

— Jo, i them. Kam pak si të ftohët.

— Këtu brenda sikur... Megjithatë të të sjell një batanie?

— Si të duash...

Siç dukej, kisha ethe. Batania s'më solli ndonjë dobi. S'di se kur, por më në fund gjumi më zuri. Në mëngjez u ngrita si gjithë të tjerët. Ndjehesha më mirë. Ahmeti a Domeniku, s'më bie në hatër, më tha:

— Dukesh pak i zbetë, mos je gjë sëmure?

— Jo. Natën kam patur pak të ftohët.

— Çudi, unë mezi i kam duruar bataniet. E mira është të vizitohesh — më këshilloi. Unë kundërshtova. Mëngjez pothuajse nuk hëngra. Domeniku e mbështolli bukën me një copë gazetë dhe ma dha:

— Merre, ka me të hy në punë.

Sa më preku ky kujdes i Domenikut! M'u kujtua koha kur shkoja në shkollë. Edhe atëhere, kur s'haja mëngjez në shtëpi, sidomos kur më dilte gjumi me vonesë, nëna ma mbështillte bukën me letër dhe më thoshte: «Merre, kur të të vijë uri, haje.»

— S'më vjen as nesër për të ngrënë, Domenik. Kot që t'i heqim të rëndët — ju përgjigja shokut tim.

— Ja heqim ne, — ndërhyri Ahmeti dhe e mori pakon me vete.

Kur dolëm nga mensa, shiu sa kishte filluar. E kuptuam se atë ditë do ta kishim vështirë, do të lageshim keq. Pikën e vrojtimit do ta zinim disa orë larg repartit, në një kodër të lartë. Atë e kishte mbuluar mjegulla, s'dukej. Por ne e dinim ku binte. U nisëm. Instrumenti, megjithëse isha mësuar me të, më dukej i rëndë. Të paktën, unë kështu mendoja. Ecnim të maskuar, në fshehtësi. Deri në njëfarë vendi ecja i fundit. Pastaj, Ahmeti bëri sikur do të lidhte këpucën dhe qëndroi prapa. E kuptova që ai këtë e bëri për mua, po nuk i thashë gjë. Përkundrazi, më erdhi mirë. E përpjeta po më lodhte. Gjunjët sikur po më këputeshin. Steriogypti sikur po më copëtonte krahun. «Ndoshta pse s'kam ngrënë» — arësyetova me vete.

Përpara na doli një rrëpirë gjithë gurë të vegjël të bardhë. Poshtë saj vinte një buzë, që përfundonte në një përrua të thellë. Kaloi oficeri, kaluan dy shokë, Domeniku, më erdhi radha mua.

— Kujdes, më foli me zë të ulët Ahmeti, është vend i rrezikshëm.

Qëndrova. Djersët më kishin mbuluar fytyrën, djersë dhe pikat e shiut, që s'pushonte. Ndjeja dhembje në bark. Ahmetit nuk i thashë gjë. Hodha hapin e parë, të dytin, të tretin... Shkava. Asgjë s'mora vesh. Vetëm pas pak, pasi e mblo-



dha veten, shikoj Ahmetin me Domenikun, që përpiqeshin të më ngjithnin lart.

— Vazhdoni nga rruga tjetër! — tha oficeri.

— Do të vijmë me ju — u përgjigj Domeniku.

— Këtej rrezikoheni. Hidhuni në krahun matanë, nën atë grurin atje dhe dilni në pikë nga rru-ga tjetër, ose... Oficeri shikoi orën. Në qoftë se Ademi s'e ndjen veten mirë, përcillenë deri në kazermë.

— Jam mirë, shoku komandant — u përgji-gja dhe ju luta shokëve të më lëshonin. Ahmeti më mori instrumentin. Nuk e kundërshtova. Nisa të ecja vetë. Me mundim arrita deri te komandan-ti. Kisha përpara një shkallë.

— Ma jep dorën — më tha.

— Jo, do të ngjitem vetë, të falenderit — ju përgjigja. Më vinte zor ta lëshoja veten, me-gjithëse dhimbjet po më shtoheshin. Eca dhe pak dhe i thashë Ahmetit të më jepte steriogypin.

— Si dukesh? — më pyeti.

— Jam mirë. Ndjej ca dhimbje në bark, po do të më kalojnë.

— Ke uri?

— Kur të pushojmë, s'do ishte keq të haja pak. Ma jepni steriogypin, kundërgazin.

— Pas pushimit.

Kot të ngulja këmbë. I njihja që të dy, ua dija kokën... Dolëm në pikën e vrojtimit. Atje na priti një shi i rrëmbyer, që s'na u nda për disa orë. Stërvitjen nuk e ndërpreme. Në krye të dy orëve dhimbjet i pata aq të forta, sa s'munde-sha më. Shokët dhe komandanti u shqetësuan.

— Kush do të shkojë ta përcjellë? — foli ai pa më pyetur nëse doja apo jo të shkoja.

— Unë! — tha Domeniku.

— Duhet dy — foli përsëri komandanti.

— Edhe unë, — u përgjigj Ahmeti.

— Atëhere mos humbisni asnjë minutë. Për krahun ose në çdo mënyrë ta shpini drejt e në spital.

Me vështirësi, por u ngrita. Doja t'u tregoja se mund të ecja. Bile mora dhe instrumentin.

— Kur të na jenë tha krahët neve, atëhere merre ti — më foli Domeniku, i rrëmbyer si gjithmonë.

Se ç'hoqën derisa më sollën në spital, ata e dinë, ama dhe unë di të them: Pa krah mbetsh, por pa shokë jo, shokë që të të fshijnë djersët, të të japin pikën e fundit të ujit nga pagurja e tyre, shokë që të mbajnë në shpinë edhe kur kanë nevojë të ndihmohen për vete... Në spital qëndrova gjatë. Kjo më krijoi boshllëqe në stërvitje. Po kush më dha dorë. kush qëndronte deri në orët e vona me mua për të më mësuar, për t'u bërë siç u bëra, zbulues? Ja, ku i kini, Ahmetin e Domenikun, ja ç'bënë ata për mua, për shokun, vëllanë e tyre...

## 6. ANALIZA E VETËVETES

Kishin kohë që vrisnin mendjen të gjenin një formë të përshtatshme për të zbatuar sa më mirë porosinë e shokut Enver Hoxha në Kongresin e pestë të Partisë. Shoku Enver porositi që secili duhet ta shikojë veten si në pasqyrë dhe,



ashtu siç lan përditë fytyrën, të pastrojë përditë ndërgjegjen e tij, duke mbajtur një qëndrim komunist ndaj vetëvetes.

— Po ja, — thoshte Domeniku, — herë pas here të mblidhemi dhe t'i themi njeni-tjetrit: çfarë anë të dobëta ke konstatue në vetëvete dhe ç'ka mendon të bajsh për çrrënjosjen e tyne?

— Ose, — shtonte Ademi, — gjatë studimit që u bëjmë fjalimeve të shokut Enver, dokumentave e materialeve të tjera të partisë, të nënvizojmë pjesë, t'i shënojmë ato në bloqet tona dhe po aty të shënojmë se si jemi ne me porositë e partisë dhe të shokut Enver.

Për mjaft kohë vepruan edhe sipas mendimit të Domenikut, edhe sipas mendimit të Ademit. Por, analizën e vetëvetes nisën ta bënin rrallë e për mallë dhe kjo vinte, ca se s'gjenin kohë të përshtatshme, ca nga pakujdesia. Kurse bloqet u mbushën me citate, dhe mësimet që nxirrnin rrallë e më rrallë i lidhnin me jetën, me vetëveten.

Një ditë, pasi ishin kthyer nga qyteti, ku kishin blerë disa nga broshurat si «PPSH mbi vijën e masave», «PPSH mbi edukimin klasor-revolucionar», etj., e çelën përsëri këtë bisedë. Shkak u bë Ademi. Ai ua tregoi shokëve se si një ushtar i kishte thënë se, ata na qenkërkeshin «mendjemëdhenj».

— Në këtë «thes» na futi të gjithë, apo e kishte vetëm me ndonjërin? — e pyetën Ademin.

— Mbante mend një ngjarje të shkuar me shokët që u liruan.

— Avaz i vjetër — tha Domeniku e, pasi u mendua një hop, shtoi: — Megjithatë, s'është keq ta rishikojmë vedin.

— Në ç'drejtim? — e pyetën të tjerët.

— Po ja, në qoftë se s'vuejmë nga mendjemadhësia, mund të kemi, fjala vjen, njëfarë familjariteti midis nesh, mundet edhe konservatorizëm. Se ja, p.sh, e vërteta ashtë se pak shoqnohemi me ata të nënreparteve të tjera. Dashje pa dashje, krijojmë përshtypjen sikur po na rritet mendja, sikur dimë ma tepër, sikur ne këtu ja mbulojmë njeni-tjetrit. E ç'mund të them ma tjetër... Puna ashtë që ne në çdo hap të shofim vedin si në pasqyrë.

Mendimet e Domenikut iu dukën interesante shokëve. Bile ata patën përshtypjen se ai këto i kishte bluar prej kohësh. Aty për aty rarë dakord: të kthehej Sotiraqi me Xhezmiun nga shërbimi dhe t'i rrihnin mendimet, të gjenin rrugë të reja për të luftuar më mirë, si në vetëvete ashtu edhe në kolektiv shfaqjet dhe mendimet e huaja, Ata arritën në një mendim të përbashkët: në një blok të veçantë secili të shënonte në krye porosinë e shokut Enver, dhe për çdo ditë ose sa herë e shikonte të nevojshme të shënonte se çfarë shfaqje të huaj, mbeturinë, manifestoi në stërvitje, në shërbim, në shoqëri e kudo, si e manifestoi këtë, çfarë mendonte të bënte për t'i luftuar të metat.

Të gjitha këto ja thanë shokut Andrea, i cili erdhi t'i ndihmonte për mbledhjen e organizatës së rinisë për dhënje llogari e zgjedhje. Ai jo vetëm i dëgjoi me vëmendje dhe i pyeti deri në hollësitë më të vogla, por i konkretizoi më mirë mendimet e tyre, duke u sqaruar nga ana e rëndë-



sisë politike dhe ideologjike porosinë e shokut Enver në Kongresin e pestë.

— Mirë bëni që diskutoni, — i këshilloi ai, — por unë do të isha i mendimit që edhe të veproni. E menduat se kështu është mirë?.. Atëhere filloni! Kjo është një inisiativë që do t'ju ndihmojë në rritjen e ndërgjegjes, inisiativë që mund t'u vlejë shumë edhe organizatave të tjera të rinisë.

Këshillat, vërejtjet, ndihma e komunistit i nxiti, ua shtoi vrullin. Në mbledhjen për dhënje llogari e zgjedhje, fletoret e shënimeve u quajtën «bloqe të vetanalizës».

Pas ca kohësh, kur kishin fituar njëfarë eksperience, ata vendosën të diskutojnë si ta thellonin më tej punën e nisur. Për këtë, më parë lexuan bloqet e njëri-tjetrit, u njohën, si të thuash me botën e brendshme të njëri-tjetrit. Atyre, duke lexuar shënimet, të mbajtura për vete ose për shokun, u dukej sikur depërtonin thellë në zemrën e secilit, sikur shikonin me sy atë luftë ndjenjash, mendimesh, konceptesh që zhvillohej atje, në thellësi të ndërgjegjes. Në këto «bloqe të vetanalizës» shikon se si zhvillohet revolucionarizimi i ndërgjegjes te ushtari.

Ja si zhvillohet kjo luftë e brendshme në ndërgjegjen e Xhezmiut dhe që shprehet në disa rreshta në «blokun e vetanalizës»:

... Në një çast, gjatë stërvitjes, ai nuk kishte zbatuar kërkesat e rregullores, nuk ishte maskuar. — «E mo, s'u bë qameti, s'ka se kush më vrojton, se mos ka me të vërtetë armiq në kodrën përkarshi!», — kështu kishte thënë me vete dhe kishte ecur i pamaskuar drejt vendit që i ishte caktuar

të zinte. Komandanti i skuadrës e gjeti midis shqopave. «Mirë» — i kishte thënë dhe ishte larguar. Meqenëse nuk e kishte ndjekur lëvizjen e tij, komandanti nuk i vuri re mungesat në maskimin e ushtarit. Ja, pra, sa i pakujdesshëm ishte treguar komandanti. Dhe pse? La mënjanë kërkesat e rregulloreve, s'u tregua i rreptë të kontrollonte një për një veprimet e vartësit.

Në blokun e tij Xhezmiu e analizon kështu këtë rast: «Në të vërtetë, unë, me veprimin tim, theva rregulloren, sepse e nënvleftësova një element të stërvitjes, maskimin. Po sikur të ishte luftë? Sigurisht plumbi i armikut, siç ecja unë, i pamaskuar, nuk do të më kishte lënë ta zija vendin e caktuar. Nga ana tjetër, dashje pa dashje, unë nuk u tregova i ndërgjegjshëm para komandantit, megjithëse ai duhej të vinte re të metat dhe të më bënte mua të skuqesha. Por pse veprova kështu? Më pëlqente të mos e lodhja veten. Pra vura interesin personal mbi atë të përgjithshmin. Po pse tani i kuptoj këto, dhe atëhere jo? Kur u grumbulluam, më erdhi zor nga vetja. Të gjithë ishin ngarkuar me gjethë, ndërsa unë... Komandanti më tha vetëm kaq: «Krahasoje veten me shokët!» E ç'krahasim mund të bëja unë, kur mbeturinat mikroborgjeze e kishin bërë punën e tyre? Sidoqoftë, unë kam forca t'i shkul ato dhe t'i flak. Sa të mbaroj së hedhuri këto shënime në blok, do të rilexoj paragrafët e parë të rregullores së disiplinës, dhe qysh nesër do të filloj nga rileximi i fjalimit të 6 shkurtit. E ndjej këtë si një nevojë të domosdoshme. Ndryshe s'kam si të eci përpara...»

Ja dhe diçka nga Domeniku. Ato janë shkruar



në faqen e parë të blokut: «Shokët kishin shkue për me mbjellë patate. Pak ma vonë u nisa dhe unë. Rrugës mendoja: «Kot që s'qëndrova në kazermë. Ata s'më presin. Jam dhe i lodhur gjatë stërvitjes...» Ja dy forca: dëshira për të pushuar dhe puna që më priste. Dy mendime në luftë me njëri-tjetrin. Në ecje e sipër, sidomos kur pashë shokët që punonin me aq vrull, flaka tej inetresin personal. I shënojmë këto, që të kem mendjen herë tjetër».

Po mbi mbjelljen e patates, në një rast, Ademi ka shkruar: «Unë jam prej natyre pak i javashëm, po jo dembel. Sot ky javashllëk u kthye në dembelizëm. Bëra autokritikë para shokëve, dhe fjalën s'do ta bëj dysh».

Duke shfletuar një nga një fletët e atyre bloqeve, të del si në pasqyrë jeta luftarake e atij kolektivi të vogël, përpjekjet që bën secili për të rritur ndërgjegjen revolucionare, gatishmërinë luftarake, për ta bërë nënrepartin një kudhër kalitjeje, një detashment kompakt, të disiplinuar, të aftë për të plotësuar më së miri detyrat që i caktojnë partia dhe populli

Në faqet e atyre bloqeve gjen të shënuara shumë data. E në secilën prej tyre janë të rradhitura ndjenjat, mendimet. Secila pasqyron një pjesë të jetës së çdonjerit, një pjesë nga jeta e kolektivit. Ajo është një jetë e gjallë, që gurgullon pa pushim, si ai burimi që çan midis gurëve e zallit, është një jetë ku ndeshen koncepte, mendime të kundërta, ku lufton e reja me të vjetrën. Kjo luftë është e rreptë, sepse e reja s'mund të pajtohet me të vjetrën, qoftë dhe në shfaqjet më të vogla të saj. Që ta kuptosh thellë këtë, duhet t'i

lexosh të gjitha shënimet e tyre, duhet të bisedosh me ta gjatë e shtruar, duhet t'i njohësh në punë, në jetë, në stërvitje. Kështu do të vëresh se si ndërgjegja e secilit argaset më tej, bëhet më e pastër, më revolucionare.

Më ra në sy se në një datë, një muaj pasi Domeniku ishte zgjedhur sekretar i organizatës së rinisë, të gjithë i fillonin shënimet pak a shumë kështu: «Mbrëmë na ndodhi diçka, për të cilën do të mundohem të jap shpjegime më poshtë. Kjo lidhet me Domenikun...» Domeniku vetë, në shënimet e asaj date, ishte zgjatur më tepër se çdo herë tjetër. Ç'kishte ndodhur?

... Mbrëmje për mbrëmje Domeniku i jepte Sotiraqit të zgjidhte një numër ushtrimesh. Në fillim nga dy, pastaj nga tre, nga katër. Qëllonte që rrinin me orë të tëra në klasë dhe dërrasa e zezë sa «mbushej» me formula, «zbrazej».

Një pasdite ata mësuan diçka që edhe i habiti, edhe i bëri të mendohen.

Mbaruan ndeshjen e voleibollit që kishin me fqinjët dhe Domeniku, pasi i dha fletoren Sotiraqit, u nis për te ndërlihdësit të pyeste për Xhezmiun, si paraqitej, ku ishte me specialitetin si radist, si sillej. Ahmeti dhe Ademi qëndruan edhe disa minuta me «kundërshtarët», ndërsa Sotiraqi me Xhezmiun u futën në klasë. Në krye të një ore Domeniku u kthye dhe i gëzoi pa masë. Shoku i tyre ishte një ndër radistët më të mirë. «Është xhevahir djalë», — me këto fjalë e kishte përcjellë komandanti i nënrepartit ndërlihdës.

— Ku asht? — pyeti Domeniku.

— Në klasë, kushedi ç'lexon, — i thanë dhe u



drejtuan për atje. Dhe ja e papritura: ndërsa Sotiraqi qëndronte ulur e diç shkruante në fletore, Xhezmiu bënte zberthimin e një ushtrimi në dërrasën e zezë.

— Xhezmi, paske qejf të bahesh zbulues? Qenke fut drejt e në... — Domeniku nuk e mbaroi fjalën. E kuptoi se mund të rëndonte modestinë e ushtarit. Prandaj, pa i dhënë kohë Xhezmiut të fliste, shtoi:

— S'ka ma mirë. Le të shtohen radhët e zbuluesve, sidomos kur je dhe radist i dalluar!

— Ama dhe ti... — Xhezmiu la shkumësin dhe u mat të ulej.

— Jo, prit, vazhdo, shpjere ushtrimin deri në fund!

E vërteta ishte se Xhezmiu kishte marrë zotim të përvetësonte dy detyra, atë të radistit dhe të telefonistit. Por duke qëndruar pasditeve me zbuluesit, duke ndjekur përparimet që bënte Sotiraqi, si në detyrën e llogaritësit, ashtu edhe në atë të zbuluesit, duke ndjekur me kujdes ushtrimet që i jepte vazhdimisht Domeniku, kishte thënë me vete: «Po unë, a mund të bëhem zbulues?» Një ditë këtë mendim ja kishte shfaqur Sotiraqit: «A mundesh?! As mos e diskuto!» — i ishte përgjigjur ai dhe kishte filluar t'i tregonte diçka rreth kësaj detyre, bile së bashku kishin zgjidhur edhe ushtrime të thjeshta. Dhe kështu, pa zhurmë, në qetësi, ama i sigurtë në vetevete, i hidhte hapat Xhezmiu edhe në këtë detyrë. Kur e pyetën se pse s'ua kishte thënë më parë, ai ishte përgjigjur:

— Për dy arsye: së pari druhesha se mos mendonit: «E po dhe ky, përvetësoi radion dhe i

mbeti detyra e zbuluesit», dhe së dyti, ju do të më ndihmonit duke sakrifikuar kohën e lirë ose gjumin. Pra, më dukej sikur do t'ju bëhesha barrë. Por, ama, dhe duarkryq, sehixhi s'mund të rrija.

Sinqeritetin e Xhezmiut nuk e kaluan në hesh-tje. Ju duk se kishte mjaft për të diskutuar dhe diskutuan, bile e kritikuan rreptë që ruante rezerva ndaj shokëve. Ç'donin të thonin ato fjalë, «do t'u bëhesha barrë?» «Ky është kolektivi ynë!» — shtruan pyetjen ata...

Atë pasdite, që Sotiraqi me Xhezmiun prisnin të futej në klasë Domeniku, për t'u dhënë shokëve ushtrime të reja, u dha papritur te dera Ahmeti:

— Ku është Domeniku?

— Atë po presim, tani duhet të vijë, — folën njëzëri të dy shokët.

Megjithatë nuk u shpëtoi pa vënë re njëfarë shqetësimi në qëndrimin e Ahmetit. Ai bëri një gjest pakënaqësie me dorë, lëshoi një «ah» dhe u largua. Dy të tjerët u ngritën dhe dolën përjashta. Ahmetin e gjetën duke biseduar me Ademin. U bashkuan të katër.

— Si t'i përgjigjem shokut Andrea? Ai e do këtë minutë në telefon, — fliste Ahmeti.

— Ju sikur ishit bashkë?

— Po, mbaruam përgatitjen për stërvitjen e nesërme, u morëm vesh që, pasi ta mbaronte së lexuari romanin «Dasma», të na bënte recens-ionin e tij dhe ai u nis për te ju. E dëgjova që dikush e thërriti, se kishte për t'i dhënë një letër, u takua me të dhe pastaj s'di nga shkoi.

— Cili është ai?

— Nuk e pashë mirë.



— Po ushtarët e baterisë i pyete?

— Po.

— Edhe oficerin e rojes?

— Po.

— Nga parku ishe?

— S'kam lënë vend. Edhe në kuzhinë pyeta.

Asnjëri s'foli më. Ranë në mendime. Diçka do të kishte ndodhur me Domenikun. Por, se çfarë, e kishin vështirë ta merrnin me mend. Më në fund Ahmeti shkoi në telefon. I tha zëvendëssekretarit se Domenikun s'po e gjenin dot, diku kishte shkuar.

— Si është e mundur të mos gjendet, Ahmet?...  
— Po ja...

— Ç'ishte ajo letër që mori sot? Mos i ka ndodhur gjë nga familja?... Pastaj, sido që të ishte puna, si të mos ju vinte në dijeni, fundja njërin prej jush... Mirë, ai do të kthehet shpejt. Sqaroheni si është puna dhe më njoftoni. Do të jem këtu, në shtab... Tani dëgjo: së shpejti, një ekip i komitetit të partisë do të vijë te ju. Do të kontrollojë gatishmërinë luftarake... Më hollësisht bisedojmë nesër. Do të vij që në mëngjes... Ti, njoftoi shokët! Kam besim se...

Ahmeti e kuptoi se ç'do të thoshte me fjalët e fundit zëvendëssekretari i organizatës bazë të partisë, por u përmbajt t'i përgjigjej. U mjaftua vetëm me shprehjen:

— Si urdhëron, do t'i njoftoj shokët!...

Në orën e kulturës masive vendosën të bënin studim individual. Por mendja u qëndronte po atje, te Domeniku. «Ku të jetë?» — pyeste secili veten, dhe secili nuk donte t'i besonte vetes, kur për një çast i shkante mendja se ai mund të ishte larguar pa leje.

Nuk shkoi shumë dhe te dera u dha Domeniku. Në qetësinë që zotëronte në klasë (por jo në ndërgjegjen e kolektivit) u dëgjua një fjalë:

— Mirëmbërma!

Ata ngritën kokën dhe i drejtuan vështrime pyetëse, vështrime që kërkonin një përgjigje të shpejtë, të saktë, të prerë.

— Isha deri afër qytetit... Pata një pshtjellim, një si tronditje, një çështje personale, që më shtyni me u largue pa leje... ç'ka me ju thanë tjetër? E bana këtë... Gabimi asht i randë... E kuptova, por ishte vonë, e kuptova pasi isha largue... Kjo më bani që të mos futesha në qytet, të mos shkoja as në postë... Më dukej sikur dëgjoja që larg zanin tuej... Kjo asht e gjitha.

Ahmeti u ngrit në këmbë. Domeniku s'guxoi ta shikonte në sy. Dhe cilin, Ahmetin, shokun e ngushtë, atë që e njihte aq shumë, që e donte aq fort, atë që e pyeste për çdo gjë, që i hapej, i qante hallin për çdo gjë, që e quante si vëlla, që e ndjente mungesën e tij në nënrepart. Dhe ja, pikërisht Ahmetin s'guxonte ta shikonte drejt e në sy. Shoku foli:

— Diçka na the, dhe bëre mirë. Por kjo nuk është e gjitha. Bile, më duket mua, është vetëm fillimi. Pra, nuk mund ta lëmë me kaq, sepse nuk na lë ndërgjegja. Po, ndërgjegja... Unë propozoj, shokë, që sot të bëjmë mbledhjen e organizatës së rinisë për sekretarin tonë dhe të shikojmë se ç'është kjo «çështje personale», që e bëri atë të thyejë disiplinën, të largohet pa leje nga reparti, duke lënë për disa kohë pozicionin



luftarak, pushkën. Kjo na shqetëson tepër, sepse ka të bëjë me një shokun tonë, me ndërgjegjen e tij, me qëndrimin e tij ndaj detyrës, me kolektivin tonë, ka të bëjë me interesat e gatishmërisë luftarake.

— Unë jam i mendimit për ta bërë mbledhjen edhe pse është vonë. Na takon neve, shokëve të tij, ta zgjidhim çështjen, ta shpiem deri në fund, të shtyrë nga kujdesi që kemi për pjesëtarin e kolektivit tonë, nga dëshira për ta ndihmuar atë, — foli Ademi.

— Më kot e zgjatim, ta bëjmë!

— Ta bëjmë, — tha dhe Xhezmiu.

— Po ju, shoku Domenik?

— Kur vendosët ju, edhe unë...

Mbledhja filloi menjëherë sapo hëngrën darkë. Ishte një mbledhje jo si të gjitha të tjerat, një mbledhje ku ndërgjegja e një shoku vihej përballë ndërgjegjes së një kolektivi.

Dhe ja si ndodh kjo: në një çast ti, shok i dashur Domenik, me veprimin tënd fillove të krijosh në ndërgjegjen e kolektivit një boshllëk, ndoshta të vogël. Por a mund ta lejojë kolektivi një gjë të tillë? Në asnjë mënyrë, jo. Ai e di se, sa kohë që ka luftë klasash, ndërgjegja e njeriut ushqehet në mënyrë të pandërprerë me ideologjinë klasore, ajo nuk lejon boshllëk, se çdo boshllëk do të krijonte kushtet që ndërgjegja të të prekej nga ideologjia borgjeze dhe revizioniste. Prandaj, kolektivi që këtë çast, pa asnjë ngurrim, i bën «diagnozën» ndërgjegjes tënde, kërkon të gjejë «mikrobin», atë që të shtyu ty të thyeje

disiplinën, të largoheshe pa leje, të qëndroje për një kohë i mbyllur në vetëvete, duke harruar detyrën që të ka ngarkuar populli, atdheu. Në këtë rast, kolektivi po vepron me ty si ai mjeshtri që nuk pret sa të mbarojë muret e ndërtesës së lartë e pastaj të shikojë nëse është në rregull ose jo. Mjeshtri i mirë, pas çdo tulle ose brezi tullash, kontrollon nëse tulla që vuri zuri vend mirë, u puthit me shoqet e tjera, apo ka nevojë ta përdorë përsëri çekanin. Dhe e përdor atë i sigurtë, me mjeshhtëri, e përdor derisa ajo ndërtesë me themele betoni të përfundojë krejtësisht, që të mos ketë mortje kurrë, por të jetë e patundur, e fortë, që t'u rezistojë tronditjeve ,rrebesheve, stuhive.

Ja, pra, këtë kërkon të bëjë me ty Domenik, kolektivi, të bëjë «diagnozën» e plotë, të përcaktojë dhe të «bombardojë», me forcën që i jep ideologjia e klasës, «mikrobin» që nisi të nxjerrë kokën tek ti, «mikrobin» e rrezikshëm të individualizmit. Mos u habit! Ne nuk mund të jemi të imunizuar nga çdo gjë e keqe. Jo! Po të mos vepronte tek ti ndjenja individuale, interesi i ngushtë personal, qoftë edhe për një çast, a do të ngjiste që ti, sapo more letrën shkrove dhe u struke në një qoshe, larg shokëve, duke harruar se ke detyrime ndaj tyre, ndaj repartit, ndaj atdheut.

Na kupton, Domenik, ku e kemi hallin? Ta përsëritim: na hap zemrën. Për ne dhe për ty kjo ka rëndësi, prandaj dhe nuk bëjmë lëshim, prandaj dhe s'mund të heshtim, prandaj dhe të kërkojmë llogari si shoku ynë, si pjesëtar i kolektivit tonë.»



Domenikut i dukej sikur këto fjalë vërshonin nga goja e secilit, edhe pse deri në ato çaste, akoma s'kishin zënë vendet, asnjëri s'kishte shprehur gjë me gojë. U ulën. E mori fjalën Ahmeti.

— Mendoj ta merrni ju fjalën, jo si sekretar, por më tepër si anëtar i BRPSH. Ju duhet të na përgjigjeni neve, shokëve të tu, — tha Ahmeti.

— Drejt. Ngreu, Domenik!.. Na e hap zemrën. Ne do të mundohemi të lexojmë atje gjithshka...

— Ta kuptosh se ne, shokët e tu, të kërkojmë llogari. Pra, shikoje veten si në pasqyrë... Kujto këtë porosi... «lufta e klasave drejtohet.. kundër çdo shfaqjeje të huaj, që vihet re në ndërgjegjen, mendjen, sjelljet e qëndrimet e çdo njeriu». E mban mend? Kushedi sa herë e kemi përsëritur...

— Çka me ju thanë tjetër?! Unë e ndjej atë që bana...

Shokët nuk u kënaqën.

— Na e sqaro çështjen, shoku Domenik!

— S'ka asgja për me u shqetësue, asht thjesht një çështje personale, një çështje që më takon vetëm mue.

— Po ti, je i këtij kolektivi, apo jo?

— Kot me e diskutue!

— Diskutojnë qëndrimin që mbajte ndaj detyrës. Pse, ç'të shtyu të ikje pa leje?

— Unë e thashë, kam ba gabim.

— Kjo s'mjafton! Çfarë të detyroi të bije në këtë gabim? Pse nuk u këshillove me shokët?

— S'më shkoi në mend.

— As për Ahmetin?

— Unë njilloj i kam të gjithë.

— Po, njilloj. Kjo është e vërtetë, po ti tek

asnjëri nuk shkove dhe t'i thoje: «Kam këtë hall, më jep një mendim, një këshillë» dhe shoku do të të ndihmonte, shoku do të të hiqte «turbullirën», do të të bënte të kontrolloje vetën dhe të mos i bëjë ato hapa të gabuara. Por s'e bëre këtë, e di pse?

— Ai hall që kisha unë s'ishte për t'u diskutue as me shokun as me kolektivin; e thashë, asht një diçka personale, që më përket vetëm mue.

— Por kjo «diçka personale» ka cenuar detyrën, interesin e përbashkët...

— Unë ashtu e shiqoj. A mund të merret kolektivi me gjanat e mia, kur unë ato mund t'i zgjidh vetë? Të më kuptoni, këtu e kam fjalën për gjana thjesht personale.

— Dhe ç'rrugë ndoqe për t'i zgjidhur këto çështje «personale?». Rrugën e ikjes pa leje?!

Kjo pyetje e Sotiraqit e bëri Domenikun të mendohej thellë. Qëndrimi që po mbante s'ishte aspak i drejtë. Diç u fshihte shokëve, s'kishte guxim t'ua thoshte të vërtetën në sy. Në këtë mënyrë, dashje padashje tregonte mosbesim ndaj tyre, mbante rezerva. Shokët po e kuptonin, po bindeshin gjithnjë e më shumë se kishin të bënin me koncepte të huaja, me mbeturina që ishin ngulur thellë në ndërgjegjen e Domenikut. Ato gjetën rastin dhe ju bënë ferrë nëpër këmbë shokut, po e pengonin. Ai e ndjente se diçka kishte në këtë mes, por s'po mundte ta shkulte e pastaj t'i digjte këto ferra. Për këtë duhej ndërhyrja e «kirurgut», e forcës së kolektivit, i cili e kuptoi se prapa letrës që mbante në xhep shoku i tyre fshiheshin konceptet e tij. Dhe Domeniku s'mundi t'i rezistonte kolektivit,



ndjenjave të tij. Ai provoi edhe një herë t'i shikonte shokët drejt e në sy dhe ju duk sikur secili i fliste vetëm atij, ndërgjegjes së tij. Ja ç'thotë vështrimi i Ahmetit në këto çaste:

«Domeniku është një shok i mirë. Po ja, di-ku, në ndërgjegjen e tij paska bërë vend një e keqe, një mbeturinë, që kur i erdhi koha, kur gjeti rastin, ngrihi kokën, u aktivizua, veptoi. Këtë na takon neve t'ja zbulojmë, t'ja tregojmë dhe t'ja shkulim. Ky është individualizmi mikroborgjez, mbyllja në guaskën e vet. Kur t'ja them, do të hidhet përpjetë, do habitet. Por ndodh që atë që ti nuk e sheh në veten tënde, e shohin të tjerët...»

Tek vështrimi i Sotiraqit Domeniku sikur lexon: «Ti, Domenik, para se të përgjigjesh për pyetjen që të bëra, kujto një këshillë, një mësim të madh të shokut Enver. Po qe se e ke harruar, po ta kujtoj unë. Dëgjo: «Kurrkush nuk mund të thotë se kjo është çështje personale, private, kur ajo është e lidhur me shoqërinë, me normat socialiste dhe të partisë». E ke të qartë? Këtu ndalu dhe hyrë në brendësi të çështjes...»

Ja dhe Xhezmiu «Çudi, more Domenik. Ti ke genë dhe mekanik, elektrikist, pra punëtor. Ndoshta i ri, por njeri i klasës, e si, gjatë më tepër se një ore, fjalët: «çështje personale», «thjesht e imja» të përsëriten aq herë nga goja jote?.. Eh, mor byrazer, sot nxora një mësim edhe për ty, edhe për vete, edhe për gjithë shokët: të rritim kërkesën ndaj vetëvetes, për t'u thëlluar më tepër në politikën dhe ideologjinë e partisë. Një gjë duhet të kemi të qartë: pa e mësuar teorinë marksiste-leniniste, nuk do të bëhemi revolucionarë në atë shkallë që kër-

kon partia, do të mbetemi kurdoherë praktiçistë. Kjo porosi, shokë, duhet të na vlejë të gjithëve».

Po ti, Adem? «Domeniku më ka mbajtur mbi shpatulla, ju kujtohet? Jua kam treguar një rast. Domeniku është nga më të përgatiturit në kolektivin tonë. Njeriu që s'përton për asgjë. Unë kam mësuar dhe kam se ç'të mësoj prej tij. Dhe do të mësoj. Por ja që edhe ti, Domenik, duhet të mësosh nga ne. Tani shtroj pyetjen: A është gabim i rastit ky që bëri Domeniku? Them se jo. Unë i kam nënvizuar mirë këto fjalë... «pa qenë njeriu politikisht dhe ideologjikisht i ngritur, shumë mbeturina që i zenë këmbët do ta çojnë në gabime». Mos të të vijë çudi. Ti ke ecur, ti s'je ai që ke qenë, ashtu siç ka ecur i tërë kolektivi, të gjithë ne. Po ja që një çast ti e ngatërrove hapin dhe... shkele në dërrasë të kalbur. Dhe pse? Sepse, qoftë edhe për një çastë ke harruar ta ushqesh ndërgjegjen me ideologjinë e klasës punëtore.»

Domeniku u ngrit dhe desh të fliste, po nuk mundi të hapte gojën. Një ushtar u dha te dera e klasës:

— Shokun Domenik e kërkojnë në telefon.

— Kush?

Ahmeti, që e bëri këtë pyetje, kafshoi buzën e poshtme. Ai kishte harruar porosinë e shokut Andrea. «Po, po, ç'bëra?...» Ju drejtua Domenikut.

— Shko, me qind për qind të kërkon shoku Andrea.

Dhe me të vërtetë ai ishte. Ndodhej me shërbim në shtab. Që në fjalët e para Domeniku kuptoi shqetësimin që e kishte pushtuar zëvendëssekretarin e organizatës bazë.



— Ç'ka ndodhur me ju, shoku Domenik?

— Po ja, jemi tue vazhdue mbledhjen e organizatës... Unë... Unë... dola pa leje... Shokët më kërkojnë t'u them arësytën pse e bana këtë.

— Dhe ti ngurron?

— Si me ju thanë... Ua kam përsëritë se gjithë puna qëndron tek letra, se kam pasë një hall të madh, një çështje thjesht personale... U nisa me shkue deri në postë, u pendova dhe u ktheva... Çka me ju thanë tjetër gja? S'di pse ngulin kambë aq fort?

Andrea e dëgjoi deri në fund. Para se të fliste u mendua. «Ata bëjnë mirë që ngulin këmbë. Prapa «letrës» fshihet diçka». Në telefon ai u kufizua me këto fjalë:

— Mirë nesër unë do të vijë andej, do të bise-dojmë shtruar. Po ti mos më prit mua: mos ngurro t'u hapësh zemrën shokëve, e kanë për të mirën tënde, të kolektivit, për të mirën e ushtrisë. Se ti, mos harro, Domenik, je ushtar i popullit, i partisë. Pra, mos ngurro të njohësh gabimet, të kërkosh ndihmë, të bësh autokritikë. Si thua, Domenik?

Në anën tjetër të telefonit mezi u shqiptuan këto fjalë:

— Do të mundohem!..

Edhe pse këtë premtim e bëri me zë të ulët, prapëseprapë e mbajti. Pasi u fut në klasë, hoqi kapën, e vendosi mbi tryezë dhe ju drejtua shokëve:

— Ishte shoku Andrea. Më pyeti se ç'më kishte ndodhur. Nuk ja tregova të gjitha. Ma mirë me thanë, atë që duhej s'ja zuna në gojë. Edhe juve, po ashtu, deri tash s'jua kam thanë. Por do t'jua them: Boll më ka mundue. Do të më jepni një men-

dim, nëse kam ose s'kam të drejtë. Do të më ndihmoni... Ndoshta asht vonë, por, si i thonë — ma mirë vonë se kurrë... Kështu, pra, me thanë të drejtën, pasi u ndava me Ahmetin, u nisa me ardhë këtu, në klasë. Por takova një shok, bashkëqytetari jem, që ishte kthye nga leja. E pyeta për nga familja. Ai s'kishte mujtë me shkue, po s'di kush kishte dalë te autobuzi dhe i kishte dhanë një letër për mue. Ma dërgonte familja. Shoku s'më priti sa me e lexue. U largue, se e kërkojshin. Atëhere unë shkova pas kuzhinës dhe u ula në një stol. E lexova letrën me një frymë. E rilexova dhe një herë. S'po u zija besë atyne që thuheshin... Ja, shkurtimisht përmbajtja: prindërit më njoftonin se së shpejti motra do të martohet. Kështu kishin vendosë ata dhe motra ishte dakord. Kjo do bahej për disa arësye, që s'm'i shpjegojshin. Veç këtyne, më thojshin se i fejuemi i motrës hyn e del në shtëpi pa u drojt, se asht djalë i mirë boll, e gjana të tjera që s'kanë ndonji randësi.

— Shumë mirë, ç'të keqe ka këtu?

— Mos e ndërpre, shoku Adem! Kemi vendosur ta dëgjojmë deri në fund, — dhe Ahmeti ju drejtua Dömenikut:

— Pastaj?

— Pastaj, s'asht ashtu si e mendon Ademi, se unë e di ku më dhemb. Motra do martohet me një afat ma të gjatë. Dhe kjo ishte lanë me qëllim që të përgatiteshim. Deri atëhere edhe unë do të isha liruar nga ushtria dhe...

— Dhe do t'i përgatitje pajën?

Ai ishte nderur në fytyrë dhe belbëzoi:



— Unë e kam motër... duhej të kishin marrë mendimin tim...

— Dhe këtë ti s'mund ta durosh, ë?..

— Të kuptohemi, Sotiraq. Unë e kam ndie ve-din të fyem. Si asht e mundun të mos pyetem për asgja? Unë s'jam i vogël, unë e kam motër, unë mund të jepja një mendim, t'u propozoja diçka! Apo pse jam larg dhe.. Pastaj, le prindërit, po as motra të mos më pyesë? Unë s'e shikoj të drejtë veprimin e saj... Ja ku del dhe një gja tjetër: i fe-juemi i saj — unë e njof, asht djalë i mirë — e ka ba shtëpinë tonë si të vetën. Kjo sikur nuk shkon. Patjetër ai ka përfitue se unë jam larg.

— Se po të ishe më afër, do ta ndaloje?

— Por edhe atij do t'i vinte ma zor...

— Po të ishte i fejuar me ty, po!

Ndërhyrja e Ademit shkaktoi të qeshura. Do-meniku u hutua një çast. Pastaj e mblodhi veten dhe vazhdoi:

— Unë i tregoj gjanat si janë, si i ndjej. Ju ju kam shokë. Mbi këto që ju them unë, gjykoni e më thoni si duhet të baj.

— Po, drejt e the, — e mori fjalën Ahmeti. — Ne do të gjykojmë ashtu si na mëson partia. Edhe ti i di porositë e 6 shkurtit. Së bashku kemi disku-tuar sa herë mbi zakonet prapanike, mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve, mbi emancipimin, por, me sa po kuptojmë, s'je thëlluar në to, ke pandehur se ato u takojnë të tjerëve dhe jo çdo qytetari, të është dukur sikur vetëm njerëzit me moshë të kaluar ruajnë në ndërgjegje mbeturina, ndërsa ne, jo! Por në të vërtetë secili ka se çfarë të luftojë në vetë-vete, edhe ne që jemi të rinj...

Domeniku e dëgjonte Ahmetin me një kujdes e vëmendje të tillë, sa që kjo u ra në sy të gjithëve. Ai ja kishte ngulur sytë atij dhe sikur i përpinte çdo fjalë. Të dukej sikur thoshte me vete: «Eh, sa gabim bana atëhere kur mora letrën. Pse s'erdha të këshilloheshim bashkë, të të thosha: «Qe, Ahmet, ja ç'po më shkruajnë». Me siguri t'i s'do më lije të bëja atë që bana, mbi të gjitha theva disiplinën. E përse?..»

Këtë pyetje që i bëri vetes, atij ja bëri edhe Ahmeti, ja kishin bërë edhe shokët e tjerë. Ata sipas fjalëve të tij e dinin si ishte larguar, dinin se deri te qafa ja kishte hipur një maqine, pastaj ishte nisur më këmbë dhe atje, ku duket qyteti kishte qëndruar dhe ishte menduar një copë herë. Pikërisht aty, një zë i brendshëm, zëri i ndërgjegjes i kishte thirrur: «A nuk mund ta bësh një ditë tjetër telegramin, ose t'i marrësh njerëzit e shtëpisë në telefon? A e kupton se ke ikur pa leje, ke thyer disiplinën, rregullat?..» Dhe ishte kthyer. Po, këto ata i dinin, por ngulnin këmbë që Domeniku t'u thoshte me gojën e tij se a e kuptonte shkakun e këtij verpimi. A e kuptonte ai se duke patur në kokë koncepte e mendime të gabuara e kishin futur në një rrugë pa krye?

Ata e morën fjalën përsëri dhe t'han e drejtuan po këtu: Domeniku ruante në ndërgjegje mbeturina që po e pengonin. Këto ishin konceptet jo të drejta ndaj së motrës, martesës së saj, — ruajtja e zakoneve prapanike, bile patriarkale në këtë drejtim. Ata i treguan shokut edhe rrugët për çrrënjosjen e këtyre mbeturinave. Dhe rruga ishte një e



vetme: thellimi i mëtejshëm në mësimet e partisë e porositë e shokut Enver Hoxha.

Mbledhjen e mbaruan pas katër orësh. Shkuan për të fjetur. Domenikun e zuri gjumi më pas se gjithë të tjerët...

## 7. NGA KUJTIMET E ASAJ MBRËMJEJE

Pak ditë më vonë, midis Ahmetit dhe Domenikut, që sapo ishte kthyer nga qyteti, zhvillohej kjo bisedë:

— Erdha drejt e këtu. Më duhet me u përgatitë për nesër.

— Me bisedën, ç'bëre?

— Gati e kam, don me e këqyrë?

— Jo. Desha të të them a e ke patur parasysh broshurën: «PPSH mbi vënjen e interesit të përgjithshëm mbi interesin vetiak».

— Qe, ku e kam, e bleva sot.

— Po ne e kemi një kopje.

— S'ka gja se bahen dy.

— Për konferencën e more vesh? Do të bëhet në fund të javës.

— Të gjithë do shkojmë?

— Më duket se po. Sidoqoftë duhet të përgatitemi.

— Pse jo, foli Domeniku, kena çka me u tregue shokëve.

— Tani pa më thuaj, ç'bëre, a mbarove punë?

— I falemnderit shumë shokut Andrea! Nuk m'u nda derisa mbarova.

— Bisedove?

— Po, me babën. Tanë i kisha mirë. «Të fala shoqënisë» — më tha në fund baba.

— E sqarove çështjen?

— Fola dhe me motrën. Më ka hjekë një rryp, që... Po ku i kishte tanë ato fjalë, tanë atë seriozitet. «Ti shiqo detyrën, ajo asht kryesorja. Ne do bajmë siç na mëson partia...» Ja, kështu më tha.

— Sa mirë! Pse, ç'pandehe, do të bëheshe komandant i saj dhe t'i diktoje se kur të martohet? Mirë ta ka thënë, ajo e di vetë këtë punë.

Domeniku uli kokën mendueshëm. Diç desh të thoshte, por u përmbajt. Ahmeti ndiqte me kujdes çdo lëvizje të tij, çdo gjest, qoftë dhe se si i ngrihej dhe i ulej gjoksi. «S'ka gjë pse ja thashë edhe një herë kaq copë, i bën mirë», — mendoi me vete, ndërsa vërente duart e Domenikut që shtrëngonin gazetën. Pastaj foli me zë:

— Dalim?

Tjetri ju bind pa e hapur gojën. Ecën disa hapa.

— Sa shpejt ikën kjo ditë, çudi! — tha si me vete Ahmeti. Pas një çasti shtoi:

— E, ç'thua, ti, Domenik?

— Unë? Asgja.

— S'e ke mendjen këtu, kushedi nga të kullot.

— Eh, eh... Ashtu asht. Tek ti e kam mendjen, te shokët, tek ajo ditë...

«Kjo më gëzon, shok i dashur, nisi të mendojë me vete Ahmeti. Vazhdo ta kesh mendjen tek ajo ditë, ose më saktë tek ajo mbrëmje. Mësove ti, mësuam dhe ne. Edhe ne shpesh kthehemi te ajo ngjarje dhe përsëritim: «Asnjëri të mos mendojë se është i garantuar nga çdo gjë e keqe



dhe nuk ka se çfarë të luftojë në vetëvete». Po, po, asnjëri!»

Por kjo ngjarje nuk ishte e vetmja në këtë kolektiv. Sukseset ata i arrinin nëpërmjet luftës që bënin, para së gjithash, për rritjen e nivelit ideopolitik, luftës për forcimin e mëtejshëm të disiplinës, të rregullit, të shoqërisë ushtarake, nëpërmjet kritikës dhe autokritikës së hapur dhe parimore. Ata gjithnjë i ka karakterizuar qëndrimi dashamirës dhe i rreptë, kërkues ndaj njërit-tjetrit. Po tregojmë edhe një rast, i cili ndikoi së tepërmi në ndërgjegjen e secilit, në forcimin e unitetit dhe kompaktësisë së nënrepartit. Si pasojë ata arritën suksese gjithnjë e më të larta:

## 8. KUDHRA

...Pas konferencës, të gjithë u futën në sallën e shfaqjeve. Estrada e qytetit jepte një program, që e kishte luajtur disa ditë më parë. Nuk po pëlqehet. Në skenë, siç thonin një pjesë, mungonte jeta e gjallë. Pa prituri fundin, Ahmeti i propozoi Domenikut dhe dolën. Në rrugën kryesore të qytetit kishte pak lëvizje.

Maqinës ja arritën në çastin e nisjes. Zbritën në stacionin e fundit. Ecën dhe, aty ku kryqëzohen dy rrugë, qëndruan. Dyqani i vogël ishte hapur.

- Do marrim ndonjë send?..
- Më mirë ecim.
- Dy minuta, s'vonohemi.
- E, po... A, tash po vij në vedi unë: Don

me më qirasë, shoku zëvendëssekretar i komitetit të rinisë! Bukur fort. Shkojmë...

Aty kishte dhe ushtarë të tjerë. Të dy shokët morën nga një gurabie dhe ju afruan grupit që rrinte në këmbë në një cep të dyqanit. Kaluan kështu disa minuta. Në kohën që Domeniku po tregonte diçka, në derë u dha Ademi. Qëndroi. Një çast i mjaftoi të shikonte se kush ishte brenda. Bëri të kthehej, por hoqi dorë. Eci drejt banakut pa shikuar as djathtas e as majtas. Një zë:

— Adem, erdhët?

Zë i njohur ky i Ahmetit. Ktheu kokën. Sytë i nguli si një gozhdë. Nga goja i dolën me ndërprerje këto fjalë:

— Po... Edhe neve... erdhëm!

Ahmeti kuptoi gjithshka. S'kishte nevojë për më tepër. Mjaftoi edhe vetë pamja e Ademit: ato buzë të shtrënguara, ai ballë i vrëjtur i tij. Çdo gjë fliste, çdo gjë ishte e rreptë te Ademi, qortonjëse.

Ahmeti ju afrua. Dësh t'i thoshte diçka. Dësh të bënte diçka në ato çaste... Tjetri u tërhoq pak prapa dhe u bë gati të shpërthente në fjalë, por u përmbajt. «S'është e hijshme. Ç'do të thotë të tjerët» — tha me vete. Xhezmiu e priste në mes të rrugës.

— U vonove, sikur do të ngrije gjithë dyqanin.

— Urdhëro, ke një llokume nga Ahmeti, merre!..

Pas pak doli dhe Ahmeti me Domenikun. Gjatë rrugës nuk thanë asnjë fjalë. Me ta u kthyen në repart edhe shumë të tjerë. Kur po bë-



heshin gati të ndaheshin prej tyre, dikush i thërriti Domenikut. E kërkonte oficeri i rojes.

— Shko, mua më gjen në klasë, — i tha Ahmeti dhe u nis gati me vrap. Aty gjeti vetëm Ademin që po vizatonte.

— Adem, më thuaj... Përse gjithë kjo mospërfillje, përse?

Shoku vazhdonte të punonte. Ahmeti u lëshua si i trullësuar në karrigen që kishte më afër. S'e hapi më gojën. Nisi të bisedonte me vetëveten, nisi t'i radhiste, t'i sistemonte, t'i lidhte ngjarjet. Kuadri i doli parasysh i plotë...

Të nesërmen e asaj mbrëmjeje, pasi mbaroi stërvitja dhe Domeniku bëri konkluzionin, Ademi kërkoi të fliste.

— S'kam për të shtuar gjë. Kryesorja është të mos vetëkënaqemi. E mora më tepër fjalën, sepse kam një kërkesë nga shokët: dje ne prishëm rregullin, erdhëm në mënrepart jo të organizuar. A nuk duhet të na shqetësojë kjo? Me këtë është e lidhur edhe mospërfillja që treguan ndaj nesh, shokëve të tyre, Ahmeti dhe Domeniku. Unë mendoj se s'është keq që t'i shikojmë këto çështje. Këto kanë të bëjnë me ecjen tonë përpara, me forcimin e disiplinës, të rregullit, të gatishmërisë. Mua më duket se e harruam shpejt atë që na ndodhi me Domenikun. Kjo s'na lejonet. Shokët e komitetit të partisë, kur ishin për kontroll, na thanë se bëmë mirë, që mbajtëm qëndrim për atë rast dhe na porositën që të mos e humbasim vigjilencën, por ta forcojmë gjithnjë disiplinën. Nën këtë prizëm ta shikojmë edhe rastin e djeshëm.

— E drejtë — u përgjigjën njëzëri të tjerët.  
...Pas disa orësh u ulën në cep të fushës në formë rrethi.

— Unë kam qysh mbrëmë që pyes veten: «A ishte ajo që ndodhi një keqkuptim apo diçka tjetër»? Dhe s'kam mundur të arrij në një përcaktim të saktë. Tani për tani kuptoj vetëm kaq: është diçka më tepër se një keqkuptim. Dhe them se këtë «diçka» ne duhet ta zbulojmë.

Kështu e çeli bisedën Ademi dhe priti që të fliste ndonjë tjetër. Shokët heshtën. Atëhere vazhdoi:

— Dolëm siç dolën të gjithë të tjerët. Ju kërkuam, por nuk ju gjetëm. Pastaj u kthyem në sallë. Ajo ishte e zbrazët. «Ku shkuan?» — pyesnim veten, ndërsa morëm rrugën për te maqina. Do të kenë ikur përpara», — më tha Xhezmiu. — Ndoshta na presin te maqina». Desha ta besoja, por hoqa dorë, se m'u kujtuan fjalët që tha oficeri para se të fillonte shfaqja: «Nisja do të bëhet në rregull». Në këtë kohë edhe Domeniku ma bëri me dorë, që donte të thonte: «Grumbullimi para klubit». Po ç'ndodhi? Një pjesë nuk u nisën sipas urdhërit. Pati shokë, që nuk e respektuan rregullin, e prishën, bënë sikush me kokën e vet. Kur arritëm ne, maqina sa ishte nisur. Menduam se shokët tanë do të kishin hipur në të, se s'na zuri syri njeri as para, as pas. Na erdhi plasje. Thamë e ç'nuk thamë me Xhezmiun. Nuk do t'ja mbajmë fshehur, do t'jua tregojmë një për një, por thelbi është ky: Rregulli u thye, shoqëria nuk u respektua, ose më mirë, u mbajt ndaj saj një qëndrim mospërfillës. Si, ore, të mos py-



esni ç'u bënë shokët? Po, kështu ju quajtëm ju, shoku Ahmet e Domenik: mospërfillës, njerëz që vini kufi në shoqëri. Le të jemi të gabuar, puna është që ne i thamë dhe po jua themi këto këtu në sy. Më mirë t'ju vijë pak hidhur, se sa të mos jua themi, se pastaj trashen gjërat. Kur ke për ta shkukur e për ta flakur një bimë të keqe, shkule, flake, mos prit t'i shtrijë rrënjët, se pastaj të nxjerr shumë telashe. Kështu qëndron puna. Shoku Ahmet, e dimë, s'është mendjemadh, bile tipari karakteristik i tij është thjeshtësia. Ai dje u zgjodh zëvendëssekretar i komitetit të rinisë. E meriton. Për këtë u gëzuam dhe gëzohemi, sepse është pjesëtar i kolektivit tonë. Por po e them copë: dje sikur u tregua mendjemadh, sikur u deh pak. Dhe kjo u duk sapo dolëm nga shfaqja. I futi krahun Domenikut dhe harroi se kërkohej rregull e disiplinë, se kishte shokë të tjerë. E di ç'na tha njëri pas zgjedhjeve: «Hajde mbaje Ahmetin tani». Kjo ka dy kuptime: hajde mbaje, si njeri që do të aktivizohet më shumë, do të punojë më mirë dhe, «tani atij s'i dilte përpara, s'këmben dot dy fjalë, do t'i rritet mendja». Jo, ne nuk do të lejojmë të bëhesh i tillë, as ty, asnjërin nga kolektivi ynë.

Shokët prisnin që pas Ademit ta merrte fjalën Ahmeti. Por bisedën e vazhdoi Sotiraqi. Ai fliste rrallë, por fjala e tij dëgjohej me vëmendje, me kujdes. Sotiraqi përpiquej gjithnjë të tregojë i përmbajtur, që asnjëri të mos thoshte: «Ka shkollë të lartë, prandaj i pret goja». Ai shpesh përsëriste: «Ne jemi nxënës e mësues në të njëjtën kohë për njëri-tjetrin. Unë mësoj nga ju, ju nga unë e kështu...»

Pra, e mori fjalën Sotiraqi.

— Para së gjithash, duhet të bëjmë të gjithë autokritikë se thyem rregullin, urdhërin. Ne dhama një shembull të keq. Kush më shumë e kush më pak, secili ka pjesën që i takon në këtë faj. Asnjëri, as Ademi që foli, apo Xhezmiu, s'mund të pretendojnë se s'kanë pse të bëjnë autokritikë.

— E drejtë. Ne s'mund të shfajësohemi. — ndërhyri Ademi.

— Kështu, pra, — vazhdoi Sotiraqi. — Ne u ndamë në tre grupe. Pse? Harruam organizimin, rregullin. Unë dola nga shfaqja dhe drejt e tek maqina hyra, bile i pari. Shkova në krye. Nxora kokën në dritare për të parë ndonjë nga ju. Prita gjatë. Nuk pashë asnjërin. I thashë shoferit dhe më çeli derën. «Do vijnë të rreshtuar» — thashë dhe atëhere m'u kujtuan fjalët e oficerit. Autobusi u nis. Shtanga! Ahmeti me Domenikun ishin brenda, kishin hyrë në kohën që unë po zbrisja. Ata ndoshta dhe s'më dëgjuan, kur u thërrita. U nisa pas maqinës. Rrugës takova një shok. Erdhëm duke biseduar. Nga gjithë ajo bisedë më kanë ngelur në mend këto fjalë: «Kini shoqëri të mirë!» Padyshim që këtë mendim ja përforcova, po sa shumë do të më digjte sikur të më kishte pyetur: «Kuj janë të tjerët, pse të kanë lënë vetëm?» Më thoni ju, çfarë t'i përgjigjesha t'i thosha se jemi bërë kokrra-kokrra e po kthehemi secili sipas qejfit? Unë them t'i lëmë mënjanë keqkuptimet. Edhe të tilla ka, po më tepër ato mund të luajnë rolin e justifikimeve, pra të lëmë mënjanë keqkuptimet dhe të kapemi pas çështjeve parimore: pse nuk e zbatuam rregullin, pse s'erdhëm të organizuar, a e



kemi ne shoqërinë në atë nivel që duhet të jetë shoqëria ushtarake, apo jo? Ka apo s'ka Ahmeti, Domeniku, unë a cilido shenja mospërfilljeje për shokët, shenja mendjemadhësie, duhet diskutuar, por më e rëndësishmja është t'i luftojmë këto shfaqje që në embrion, bile të mos presim as sa të nxjerrin kokën. Pra, të kapemi mbas këtij rasti dhe ta shtrojmë çështjen në një plan më të gjerë, ta shohim me syrin: ç'duhet të bëjmë që ne të forcojmë më tej disiplinën, shoqërinë ushtarake, si duhet vepruar që ne t'i mësojmë më mirë, por edhe t'i zbatojmë me përpikmëri kërkesat e rregulloreve. . . »

Folën me radhë, Domeniku e Xhezmiu. Mbe-tej dhe Ahmeti. Shokët dëshironin të dëgjonin, të njiheshin me mendimet e tij. Por ja, Xhezmiu mbaroi, ndezi dhe një cigare me Sotiraqin, dhe Ahmeti dukej sikur akoma vazhdonte të grumbullonte mendimet. Ai e kuptonte se në këtë ngjarje mbante peshën më të madhe. Ai duhej të vepronte si Domeniku dikur, të hapte zemrën siç hapet një libër e shokët të mund të lexonin gjithshka aty. Kjo kurajo atij s'i mungonte, as kurajo për të bërë autokritikë. Vështirësia qëndronte gjetkë. A do të mund t'i bindte ata me arësytimet e tij? A do të mundte t'u vërtetonte atyre se në rastin konkret, dashje ose padashje, ishte bërë shkaktar i thyerjes së disiplinës, kishte shfaqur shenja mospërfilljeje, dhe se ky ishte vetëm një rast, një rast që nuk do të përsëritej më. Pas një çasti foli shkurt:

— Ju më jepni një ndihmë të madhe duke më thënë ato që ndjeni, hapur, ballë për ballë. Kush s'honeps të hidhurën, ai i bën bisht së vërtetës. Dhe

e vërteta është ashtu siç e thatë ju. Unë s'dua as t'u shtoj, as t'u heq gjë fjalëve tuaja. Ato i marr për shfaqje të kujdesit, dashurisë, respektit që kini për mua dhe në radhë të parë për kolektivin. Unë ju propozoj që me këtë rast, po sot, ose si ta shikoni ju, ne të shkëmbejmë mendime se si ta thellojmë më tej punën për vetedukimin tonë, pra të realizojmë atë që tha Sotiraqi: «ç'të bëjmë më tej?»

— Edhe kjo që bëmë s'ishte keq, apo jo? — foli Xhezmiu.

— Përkundrazi, ky diskutim ishte si të thuhesh materializimi konkret i asaj që thuhet se kolektivi është kudhër kalitjeje, — sqaroi Ahmeti.

— Po, po, kudhër kalitjeje.

— Një kudhër e fortë.

— Kudhër, që, pasi del prej saj, e ndjen veten më të përtëritur, më të fortë, më të rritur ...

Dhe pas kësaj ata filluan të ecin përpara, gjithnjë pa u ndalur. Lufta që ishte bërë në kolektiv po jepte frutet e veta, kolektivi po rritej, rritej ndërgjegjja revolucionare, rritej gatishmëria luftarake, aftësia e tyre për të qenë në çdo çast mbrojtës të denjë të atdheut.

## **9. «NDËRGJEGJEN E KE TË QETË, KUR KRYEN MIRË DETYRËN»**

Të nesërmen e asaj dite që Domeniku zhvilloi një bisedë mbi ndërgjegjen revolucionare të ushtarit të revolucionit, ndodhi diçka interesante. Po pregatiteshin të niseshin për në stërvitje. Domeniku kontrollloi bazën materiale, pajimet, gjithshka, dhe



ishte gati të jepte komandën. Në atë kohë një ushtar, që dukej se kishte ecur me vrap, ndaloi para rreshtit dhe tha:

— Oficeri i rojes më porositi që t'ju njoftoj se Ademi do të shkojë në shtab të punojë disa kohë si disenjator. Ai duhet të niset qysh tani.

Fjalët e ushtarit ishin të prera, të qarta, s'kishin nevojë të bëje asnjë pyetje. Dhe Domeniku nuk e zgjati. I dha urdhër Ademit të linte pajimet dhe të nisej. Veprimet u kryen shpejt e në heshtje. Kështu, ndërsa shokët të ngarkuar me instrumente, me helmata në kokë e pushkë në krah u nisën për në stërviçje, Ademi mori rrugën për në shtab. Pasi eci disa minuta, ai ktheu kokën nga ana e kodrës. një shokun e tyre që punon në shtëpinë e oficerëve, në bibliotekë: «E kush nuk punon atje?..» Ju duk sikur këto fjalë nuk ishin thënë për ushtarë. Faqes së saj të përpjetë ngjiteshin shokët. Në çast ju kujtuan fjalët që thonin një ditë dy ushtarë për rin e bibliotekës, po për të; i dukej sikur edhe shokët, që i ngjiteshin me mundim kodrës së pjerrët, po këto fjalë përsëritnin. Por... «Është urdhër, dhe urdhëri duhet zbatuar» — tha me vete dhe shpejtoi hapat.

Në shtab filloi menjëherë nga puna. Qëndronte deri në orët e vona të mbrëmjes. Donte të mbaronte sa më parë, që të kthehej te shokët. Dhe mbaroi. Për këtë i raportoi oficerit të shtabit nga i cili varej. «Si, kaq shpejt?» — tha ai i habitur dhe kontrolloi një për një skemat, grafikët... Mbeti i kënaqur. Ademi kishte punuar shpejt dhe mirë. Pastaj i tha:

— Mirë, merruni me ndonjë punë tjetër, hëpërhë.

Ushitari mblodhi supet. «Me çfarë mund të merrem këtu?» — pyeti vetëveten. Heshti një hop. Pastaj iu drejtua oficerit:

— Më lejoni të shkoj në nënrepart! Kam mbe-tur prapa në stërvitje.

Oficeri nuk ju përgjigj aty për aty, por doli nga zyra dhe u fut në një tjetër. Pas pak u kthye.

— Mirë, shkoni. Do t'ju thërresim përsëri, kur të kemi nevojë. . .

E thirrën pas ca ditësh. Ju desh të qëndronte gjatë përpara zyrave të shtabit, pa bërë asnjë punë. I vinte zor nga njerëzit që kalonin aty pranë. Po ç'të bënte. «Do të presësh, s'ka ardhur shefi» — i thonin. Shefi s'po dukej. Ai kishte shkuar në një nënrepart të largët. U nis të kërkonte Andrenë, zëvendëssekretarin, po edhe ai nuk ndodhej aty. Në kohën që u bë gati të shkante te komisari, takoi një shok. U përçafua me të, donte të bisedonte. Po shoku shpejtohej dhe në ecje e sipër i tha:

— Po shpejtohem, më presin shokët në kodër. Ty të del koha edhe t'i vësh synë diellit, ndërsa ne. . .

Ademit i erdhi shumë rëndë nga këto fjalë. Desh t'i përgjigjej, por u përmbajt. «Ka të drejtë. Unë sot po ngrohëm në diell dhe dielli të ngroh trupin, por jo ndërgjegjen. . .» — tha dhe u nis të shkante te komisari. Ai ishte në një mbledhje. Ju kujtua se Domeniku atë ditë ishte me shërbim. E kërkoi dhe bisedoi në telefon. Ja tha të gjitha, bile edhe se do të kthehej në nënrepart, se ai «s'mund të ngrohej në diell». Por ç'mund t'i përgjigjej Domeniku, kur kjo punë nuk varej prej tij? Veçse edhe ai e këshilloi të takonte komisarin. «Mos u



druej, edhe pse asht në mbledhje, trokit dhe futu brenda». Puna nuk arriti deri atje. Një nga oficerët e shtabit e sqaroi çështjen dhe ai mori rrugën për te shokët. Ndjehej i gëzuar, se nuk do të ndahej më prej tyre, do të stërvitej, do të derdhte djersë, do të kalitej bashkë me ta. «S'do t'i vë më synë diellit. Ndërgjegjen e ke të qetë vetëm kur kryen mirë detyrën!» — tha me vete, ndërsa shkante drejt vendit ku stërviteshin zbuluesit.

Kështu u bënë përsëri bashkë.

## TAKIMI

Ora e takimit me të rinjtë e organizatës së nën-repartit fqinj po afronte. Ata dolën nga klasa duke mbajtur secili në dorë «blokun e vetëanalizës».

Dhe takimi filloi. Minella, sekretari i organizatës, ja dha fjalën Domenikut.

— Ne e biseduem me shokët çka me ju thanë sot. E kena pak vështirë, se vetëm dy muej po bahen që i përdorim «bloqet e vetëanalizës. Pra, s'kena ndonji eksperiencë të madhe. Sidoqoftë... — Domeniku u tregoi si u lindi idea e «bloqeve të vetëanalizës», si u ndihmuan nga komunistët e u nxitën prej tyre t'i futeshin kësaj pune, u tregoi se çfarë u kishte dhënë kjo inisiativë.

— Pikësëpari ne po thellohena ma tepër në mësimet e partisë e të shokut Enver; shpesh e ma shpesh e pyesim veten: «Si po i vemë në jetë këto mësimet?» Ja, unë, po ju tregoj për vedit. I kam shkruar disa gjana këtu, në blok. Po ndalem në një rast...

Të gjithë ndiqnin me kujdes bisedën e Domeni-

kut. Kur ai mbaroi dhe zuri vend, dikush në sallë i pëshpëriti shokut në krah:

— Po tani, ç'thua?

— E mo, s'është kushedi se çfarë. Ditar mund të mbajë kushdo...

— Ashtu vërtet, por jo ditat të tillë...

U ngrit Ahmeti:

— ...Dikush mund të mendojë se këto bloqe s'janë gjë tjetër veçse ditare personale. Deri para pak ditësh, për mungesë eksperience, pothuajse i kemi patur në një formë të tillë. Por, pasi u këshilluam me disa shokë, bile dhe me komisarin e njësisë, u ndalëm dhe e kemi thelluar përmbajtjen e tyre. Pra, po i kthejmë ato plotësisht në bloqe të analizës së vetëvetes...

Pastaj të rinjtë e organizatës fqinje u njohën më konkretisht me bloqet e shokëve, i lexuan, shfaqën mendime interesante dhe vendosën të ndjekin shembullin e tyre.

## 10. — ÇASTE PROVE

Pas takimit ndodhën dhe shumë gjëra të tjera që atyre u vjen mirë t'i përmendin, se tërësia e tyre, po t'i marrësh të pashkëputura nga njëra-tjetra, përbën atë që e quajmë rritje, ecje përpara. Ja disa episode:

Ademi me Xhezmiun do të përcaktonin koordinatat e një pike diku në një vend pas kodrës. Dhe u nisën. Në afërsi të vendit, disa dhjetëra metra, Xhezmiu ndaloi.

— A ndjen gjë, Adem?



— Jo.

— Si? !.

Vazhdojnë ecjen. Përsëri Xhezmiu kthehet nga shoku.

— Po tani?

— Ndjej, po nuk di si ta shpjegoj.

— Diku këtu afër dhe, me sa po kuptoj unë, pikërisht rreth pikës që duhet të arrijmë, ka gaz metan.

— E ç'ka këtu për t'u shqetësuar?

— E di ç'do të thotë gaz metan?..

Dhe Xhezmiu nisi t'i tregonte. Ai, si naftëtar, dinte shumë gjëra për gazin metan. Tjetri e dëgjoi dhe pastaj e pyeti:

— Ç'mendon të bëjmë?

— Ti, si mendon?

— Mos duhet...

— E ke fjalën për kundërgazin?

— I re në të.

— Atëhere të mos e zgjatim... Veçse për këtë duhet të njoftojmë. Bile, unë them që këtë punë të mos e lëmë për nesër...

Veshën kundërgazet. Pika nga do të përcaktonin koordinatat ndodhej pikërisht në vendin ku dilte gazi. Aty punuan rreth një orë në kushte të vërteta luftarake, siç u shprehën më pas. Kur mbaruan, zbritën deri në përrua pa i hequr kundërgazet. Fillonte e përpjeta. Pranë një peme ndaluan. Shikuan njëri-tjetrin nëpërmjet syzeve të kundërgazit. Duart asnjëri s'po i lëvizte. Të dy, në të njëjtën kohë, shprehën një mendim.

— Le të vazhdojmë kështu deri te shokët.

Kjo është në dobinë tonë, edhe pse do djersitemi më shumë apo do lodhemi si tepër...

Një herë tjetër i njoftuan se do të merrnin pjesë në një stërvitje natën. U përgatitën siç duhet. Në pikën e vrojtimit arritën kur ishte errur krejtësisht. Në kohën që po përcaktonin detyrat sipas specialitetit, i mblodhi komandanti.

— Telefonisti «mungon», po ashtu dhe një zbulues. Gjithshka e kërkojmë nga ju...

Kur u largua komandanti, Domeniku pyeti:

— Ç'thoni, shokë?

Siç duket Sotiraqi kishte menduar me kohë dhe kishte marrë një vendim. Ai foli i pari:

— Detyrën e llogaritësit këtu në pikë e kryej unë.

— Linjën telefonike, nga pozicioni i zjarrit deri këtu, e shtrij unë. Edhe telefonin, krahas detyrës që më takon si zbulues, do ta përdor unë. Pse më ka mësuar Xhezmiu mua, për sport? Ja, si erdhi rasti, që edhe detyra e telefonistit duhet të kryhet nga ne... Mendoj se duhet filluar menjëherë nga puna. Ndryshe s'ja dalim dot, — foli qartë Ademi.

Pjesëtarët e kolektivit, kudo që ishin, në pozicionet e zjarrit apo në pikën e vrojtimit, edhe pse u qëllloi të kryenin dy e më tepër detyra, edhe pse pa gjumë e në kushte të vështira, çdo gjë e plotësuan me sukses. Në fund, para gjithë nënrepartit, komandanti i falënderoi. Ajo natë stërvitjeje intensive nxori më në pah ndërgjegjen revolucionare të tyre.



Ata kishin edhe shumë për të më treguar, se jeta e tyre është e pasur, jetë luftarake, në rritje të pandërprerë. Por, një ditë ne u ndamë. Ishte një mëngjez i freskët, tërë vesë dhe ata morën rrugën në drejtim të një kodre të lartë. Atje kishin për të zhvilluar stërvitje, atje do bëheshin më të aftë për t'i shërbyer atdheut si i ka hije ushtarit të popullit.

## VËRSHIM I PANDALSHËM

Kanë kaluar qysh atëhere mjaft kohë, e megjithatë e kam ndjerë veten gjithnjë pranë tyre. Një mëngjez m'u duk sikur edhe bisedova me ta, ashtu si dikur në klasën e vogël përballë fjetores, apo duke ju ngjitur kodrës së veshur me shqopë. Por jo, ky ishte vetëm një vegim i çastit, se me ta më bashkonte e më lidhte tashmë zëri i Namikut, i shefit të tyre. Ai dej t'u shtonte diçka shënimeve të mia që kisha për ta, diçka që të vllente si epilog i këtij përshkrimi.

...Detyra nuk ishte e lehtë. Do të viheshin në provë dijet, aftësia, gatishmëria e tyre. Ata do të përfaqësonin njësinë në garat që organizonte komanda eprore. Pra, ndodheshin në pozitën e ushtarit, që ka marrë urdhër të sulmojë. E që të sulmosh, duhet të kesh zemër të fortë, ndërgegje të lartë, të jesh guximtar, i papërkulur ndaj vështirësive, të jesh i sakrificës.

Ata filluan përgatitjet. Andrenë, zëvendëssekretarin e organizatës së partisë e kishin gjithnjë

pranë, si gjatë stërvitjeve të vazhdueshme, edhe në minutat e pushimit. Komunisti ua rriti më tepër besimin, optimizmin. Ata u bënë më të vendosur.

«Do të fitojmë!» — thanë.

Dhe sulmuan për të fituar me çdo kusht. Objektivit ja arritën, ja arritën me mund e djersë, me sakrifica. Ata merituan flamurin e kuq të komitetit të partisë e të komandës eprore. Në atë flamur ishte shkruar: «Grupit të zbuluesve, që zuri vendin e parë në garat e artilerisë, për vitin 1968». Ky sukses ishte fitore për ta, por edhe për njësinë. Në këtë mënyrë ata i shërbenin forcimit më tej të Ushtrisë Popullore.

U kthyen në njësi krenarë, me zemrën të mbushur plot gëzim, u kthyen siç kthehen ushtarët nga një front i vështirë: më të kalitur, me ndërgjegje më të lartë, u kthyen të gatshëm për t'ju përveshur më me energji e me vrull detyrave të reja, detyrave që e presin çdo çast ushtarin, e revolucionit, mbrojtësin e denjë të atdheut, të fortësës socialiste këtu në brigjet e Adriatikut.



## KËNGA E KËPUTUR...

Për ngjarjen që vjen më poshtë u fol në një nga mbledhjet e organizatës së rinisë. Në kallëzimin e saj morën pjesë të gjithë. Vetëm Ismeti, komandanti nuk kishte si të na kallëzonte. Ai ishte në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve. Po për të na folën vartësit e tij.

\* \* \*

...Frani i thamë ta përsëriste për të dytën herë atë këngë. Ai nuk na e prishi. Tingujt e çiftelisë jehuan. Na dukej sikur i thithnim bashkë me ajrin. Ishte një këngë trimash, një këngë e re, një këngë që fliste për heronjtë e ditëve tona.

Këtë herë Frani nuk e shpuri këngën deri në fund. Ajo u këput, qëkurse u këput një tel i çiftelisë. Sa u dëshpërua shoku ynë! Dësh e bëri çiftelinë dysh. Po ne e qetësuan.

— S'të ka faj çiftelia. Pse u rëndon aq fort telave?

Ai na shikoi si me dyshim. Pandehu se po tallehim. Foli:

— E po, mirë dhe kaq. E vazhdojmë nesër kangën që lamë përgjysmë.

— Nesër duam dhe të tjera, — i thamë.

Por, të nesërmen ai nuk i rregulloi dot telat e çiftelisë, dhe në as që ja zëmë në gojë. Këngën e këputur në mes e vazhduam duke u përleshur me detin.

...Mëngjezi u gëdhi i vrëjtur. Deti gjithë dallgë. Ai dukej si i inatosur dhe dufin e shfrynte në bregun shkëmbor. Ulërinte. Era e shpinte deri larg oshëtimën e tij.

Shërbimin e rojes e mori Frani. Nënoficeri, para se të largohej, e porositi edhe një herë.

— Kujdes!... — dhe vështroi nga deti.

Aty tek bregu, thuajse mbi shkëmbinjtë, qëndronte prozhektori. Shumë mund e djersë desh ndërtimi i pistës së tij. Atë ditë që e vendosëm mbi beton, i thamë Ahirit që do ta drejtonte:

— Tani ti u bëre me sy shumë të fuqishëm.

— Pse, vetëm unë? Prozhektori është dritë për sytë e të gjithëve neve që kryejmë shërbimin këtu, në këtë pikë të bregdetit.

...Frani ju afrua prozhektorit. Dallgët arrinin deri te shkëmbinjtë. «Të tilla kemi parë përherë!» — foli roja me vete dhe shkoi te vendi, duke mos e pakësuar vëmendjen.

Nënoficeri kishte patur të drejtë, kur i kishte thënë: «Kujdes!»... Frani s'pati kohë të rregullonte kapelen, që mënd ja rrëmbeu era. E pa shumë mirë se si u thërrmua një dallgë gjithë shkumë në pistën e prozhektorit. Ajo u tërhoq një çast, u bashkua me një tjetër dhe u sul përsëri përpara. Franit ju duk sikur këtë herë prozhektori lëvizti, sikur atë, së bashku me pistën, e përpinë dallgët. E, të tilla ai s'kishte parë asnjëherë. Ky ishte një vërshim i



vërtetë. Shtresa e pistës po çahet. Prozhektori rrezikohej të përfundonte si lodër për dallgët që hidhnin valle mbi shkëmbinjtë.

Roja dha alarmin. Ushtarët, disa prej të cilëve sapo ishin kthyer nga shërbimi e kishin rënë në gjumë të thellë, veshur e pa veshur, ashtu, të shpejtë si vetëtimat dolën nga fjetorja. S'patën nevojë për urdhër. Prozhektorin e kishin përpara; atë nga çasti në çast mund ta përulanin dallgët. Ai duhej shpëtuar, duhej larguar prej andej. Pista po shembej. Dhe u shemb. Mundi e djersa tashmë u bënë pre të detit. Por prozhektori, jo. Krahët e fuqishëm të ushtarëve e tërhoqën dhe e strehuan në korridorin e ndërtesës. Sa zgjati kjo? Asnjë nuk e mati kohën. Vetëm na kujtohet që dallga nuk na arriti dot. Kur ngjeshi kryet në pistë, atje gjeti vetëm gurë e beton dhe gjurmët tona, gjurmët e këmbëve, e jo të këpucëve. Shumica s'pati kohë t'i vishin ato.

Komandanti ynë, nënoficer Ismeti fshiu me mëngët e këmbës ballin e djersitur. E pamë, kur mori frymë thellë i lehtësuar. Pastaj na bëri shenjë të mblihdheshim para prozhektorit. U mat të na thoshte ndonjë fjalë lavdëronjëse. Ne e vumë re këtë qëkur lëvizti krahun dhe na tha:

— Pa hajdeni, djema!

Po ai s'pati kohë për një gjë të tillë. E kuptoi, ndoshta i pari, se përleshja me detin sapo kishte filluar, se tërheqja e prozhektorit deri në korridor ishte vërtet fitore, por kjo fitore ishte në rrezik të na fluturonte nga duart. Po të vazhdonte vërshimi në ato kushte që ndodheshim ne, s'kishte më vend ku ta çonim prozhektorin. Mbetej vetëm

një rrugë: t'u vinim gjoksin dallgëve, të mos lejonim të na e merrnin me vete. Dhe nënoficeri komunist e parashikoi se dallgët do të vazhdonin «agresionin», ato do të na «sulmonin» edhe në korridor. Foli shkurt:

— Do të boshatisim ndërtesën! Një pjesë: ti, Ahir, Hysen, Tahir, unë dhe ti Fran (detyrën e rojes po e kryente një tjetër) do të qëndrojmë këtu, pranë prozhektorit. Ju të tjerët do të merreni me boshatisjen. E qartë?..

— Po njësitë që do të kthehet?

— Këtu, në prozhektor! Forca e dallgëve është e tmerrshme, ajo thërrmon shkëmbinj. Ne duhet t'i dalim çdo gjëje përpara. Prozhektorin duhet ta mbrojmë, qoftë edhe me jetën tonë!

— Ashtu siç mbrojti Ademi bigën lundruese!  
— ndërhyri Hyseni.

— Po! — thanë të tjerët të vendosur, — ashtu do ta mbrojmë!

Këto fjalë, që dolën nga zemra e secilit, i ngjanin një betimi të vërtetë.

Ndërsa filloi boshatisja e ndërtesës dhe nënoficer Ismeti po caktonte vendet, dallgët e detit e shtrinë pushtetin e tyre edhe në korridor. Në fillim ato vetëm sa lagën çimenton, rrobat e prozhektorit dhe këmbët e ushtarëve. Pastaj...

Pastaj ujët buçiti. Dallgët futeshin në korridor si lokomotiva në tunel, goditnin prozhektorin dhe gjokset e ushtarëve që ishin në ballë. Kur tërhiqeshin, të dukej sikur ishin ngarkuar me një forcë manjetike. Atëhere dhe prozhektori mernte vrull pas tyre, atëhere tendoseshin dhe krahët e Ismetit, Ahirit dhe Hysenit, Franit dhe Tahirit, atë-



here do të dëgjoje mbi zhurmën e detit thirrjet e nënoficerit:

— Mbahuni, mbahuni, shokë! Mbërthejeni mirë, mos e lëshoni!

Dhe forca e atyre krahëve e sillte në vend prozhektorin. Por dallgët s'mbaronin: sa futej dhe dilte njëra, tjetra vinte më e egërsuar. E atëhere, përsëri të njëjtat fjalë, e njejta thirrje:

— Mbahuni!..

Në një çast, sapo dallga ishte tërhequr dhe prozhektori zuri vendin që kishte, nënoficeri dha urdhër të ndërroheshin shokët që ishin në ballë me ata që e mbanin maqinën luftarake nga prapa. Veprimet u kryen shpejt. Në krah të Ismetit zuri vend Frani.

— Po ju, shoku komandant, kush do t'ju ndërrojë?

Kjo pyetje mbeti pa përgjigje. Nënoficeri mundi të shqiptojë vetëm një fjalë, edhe atë jo të plotë:

— Kujde..!

Dallgët sulmuan njëra pas tjetrës me uturimë, s'të linin të merrje frymë; ato sikur donin me çdo kusht të mposhtnin atë grusht njerëzish e të rrëmbenin me vete prozhektorin. Po ushtarët qëndronin, s'tundeshin. Veçse këtë herë ato s'u tërhoqën bosh. Forcës së tyre, Frani nuk mundi t'u bëjë ballë. Ato ja shqitën duart nga hekuri dhe e morën me vete. Ndoshta do ta kishin përplasur diku në shkëmbinjtë, por s'arritën. Pranë Franit ishte shoku, komandanti. Ismeti u turr mbi ato dallgë. Frani e ndjeu dorën që e kapi në shpatull. Kur e mblodhi veten, mundi të thotë:

— Si ndodhi kështu?

Dikush bëri shaka:

— Të gjetën të vogël dhe...

— Kujdes, shokë!.. Ti, Fran, dil mbrapa!..

Kur rrebeshi kaloi, Ismeti ndeshi në sytë e Franit. «Mos i përsërit ato fjalë. Unë do të qëndroj këtu; këtë vend ma ke caktuar mua». Ndoshta sepse ai ja lexoi mendimet Franit, prandaj nuk e përsëriti urdhërin. Vetëm i tha:

— Mirë. Tani shko njofto shokët t'i sistemojnë shpejt materialet dhe kthehu bashkë me ta! Këtë vend do ta ruaj për ty.

Dhe komandanti e mbajti fjalën. Tashmë prozhektorin e mbronin më shumë krahë. Në gjokset e ushtarëve deti i furishëm theu kokën. Më në fund dallgët u tërhoqën të «mundura» dhe s'u kthyen më. Prozhektori shpëtoi, mbeti i pacenuar. Ujët liroi edhe pistën ose vendin ku ajo ishte ndërtuar, bile dhe disa shkëmbinj. Ne i mundëm ato, ne fituam, ne e mbrojtëm me gjokset tona prozhektorin, që na e ka besuar populli.

\* \* \*

U gëzuam sa s'thuhet për fitoren. Përqafuam njëri-tjetrin.

— Po Frani, ku është? — thërriti dikush në ato çaste.

Ai po dilte nga fjetorja e boshatisur, duke i hequr këmbët zvarrë.

— Fran!

Ishte i dëshpëruar. Na u kujtua ai çast kur ju këput teli i çiftelisë dhe bashkë me të vetë kënga.



— Çiftelinë e ka marrë deti! — foli ngadalë.

Të gjithë heshtëm. Dëgjonim shkoqur llokoçitjen e valëve të detit. Ato puthnin shkëmbinjtë si të lodhura. Kjo heshtje nuk zgjati shumë. Që nga vendi ku ngritëm përkohësisht kuzhinën, vinin tingujt e një çiftelie. Frani e njohu, ajo ishte e tij. U nis me vrap, dhe ne pas tij. Këngës, që ai e la përgjysmë një ditë më parë, po ja thoshte Hyseni. Ai ishte kujdesur edhe për çiftelinë. Kur boshatisëm fjetoren, e kishte marrë me vete. Pas vërshimit ja kishte rregulluar telat. Kur na pa se e vumë në mes, ai buzëqeshi:

— Vazhdoje, Fran, këngën e këputur! .

## PËRMES SHËNJESTRËS E FRENGJISË

E njihni atë, Bastriun, ushtarin e pozicionit në rrëzë të shkëmbit? Ja ku po vjen. I paktë në trup është ai, thatim në fytyrë. Kur të flet skuqet. «E, si të ndodhi, Bastri», e pyesim ne. Ai zihet ngushtë, kur duhet të flasë për vete. Sigurisht, ai nuk mund ta marrë me mend se Hetemi dhe Bajrami, komandantët dhe shokët e tij, qysh para se ta takonim, na treguan gjithshka që nxjerr në pah karakterin burrëror të këtij ushtari të thjeshtë.

Retë e ngarkuara me shi shpejtonin drejt jugut. Thellë në horizont kishte shpërthyer rrebeshi. Ushtari, që zbriste shpatit përmes gurëve të bardhë, mendonte me vete: «Po zhuritet toka. Mirë bën të bjerë!» Arriti te pozicioni dhe mori nga shoku detyrën në dorëzim. Zuri vend, i mbërtheu bërrylat në tokën e fortë dhe, përmes shënjestrës e frengjisë, sytë e tij nisën të matnin me pëllëmbë horizontin që nxinte. Një rrudhë që ngrihej vertikale midis ballit, herë thellohej e herë shtrihej. Vëmendja e tij herë përqëndrohej në një pikë të vetme e herë përhapej në horizont në një sektor të gjerë. Vështrimi i mprehtë i ushtarit, duke kaluar



përmes shënjestrës e frengjisë, kontrollonte çdo pëllëmbë të sipërfaqes që shtrihej përpara.

Ai vëzhgonte me atë kujdesin, vullnetin e këmbënguljen e ushtarit të stërvitur, që e quan pozicionin një kala, nga frengjia e së cilës, me sytë e tij, vrojton vetë atdheu. Edhe atëhere kur fusha e pamjes po i kufizohej gjithnjë e më shumë, edhe atëhere kur nisën vetëtimat e bubullimat e forta, vështrimi i tij përpiquej të depërtonte përmes perdes së përhime të shtrëngatës që po afronte. Pikat e para të shiut plluqurisnë në prakun e frengjisë, dhe cirkat ja njomën ballin e faqet ushtarit. Pastaj, ato pika u dendësuan e u dendësuan aq shumë, sa perdja e rëndë e shtrëngatës ja mbuloi krejt pamjen. Në ato çaste të dukej sikur gjithshka do të shembej. Në pozicion kishte filluar të hynte ujë. Megjithatë ushtari vazhdonte të qëndronte me gjoksin e mbështetur pas mitralozit, e sytë nga frengjia. Niveli i ujit në pozicion po ngrihej e ngrihej. Ju njomën këmbët... ujët arriti gjer në gju. Telefoni s'punonte. Linja ishte këputur. Përpara frengjisë ujët dukej sikur binte nga ndonjë katarakt. «Ushtar, mos u lëkund! Ti duhet të vazhdosh të kryesh detyrën!» Ky zë ju duk sikur doli nga thellësia e dheut. Hodhi sytë nga arkat e municionit. Atyre po u afrohej ujët. Shtrëngata sikur donte të shpërthente derën e pozicionit dhe të vërshonte brenda. Bastriu u sul drejt derës dhe e mbylli më fort. Megjithatë niveli i ujit ngrihej e ngrihej. U afrua përsëri te mitralozi, sikur të donte të këshillohej me të. Arma qëndronte e ftohtë, si një shok «memec». Ai e kapi me të dy duart. E provoi ta ngrente. Ju duk i rëndë, më i rëndë nga

ç'ishte në të vërtetë. Megjithatë e ngriti dhe e lëshoi përsëri. Këq i duhej, sa për ta provuar. «Kushedi ç'mund të ndodhë», — mendoi dhe ju afrua arkave të municionit. Edhe pak dhe ujët do t'i arrinte. Sa keq! Atëhere as mitralozi nuk do të vrente. Ushtari, të cilit i ishte besuar ai pozicion, do ta ndjente veten pa krahë, të pafuqishëm. Ç'të bënte? Mori helmetën dhe nisi të hiqte ujët, që vërshonte nga fundi i derës.

Kështu vazhdoi gjatë, vazhdoi derisa një forcë ju duk sikur e shembi përtokë e i rrëmbeu helmetën nga dora. Ai ndjeu se si kërciti dera, se si ujët dhe gurët, që ishin këputur nga shkëmbi, u lëshuan në pozicion me uturimë. Rryma e furishme e përplasi te mitralozi. Dhe ushtari, ashtu vetëtimthi, zgjati dorën drejt armës. Tani qëndronte pothuaj i tëri i kredhur në ujë. Jashtë kishte vetëm kokën dhe mitralozin, që qëndronte me grykë nga frengjia. Arkat ishin mbuluar nga ujërat e turbullta, zalli dhe gurët, që hynin me potere nga dera e pozicionit. Dhe ushtari mori një vendim: «Jo, kjo s'duhet të ndodhë». Këq mendoi dhe kapi me të dy duart mitralozin, si t'i thoshte: «Nuk të braktis, vëllaçko, do të dalim nga frengjia, të njoftojmë shokët... Derën na e kanë zënë shkëmbinjtë...» Dhe i dha mitralozit me tërë forcën përpara. Pastaj, duke u mbajtur pas tij, mbështeti gjoksin në frengji. Në atë çast te dera u dha një rrymë tjetër. Ujët ju përplas me forcë në fytyrë, në gjoks. Ush-tari e përballoi edhe këtë sulm të furishëm të natyrës dhe çau e doli përjashta me mitralozin në duar. Nga frengjia, prej së cilës disa çaste më parë dilte gryka e mitralozit, tani vërshonte ujët, që



kynte nga dera dhe përmbyste pozicionin. Ushtari ktheu kokën pas. Ajo skenë e bëri t'i merreshin mendtë, t'i dukej sikur gurët e shkëmbit, që rrëzoheshin tatëpjetë, binin të gjithë mbi të. Po u përmbajt, nuk u rrëzua.

«Të njoftohen komandanti, shokët. Pozicioni duhet shpëtuar!» Ky mendim e bëri të mos e ndjente peshën e mitralozit, lodhjen, të lagurit që i ishte futur deri në koskë, të mos ndjente dhembjen që i shkaktonte plaga e operacionit, që kishte bërë disa kohë më parë. Por, si të njoftonte?

Pak metra më tej ishte një si kodrinë e vogël. Atë s'kishte rrezik ta mbulonin gurët që këpureshin nga shkëmbi, as rrëkeja s'e arrinte dot. U qep me këmbë e me duar gjer atje dhe e vuri mitralozin në gatishmëri. Hapi zjarr. Mali e përcolli larg jehonën e krismave. «Ata do të dëgjojnë» — tha me vete dhe, pasi u bind se mitralozin e kishte të siguruar, u lëshua si shigjetë drejt pozicionit, te arkat që i kishin mbuluar ujërat dhe gurët.

...Shokët arritën në pozicion. Panë gjithshka kishte ndodhur: panë derën e shkallmuar e gurët në hyrje të saj, panë dhe ujët që dilte nga frengjia. Veç ushtari nuk u pa. Një shqetësim i madh pushtoi zemrën e secilit. E për çfarë s'u shkoi mendja: po t'i kishte rrëshqitur këmba në greminë... po ta kishin rrëmbyer ujërat e furishme të përroit që gumëzhinte përmes shkëmbinjve? Shikuan njëri-tjetrin. Secili sikur lexonte tek shoku mendimet që bluante në kokë: «Po sikur të jetë nisur për në kompani, që të na njoftonte dhe?..» Njëri nga shokët thërriti me sa fuqi kishte:

— O Bastri, ooo!..

Këtë herë mali nuk e përcolli oshëtimën e këtij zëri, këtë herë atë e mbyti një gjëmim i fortë. Po ai që thërriti, s'hoqi dorë. Përsëri shqiptoi emrin e shokut. Dhe Bastriu u përgjigj. Zëri doli nga frengjia, siç dilte dhe ujët e rrëmbyer.

— Këtej, shokë, këtej! Nga dera është e pamundur!..

Nga frengjia ujët vërshoi më me vrull. Ky ishte një vërshim i çastit, i shkaktuar nga zhvendosja që bëri trupi i ushtarit. Të gjithë u drejtuan nga frengjia, duke pritur të shikonin fytyrën e shokut. Por, për çudi, në vend të tij, ata dalluan një arkë municioni, që dukej sikur e shtynte ujët. Disa duar u zgjatën njëherësh dhe e kapën atë. Vetëm kur tërhoqën arkën, ata panë Bastri Jaçellin brenda në pozicionin e përmbytur.

— Dil, Bastri, të futet njëri nga ne! — i thanë.

Por, këto fjalë nuk e arritën. Pas pak tek frengjia u duk një arkë tjetër. Kur u kthye, shokët s'ishin më aty. Ata po «sulmonin» nga ana e derës, sulmonin kundër gurëve dhe ujit që vërshonte, sulmonin për të nxjerrë arkat e municionit e çdo gjë që ndodhej aty, sulmonin për të shpëtuar vetë pozicionin.

...Pasdite, kur dielli shkrepse me shkëlqim mbi majat e maleve, nënoficer Bajrami u ndau ushtarëve teshat për t'u ndërruar. Bastriun e tërhoqi mënjanë dhe i tha:

— Si e ke plagën, ndjen dhembje?

— Jo!

— Do të thërres mjekun, prandaj ndërrohu dhe më prit në fjetore. Ndoshta do të kesh nevojë për pushim.



Ushtari desh t'i thonte diçka, po nuk arriti. Nën-officeri u largua, dhe ai mbeti vetëm, me teshat në duar. Kur doli, shokët po pregatiteshin për të marrë shërbimin. Komandanti i kompanisë, Hete-mi, po i pyeste se kush do të shkonte në vend të Bastriut. Ngritën duart shumë shokë.

— Atëhere po e caktoj vetë, — tha komandanti.

Bastriu kërkoi leje të fliste.

— Unë jam plotësisht në gjendje ta kryej detyrën. Mos më ndani nga shokët!

Ai nuk mundi t'i bëjë dot ballë vështrimit të shokëve dhe të komandantit. Uli kokën dhe qëndroi në pritje, megjithëse e ndjeu se me atë vështrim ata kishin shprehur gjithshka: edhe dashurinë për të, edhe kundërshtimin për ta marrë në shërbim. Ai foli përsëri.

— Ju s'bëtë më pak se unë. Po të mos ishit ju, s'do të ishte as pozicioni. Prandaj...

Vullneti i tij triumfoi.

Natën vonë Bajrami u nis për rrugë. Ai kishte merak për ushtarin. «Do të shkoj ta shoh atje, në pozicion», kishte thënë. Ai zbriti në atë shpat të thepisur, nga kishte kaluar kushedi sa herë. Gjatë rrugës nuk i ndahej përfytyrimi i figurës së ushtar Bastriut, me atë trup të paktë e fytyrë të hequr. Dhe thonte me vete: «E po, të ka faj? I them të më presë se do të marr mjekun, ai i lutet komandantit të mos e ndajë nga shokët. I them se ka nevojë për pushim, ai të thotë: «Jam mirë!» Pa le, po propozoi që të punojë edhe për hapjen e transesë! Eh, këta djema, për ideal, s'pyesin se lodhen, se lagen, se rrinë me orë të tëra në pozicion!..»

Me këto mendime ju afrua pozicionit. Që në unirrjen e parë dalloj shkoqur zërin e fortë të bastriut. «Hë, më të lumtë, o trim!» — foli me vete, ndërsa priste përgjegjësën e ndërresës.

\* \* \*

Kjo ndodhi në një nga muajt e verës. Pas tërë atyre shirave, njerëzit filluan të mblidhnin prodhimet e mbara. Atje në pozicion, përmes shënjestrës e frengjisë, vështrimi i ushtarit kontrollonte me pëllëmbë horizontin. E nëpërmjet atij vështrimi dukej se vrojtonte tërë atdheu.



## VAJZAT E KOMPANISË

Jeta e tyre i ngjan një libri të madh. Ai ka kohë që po shkruhet. Dhe nga ky libër i vajzave të kompanisë po shkëpusim disa fletë. Ato i kanë shkruar vetë radhët e tij, bile, faqet e fundit i nisën këto ditë, kur denoncuam traktatin famëkeq të Varshavës.

«Vajza, rrëmbeni pushkët, atdheu na thërrret të stërvitemi, të forcojmë më tej mbrojtjen e tij!»

Dhe ato i rrëmbyen pushkët.

... Hanëmja, teknike e mesme në fabrikën e çimentos, la turnin e punës dhe u nis për në shtëpi. Ndjehej e gëzuar. Turni i saj atë ditë i kishte dhënë atdheut më tepër çimento, për të çimentuar më tej socializmin. I jati e priti tek dera dhe i dha lajmin se e kishin kërkuar për të shkuar në stërvitje.

— Por më parë hajde të hash bukë, — i tha ai.

— Ajo punë pret, baba, — ju përgjigj vajza dhe u nis me vrap...

Maqinistja e eternitit, Drita po pushonte. Ajo

kishte qenë në turnin e natës. Ajo e ndjeu zërin e një shoqes së saj që e thërriste.

Brofi në këmbë. Pas pak u ndodh ballë për ballë me të.

— Si do të bësh, je pa gjumë?

— Fjalë është ajo? Më prit një minutë...

Flora, punëtore në një linjë të re të kombinatit ecte nëpër rrugët e qytetit tërë hare. Të nesërmen pregatitej të shkonte në festën lokale. Ehi, sa shumë gjëra do të dëgjonte atje, si do të jehonte kënga partizane! Ndoshta këto mendonte në atë çast, kur shoqet e thirrën:

— Flora, në stërvitje!

Dhe ajo e quajti të tepërt të shkonte në shtëpi, vetëm njoftoi me anën e një të njohure.

Ermira, punëtore në kombinat, i kishte akoma të freskëta kujtimet e mbledhjes së organizatës së rinisë për dhënje llogari e zgjedhje. Akoma i dukej sikur dëgjonte shoqet e shokët kur diskutonin, kur kritikonin, propozonin... Në shtëpi u fut me rrëmbim dhe pyeti:

— Kanë lajmëruar gjë për mua?

— Jo!

— Si është e mundur?..

Kur erdhën ta njoftonin, atë nuk e gjetën në shtëpi. Pas një ore u rreshtua përkrah Hanëmes, Dritës, Florës, Aliqit, Hajrijes, përkrah gjithë shoqeve dhe shokëve që kishin lënë punën, maqineritë, turnet, shtëpitë dhe kishin rrëmbyer pushkët për t'u stërvitur. Kështu, punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme të qytetit tani ishin ushtarë të



popullit. Punëtore në prodhim, ushtare në mbrojtje të atdheut.

... Është mbrëmje. Ushtaret e kompanisë janë grumbulluar në një skaj të kodrës. Prej aty, qyteti, fushat e gjera duken si në pëllëmbë të dorës, prej aty shumë prej tyre dallojnë oxhaqet e fabrikave tek nxjerrin tym. Atje në fabrika punojnë shokët dhe shoqet e tyre, kurse këtu ushtaret qëndrojnë roje. Atje gatuhet begatia e atdheut, këtu mbrohet kjo begati me pushkë në dorë. Dhe këtë mbrëmje në roje të fortesës socialiste janë ato dhe bij të tjerë të popullit, që stërviten, që derdhin djersë për të qenë në çdo çast gati. T'i japin plumbin ballit cilitdo që do të guxojë të prishtë rrjedhën e jetës socialiste në qytetet, fushat, malet tona.

Vajzat ja marrin një kënge. Melodia sa vjen dhe bëhet më e fuqishme, më luftarake. Është melodia e një kënge partizane. Sa kuptimplotë është kjo këngë këtë mbrëmje! Sa bukur shkëlqejnë yjet e kuq në kapelet e vajzave të kompanisë!

Në një çast kënga hesht, Hajrija, zbuluesja e kompanisë jep sinjalin e alarmit. Shoqet e saj nisen me shpejtësi nëpër pozicione, secila në postin luftarak. Jepen komanda, urdhëra, pastaj:

— Gati!

— Gati!

Komandanti kontrollon një për një veprimet e numëroreve. Edhe këtë herë, si atë ditë në poligon, kur dolën shkëlqyeshëm në qitje, ai thotë fjalët më të mira për to. Por ushtaret nuk dehen. Ato e dinë se për të arritur shkallën më të

lartë të mjeshtërisë luftarake kanë ende shumë për të bërë. Dhe për këtë u kërkojnë ndihmë shoqëve ushtarë, atyre që janë më të stërvitur, Llambit, Ibros, bile dhe njëra-tjetrës. Ndër to dallohet Hanëmja, jo vetëm si graduate, por edhe si shenjuese, Hajrija si zbuluese dhe telefoniste, Flora si graduate dhe mbushëse. Këto do t'i gjesh gjithnjë pranë shoqeve, gjithnjë të gatshme për t'i ndihmuar, për t'i bërë numërore që të dinë jo vetëm detyrën funksionale, por edhe detyra të tjera.

Gjatë natës ngrihen edhe disa herë të tjera në alarm, e në çdo rast tregohen të shkathëta, të shpejta, sypafjetura. Në mëngjez komandanti u ngarkon detyrën të maskohen vetë dhe të maskojnë pozicionet, të pastrojnë armët dhe teknikën luftarake. Shumë shpejt në kompani, rrugët, pozicionet, teknika dhe ato vetë u mbuluan me gjethe të gjelbëra. Filloi stërvitja. Djersët nisën të rrjedhin nga balli i punëtorëve të reja, i ushtareve të reja. E ato nuk i kursejnë këto djersë, se çdo veprim i tyre është në shërbim të ngritjes më tej të gatishmërisë luftarake. Ato e dinë se vetëm me mund e djersë, me sakrificë ndërtohet e mbrohet socializmi, se vetëm kështu do të bëhen mjeshtër të armëve dhe të mjeteve teknike që u ka dhënë në dorë atdheu, partia dhe populli.

Në minutat e pushimit i shohim ato si diskutojnë me njëra-tjetrën për të përdorur sa më mirë armët dhe mjetet teknike. E tek i dëgjon, tek i shikon se sa mirë dinë të veprojnë, ndjen forcën e tyre, ndërgjegjen e lartë të klasës punëtorë, ndjen dhe sheh qartë figurën madhështore



të vajzës heroike të ditëve tona, e cila di të punojë dhe di të luftojë për Shqipërinë socialiste.

Në të larguar dëgjuam përsëri jehonën e një kënge. Asaj ja thonin vajzat e kompanisë. Ajo ishte një këngë partizane. Dikur bijat e shqipes ja thonin kësaj kënge fronteve të luftës. Pasardhëset e tyre ja thonë fronteve të punës dhe të mbrojtjes, pozicioneve shkëmbgraniti të atdheut.

## USHTARI DHE PUSHKA

Ushtarët u larguan nga objektet për të marrë një sy gjumë. Puna kishte qenë e vështirë. Tokë e fortë, natë e errët. Ata u shtrinë të kapitur mbi fierin e zbutur nga vesa. Roja lëvizte me hapa të qeta disa metra më tej. Nuk kaloi shumë dhe filloi shiu, një shi i rrëmbyer. Ushhtarët u zgjuan. U ngritën më këmbë dhe i kthyen shpinën erës, që i jepte vrull edhe shiut. Aty afër s'kishte strehë. Ujët po u futej në mish. Dikush tha:

— Si t'ua bëjmë pushkëve, municionit?

Një zë tjetër:

— Në objektet do të ketë hyrë ujë.

— Të shkojmë ta heqim.

Komandanti, që i dëgjonte të gjitha këto, poluftonte me vete: «Si nuk morëm asnjë masë? Fundja të kishim ngritur një tendë»... Dhe kjo ishte një çështje që lidhej me kujdesin për jetën e njerëzve, për ata që stërviteshin, hapnin pozicione, rritnin shkallën e gatishmërisë çdo ditë dhe natë, çdo orë dhe minutë. E përse, pas një pune aq vetmohuese, pas gjithë atij mundi dhe djerse të derdhur ushtarët të qëndronin në shi, të



njomeshin vetë dhe armatimi, të qëndronin më këmbë në një kohë kur mund të pushonin, të përtërinin forcat dhe energjitë? «Jo, tha me vete oficeri, kjo nuk është pakujdesi, por diçka më tepër, që lidhet me kryerjen jo si duhet të detyrës nga ana ime si komandant...» Pastaj ai i hodhi sytë nga ushtarët. I tërhoqi vëmendjen lëvizja e atyre që qëndronin në krye. Dëgjoji që dikush tha:

— Ç'po bën ashtu, Bajram, pse e zberthen xhakëtën?

Oficeri shkoi atje ku ishte Bajrami. Ushtari pandehte se ishte shoku vet që kishte në krah, dhe foli:

— Zbertheje dhe ti, xhakëtën!

— Pse?

U panë sy në sy. U njohën. Ushtari tha:

— Më fal, të kujtova Faikun!.. Ku je, mor Faik?

Tjetri ishte përkulur dhe diç kërkonte në tokën e lagur. Pastaj drejtoi trupin dhe psherëtiu:

— Ta hajë dreqi dhe këtë shi!.. Ç'mu bë paguri?...

— Të pihet ujë? Zgjati duart e mbush grushet...! — bëri shaka një tjetër.

Oficeri vuri buzën në gaz. Shikoi Bajramin. Ai rrinte pak i kërrusur me krahët e mbledhur kular rreth gjoksit. Shtërngonte në gji pushkën dhe municionin. I mbronte nga shiu, s'donte që t'i lageshin. Dhe vendi më i përshtatshëm ishte atje, nën xhakëtë. Si do të bënte Bajrami në një natë të tillë, po të ishte me djalin e tij të vogël?

Do ta mbronjte atë me xhaketën e tij, do ta fuste në gji. Edhe pushkën ai kështu, e do shumë. Ajo duhet mbrojtur, ajo i duhet atdheut në çdo çast.

Kur shiu pushoi dhe çeli agimi, Bajrami, Faiku, Hazbiu e shumë të tjerë i nxorën pushkët dhe municionin nga gjokset, si t'i kishin pjesë të trupit. Duheshin pastruar. Edhe ato ishin lagur. Ujë e shiut rrodhi edhe gjokseve të ushtarëve. Por, me se t'i pastronin? Gjithshka, po të shtrydhej, kullonte ujë. Përsëri Bajrami shkoptisi xhaketën. Disa cepa të këmishës ishin të thata. Ato i kaloi nëpër metalin e pushkës, thithën si sfungjer pikat e shiut dhe pushka shkëlqeu përsëri në duart e tij.

Atë mëngjez, para se kompania të fillonte stëvitjen, komunist Petrua bëri një bisedë me efektivin. Ai u foli atyre për pushkën, për pushkën partizane.

— Ne ja merrnim armikut dhe me to e goditnim për vdekje atë; ne i ruanim ato si sytë, ashtu siç e ruajti Bajrami, duke e futur në gji. Para se të hanim bukë, pastronim pushkët. Pushka e pastër s'të turpëron kurrë. Pushka e pastër, fishekët me barut të thatë në duart e njeriut të kalitur politikisht dhe ideologjikisht nga partia jonë, në duart e ushtarit revolucionar e të stërvitur kthehen në një rrufe, që rrezon e copëton çdo armik.

Këto tha Petrua. E pas tij u ngrit Bajrami. Në dorë shtrëngonte pushkën.

— Isha i vogël atëhere. Por e mbaj mend mirë. Fashistët po pushtonin atdheun tonë, ata donin të vrisnin jetën tonë. Njerëzit u sulën nëpër rrugë dhe kërkonin armë, kërkonin pushkë. Por



tradhëtia e kishte bërë punën e saj. E njerëzit i binin gjoksit me grusht. Pushkë s'kishte... Partia i dha popullit ndërgjegjen e lartë revolucionare. Me këtë armë në mendje e në zemër ai u kacafyt me armikun, u armatos me armët e tij, armiku u bë depo e tij. Sot populli, partia, këtë pushkë ma ka dhënë mua në dorë, për të mbrojtur revolucionin, fitoret. Sot gjithshka e kemi në duart tona: pushtetin, fabrikat, tokat, pushkët. Na i dha partia, ajo na udhëheq, ajo na porosit që me pushkë ta mbrojmë revolucionin, atdheun. Dhe unë e shokët e mi s'ka se si të mos e mbajmë në gji pushkën, s'ka se si të mos e ruajmë si sytë e ballit, si paraardhësit tanë, si partizanët...

Nëpër pozicione kishte ujë. Ushtarët s'pyetën, po u futën në to. Përpara nxorën pushkët, automatikët, mitralozët. Prisin në heshtje urdhërin për t'u hedhur në sulm. Dhe ky urdhër s'vonoi. Nga transeja u ngritën ushtarët e u lëshuan me furi përpara mbi «armikun».

## KOMISARI, SHTËPIA DHE DETARËT

### 1

Detarët shkuan në fjetore, ndërsa vetë mori rrugën e shtëpisë. Tek kthesa qëndroi. Në apartamentin ku banonte dritat ishin fikur. Njerëzit e shtëpisë po flinin. Shikoi orën. Po, mes i natës! Lundrimi në det kishte zgjatur. Dhe kishte qenë një lundrim i vështirë. Akoma i dukej sikur po lëkundej mbi kuvertën e anijes. Në bashin e saj dallgët thyenin kokën njëra pas tjetrës...

Nga kujtimet e freskëta të atij lundrimi e shkëputi drita që u ndez në apartament. I shkoi mendja tek e shoqja. «Më pret, akoma s'e ka zënë gjumi», — mendoj. Drita u fik, dhe apartamentin e mbuloi errësira. Një mendim tjetër i ëmbël e bëri ta harronte dhembjen e kokës. Siç duket vajza do të kishte kërkuar ujë. Eh, sa herë ishte ngritur gjatë netve për t'i afruar vogëlushes pranë buzëve gotën me ujë! Ja tek i hapi sytë ngjyrë deti, ja dhe zëri i saj nëpër gjumë: «Ele, babi?» Ai lëvizi dorën si t'i lëmonte asaj flokët e butë dhe shpejtoi hapat. Por, zhurma e tyre në kalldrëm nuk zgjati.



Ai përsëri qëndroi. Diç ju kujtua, diç i kujtuan sytë e vogëlushes. Aty për aty mori një vendim dhe u kthye. Tashmë era që vinte nga deti nisi t'i rrihte fytyrën.

2

Detarin, që kryente shërbimin në fjetore, e gjeti pranë krevatit të një shoku që ishte zbuluar. E la sa mbaroi punë dhe, me zë të ulët, e thirri të afrohej. Detari u habit kur pa komisararin. I shkoi mendja se mos ai ishte kthyer të kontrollonte njerëzit e shërbimit. «Por, ç'ne, thoshte me vete, ndërsa shkonte drejt tij, ai s'ka gjysmë ore që është larguar?!»

— Kanë rënë të gjithë? — e pyeti komisarari, sapo detari filloi të raportoje.

— Po, siurdhëron!

— Edhe Vangjeli?

Detari e vonoi përgjigjen. Kjo e piku në zemër komisararin.

— Të pyeta për...

— Po, edhe Vangjeli. Ai bashkë me Aqifin erdhën pak me vonësë, dhe s'ka shumë që i ka zënë gjumi.

Nuk pyeti më. Eci me kujdes nëpër fjetore, duke shikuar nga krevatet ku flinin detarët. Qëndroi pranë atij të Vangjelit. Detari kishte rënë në shpinë. Krahët i mbante mbi gjoksin e mbuluar. Detari që ishte me shërbim s'po kuptonte asgjë, bile thoshte me vete: «E, po tani, më zure besë? Ja ku është dhe Aqifi, shikoje dhe atë. Me njëren

dorë ka kapur hekurin e krevatit dhe ndoshta i duket vetja sikur është akoma në lundrim».

Komisari, pa e ditur se ç'mendonte detari që i rrinte pranë, zgjati duart, ngriti batanien e Vangjelit dhe i mbuloi kraharorin dhe njërin krah. Tjetrin ja la zbuluar. Druhej t'ja prekte. E këshilloi dhe detarin:

— Më mirë le ta mbajë ashtu. Nën batanie dora do t'i nxehet e do të ndjejë dhembje. Dje-gja është e keqe.

Detari vazhdonte të mos kuptonte gjë. Ai s'kishte qenë në lundrim, dhe s'dinte ç'kishte ngjarë. Kur e kishte parë Vangjelin me dorën të lidhur, e kishte pyetur, po ai pa të keq i ishte përgjigjur:

— Një gërvishje, gjë pa zarar.

Fjalët e komisarit e bënë të zemërohej dhe të qortonte vetëveten pse ishte treguar aq i pakujdesshëm për shokun, pse ishte mjaftuar vetëm me një pyetje: «Ç'të ka dora, Vangjo?» Po tashmë ishte vonë, i vinte zor të pyeste komisarin, që ishte kthyer nga rruga vetëm për të parë Vangjelin. Qëndronte si në gjemba. Druhej se mos komisar i kërkonte prej tij ndonjë shpjegim. Por komisar i, sapo ja pa dorën të lidhur detarit, u qetësua. Ai ktheu edhe një herë kryet nga krevati i Vangjelit dhe i Aqifit, i shtrëngoi dorën detarit që kryente shërbimin në fjetore dhe mori përsëri rrugën drejt shtëpisë.



Kujtimet e asaj dite nuk i ndaheshin, ashtu siç nuk i ishin ndarë anijes në lundrim dallgët gjithë shkumë. Ato po e sulmonin si të ishin tallaze, ato po e çonin përsëri mbi kuvertën e anijes, nëpër postet luftarake të detarëve, ato sikur ja kishin larguar edhe dhembjen e kokës, që i pat filluar diku, në mes të detit. Edhe pse shkelte në kalldrëm, edhe pse ndjente fëshfëritjen e pishave, që shkaktohej nga era që vinte nga deti, ai prapë-seprapë në ato çaste me mendje dhe zemër ishte në lundrim...

Ja, anijes ju caktua një kurs i ri. Të gjitha llogaritjet u bënë shpejt. Komandanti që e drejtonte atë, një djalë energjik, dha urdhër të ecej përpara me të gjithë shpejtësinë. Dhe anija çau kreshtat e dallgëve si shigjetë. Komisari ndiqte çdo veprim të komandantit dhe të detarëve. Ai e ndjente, bile e shikonte me sy, se si anija, në duart e këtyre njerëzve, kthehej në një forcë të pandalshme në shërbim të atdheut. Ai zbriti në lokalin e motorëve. Temperaturë e lartë, zhurmë shurdhuese. Sa u fut brenda, pa edhe dy fytyra të rrepta detarësh. Diçka u foli, por ata më tepër e morën me mend se sa e dëgjuan. Përgjigjen e pyetjes që u bëri e gjeti në sytë e tyre: «Në rregull, shoku komisar!» Këto sikur lexoi në ata sy dhe vuri buzën në gaz. Pastaj ua bëri me dorë, si t'u thoshte: «Ashtu, trima!» Se trima ishin tre-guar ata atë ditë që ishte çarë skapamentua e motorit kryesor dhe, në kushte të vështira, midis temperaturës së lartë e gazrave që të mërrnin fry-

mën, kishin kryer detyrën. Trima tregoheshin ata në çdo lundrim, trima u treguan edhe atë ditë, pak minuta pasi ishte larguar komisari...

Vangjeli zbatoi dhe komandën e fundit. Motori mori xhirot e nevojshme. Të gjitha instrumentet funksiononin në rregull. Por, ja, diçka e papritur. Tubacioni i ujit të ëmbël doli nga vendi. Sakaq lokali po mbushej me avuj të nxehtë. Vangjeli thirrri me tërë forcën:

— Aqif! — dhe, pa pritur të merrte përgjigje, u afrua te tubi dhe e mbërtheu me duar. Avulli që dilte me forcë nisi ta shpojë si me turielë, ta djegë, po ai e duroi dhembjen, nuk e lëshoi tubin. Ai e mbajti atë dhe nuk e la ujët të rrjedhë, derisa arriti Aqifi me një shuk leckash. Pastaj i bashkuan të dyja duart. Ujët e ëmbël tashmë filloi t'i shkonte i tëri motorëve.

— Duhet njoftuar komandanti, Aqif!

— Mirë, shko ti, për tubin dhe motorët kujdesem unë.

Anija e zvogëloi shpejtësinë, e pastaj nisi të lëkundej midis dallgëve me motor të shuar. Në lokal u futën komandanti dhe komisari. Vangjeli me Aqifin nuk i vunë re. Ata vazhdonin të rregullonin tubacionin.

— Do të zgjatë shumë, djema? — pyeti komandanti.

Detarët e njohën në zë. Kthyen kokën:

— Gati, shoku komandant! — ishte përgjigjur Vangjeli duke shtrënguar çelësin me dorën që i digjte.

— Ashtu?!

Pastaj në lokal u dëgjua zëri i komisarit:



— Ku i ke lekat, Aqif, me çfarë e kape tubin?

— Unë ...

Vangjeli e pat ndërprerë shokun me qëllim:

— Ç'do gjë është në rregull, shoku komisar. Të vazhdojmë lundrimin.

Dhe anija çau përpara me shpejtësi, derisa plotësoi detyrën...

Komisari këto i mësoi kur pa dorën e lidhur të Vangjelit e, mendimi se motoristët detarë janë trima, ju përforcua më tepër, bile ai këtë e përsëriti edhe një herë, kur doli në kthesë dhe pa apartamentin ku banonte.

Atje ai çeli vetëm dritën e abazhurit. U zhvesh. Para se të shtrihej ktheu kryet nga krevati i vogëlushes. Mbi komodinë ishte gota me ujë. Ju duk sikur vajza lëvizi dhe diç foli nëpër gjumë. Atij ju bë sikur dëgjoji qartë:

«— Ele, babi?»

Ju afrua më pranë, e puti lehtë me buzët që ja kishte rrahur era e detit, ja futi të dy krahet nën çarçaf dhe belbëzoi:

— Po, erdha, vogëlushe.

Pas pak, në apartament drita e abazhurit u fik. Tashmë po zbardhte agimi.

## TAKIM ME VETERANIN

Në dhomën e kulturës u bë qetësi. Sakua, sekretari i organizatës së rinisë mori fjalën. Ai u paraqiti të rinjve veteranin dhe u tregoi se takimin në prag të jubileut veterani e kishte pritur me kënaqësi.

Të gjithë kthyen kokën nga këndi i 25-vjetorit. Veterani ju afrua standës dhe tregoi një fotografi. Dukej një faqe mali gjithë gurë e shkurre dhe disa partizanë, që ecnin në të përpjetën thikë. Në fotografi ishte fiksuar një çast, kur mitralierin partizan po e ndihmonte një shok të ngjitej në një shkallë të gurtë. Poshtë fotografisë ishin shkruar këto fjalë: «Drejt aksionit».

— Po! — tha veterani, pasi largoi vështrimin nga fotografia. — Ata shkojnë drejt aksionit. Ndoshta në qafën e malit ata do t'i zënë pritë armikut. Ndoshta, diku, mund të jenë rrethuar shokët dhe po i dalin armikut pas shpine. Ose, edhe kjo ka mundësi, kësaj skuadre partizane i është ngarkuar detyra të hedhë në erë një urë, një depo, një kazermë të armikut... Sidoqoftë, ata shkojnë në aksion. Mirë ju ka shkruar në mend që i kini vënë



fotografisë atë diciturë. Partizanët ishin njerëz të aksioneve. «Pa bukë le të mbetemi, pa përleshje jo!», «Mos ju nda armikut. Të doli në shteg, jepi plumbin ballit!» — Këto e sa e sa shprehje të tjera i dëgjoje shpesh atëhere nga goja e partizanëve... Kur niseshin për në aksion, s'kishte forcë t'i përmbante. Jeta për ta s'kishte kuptim pa aksione, pa përleshje. Edhe gëzimin më të madh atëhere e ndjenin, edhe këngët më të fuqishme atëhere shpërthenin. Kur fillonte aksioni, ata bëheshin luanë...

Kjo fotografi më solli ndër mend shumë gjëra, bile edhe diçka, që ndoshta s'do t'jua kisha treguar. Se, helbete, kanë kaluar vjete të tëra dhe shumë gjëra na kujtohen kur na i kujtojnë të tjerët ose, siç është rasti i kësaj fotografie. Ajo po më shpie si me vrap në thellësinë e viteve e po më duket sikur edhe unë po eci si këta partizanë, drejt pritës...

Korrieri i shtabit i kishte arritur ata ndanë një pylli. Matanë, në një pllajë, ndodhej fshati ku kishin ndër mend të qëndronin atë natë. Ishin pa ngrënë. Gjithë ditën kishin ecur. Disave këmbët u kullonin gjak, se u ishin prishur opingat. Ecnin zbathur. Dy shokët që ishin plagosur një ditë më parë, rënkonin, plagët u ishin mavijosur. Vetëm për ta kishin një krodhe bukë misri.

Në këto kushte, ja dhe urdhëri i ri. Ai ishte i shkruar në një copë letër të vogël, që e mbante në dorë komisari. Të dy me komandantin e lexuan dhe e rilexuan atë letër, sollën në mend marshimin që kishin bërë, çantat bosh të partizanëve, të plagosurit, këmbët e enjtura të shokëve. «Mën-

gjezi ta zërë kompaninë në rajonin «N». Ne jemi të rrethuar. Mos lejoni të kalojë kolona armike. Asgjësojeni. Kështu ne do të mund të çajmë rrethimin»

Kompania u mblodh. Komisari vështroi partizanët. Të plagosurit s'po ndiheshin më. Ata kishin kërkuar t'i vendosnin sa më pranë lisit ku u mblodh kompania. Vështrimi i tyre u ndesh me atë të komisarit. Atyre ju duk sikur u depërtoi në zemër një flakërimë drite. Bënë të ngrihen. Krahët e shokëve ju erdhën në ndihmë. Tani kompania i ngjante një bloku. Gjokset u shtrënguan me njëri-tjetrin. Komisari foli:

— Shokë! Edhe sot duhet të ecim! Na pret një detyrë e re... Edhe sot... Jemi pa bukë, kemi dy shokë të plagosur, disave... A ka ndonjë që s'mund të ecë? Le të na presë këtu, ose në fshat. Ne do të kthehemi përsëri. Ndoshta nesër në mbrëmje. Mos ngurroni. Rruga që do të bëjmë është më e vështirë, Natë. Udhëheqës s'kemi. Pastaj...

Përgjigja e prerë:

— Të ecim!.. Të gjithë! Të asgjësojmë kolonën armike. Të shpëtojmë shokët e rrethuar. Shokët e plagosur do t'i marrim në krahë!..

— T'ja marrim këngës, djema! — oshëtiu si bubullimë zëri i një partizani aty nga mesi dhe filloi i pari:

*Ne jemi partizanë,  
Atdheut i dalim zot...*

Një kor i fuqishëm e ngriti më lart këngën e filluar dhe bëri të buçasë pylli, që po kridhej në errësi.



*Një yll të kuq kemi në ballë,  
Në krahëror zemrën barot...*

Buçitja e kësaj kënge u dëgjua gjer në fshatin pranë. Ajo hyri në çdo zemër si një afsh i ngroh-të. Të gjithë thanë: «Po vijnë partizanët!» Dhe deri vonë u ushqyen me dru zjarret në vatër, deri vonë mbetën dhe sofrat pa u shtruar, deri vonë ndonjë nënë arnoi këmishën e të birit, për bijt që priste, deri vonë edhe xha Zyka qëndroi në oborr duke rregulluar disa palë opinga... Pastaj dritat e kandileve nëpër konakët nisën të fikën një e nga një.

Ndërkohë kompania partizane i ngjitej një monopati...

Pa zbardhur mirë dita, kolonës armike ju zu prita në të dy anët e rrugës automobilistike. Aty fillonte zbatimi i detyrës së re.

Dhe veterani vazhdoi:

— Ashtu siç rrija shtrirë, prapa një guri, me sytë nga kthesa, nga do të vinin maqinat naziste, m'u afrua komisarit dhe më tha të shkoja te të dy të plagosurit. Ata nuk duhej të futeshin në luftim. S'e bëra dy fjalën e tij. Ai zuri vendin tim, ndërsa vetë, përmes një përroi që kisha aty pranë, shkova pas kodrës. Të plagosurit s'i gjeta. U bëra vrer. U ktheva dhe i raportova komisarit. E pashë që u prish në fytyrë. Këtë ndoshta s'e priste. Tha:

— I porosita të mos luanin nga vendi. Të zinin pozicion atje, prapa kodrës. Për çdo të papritur, ata, me aq sa të mundnin, të na mbronin nga ai krah.

Ai desh të shtonte edhe diçka, po s'pati kohë.

Partizanët që ishin në kthesë njoftuan për afri-  
min e autokolonës. U largua nga pozicioni im duke  
më porositur:

— Shko dhe një herë! Po nuk i gjete...

Nuk e çoi mendimin deri në fund. Në kthesë  
uturiu maqina e parë. Pas pak një tjetër, një e  
tretë, e katërta... S'i numërova më. Nazistët, mbi  
maqina, po më kalonin shumë pranë. U dalloja  
qartë fytyrat, helmetat, pushkët që i mbanin midis  
gjunjëve. Mora në shenjë disa prej tyre. Në dorë  
mbaja granatën. «Ah, sikur t'ua vërvit tani» —  
thosha. — Po urdhëri vonoi edhe pak, aq sa e gji-  
thë autokolona u fut në pritën që i kishim pregati-  
tur. Pastaj e gjithë xhadeja sikur mori flakë. Kër-  
citën bombat, mitralozët, pushkët e bashkë me to  
u dëgjuan ulërime, thirrje, kërcënime. Disa maqina  
u mbuluan nga flakët. Megjithatë, nazistët e mblo-  
dhën veten, filluan rezistencën. Në krahun tim të  
djathtë disa prej tyre, duke shfrytëzuar përruan u  
sulën përpjetë. E lashë gurin dhe vazhdova rrugën  
deri te një shqopë. Prej andej, ma hante mendja, do  
ta mbyllja kalimin në përrua. Një zë më bëri të  
qëndroja në vend. Ishte zëri i komisarit.

— Ulu!

Kaq dëgjova. Pastaj shpërtheu një granatë.  
Kur e mblodha veten, (kjo zgjati fare pak), ndjeva  
në shpinë peshën dhe frymëmarrjen e një njeriu.  
Ishte komisarit. Më kishte mbrojtur me trupin e  
tij. Vetë kishte marrë plagë të lehta.

Me nazistët që na kishin hedhur granatën  
i kishin qeruar llogaritë shokët. Kufomat e tyre  
qëndronin në përrua.



— Tani, nisu! — më tha. — Nga krahu tjetër nazistët po ngulmojnë të çajnë përpara. Duan të na dalin në shpinë. Shko, atje janë shokët e plagosur...

Kur dola në kodër, buçitën tingujt rrëqethës të bories. Ajo i thërriste shokët të hidheshin në sulm. Dhe unë ktheva kokën pas. Dëgjova si gjë-muan fjalët — kushtrim: «Para partizanë!» Pashë se si për një çast bisha e plagosur naziste u hutua, pastaj nisi të copëtohej. Ata që mbetën gjallë, o ngritën duart, o morën vrapin. Zemra më rrihte fort në krahëror. U sula të kërkoja shokët e plagosur, t'u jepja lajmin e fitores, u sula, por... Në faqen e kodrës s'pipëtinte njeri. «Ku janë?» — thashë dhe flokët m'u ngritën përpjetë nga një shqetësim plot ankth. Ku s'më shkoi mendja. «Po sikur?...» Nisa të ecja pa ditur se ku, bile fillova të vrapoja, të thërrisja. Pas pak m'u duk se më ngriu gjaku. Disa metra më tej pashë trupin e një nazisti. Pranë tij edhe një tjetër. Jo shumë larg, një i tretë tërhijej zvarrë dhe rrënkonte. Automatikun e kishte në dorë. Kur më ndjeu, u përpoq të kthehej dhe të hapte zjarr, po s'arriti. Plumbi im e bëri ta ngulte kokën në tokë për të mos e ngritur kurrë më. E kuptova se ata kishin depërtuar andej nga më tha komisari. Por, aty i kishin pritur pushkët e shokëve tanë të plagosur. Ata, pra, kishin mbrojtur shpinën tonë. Të gjitha këto dukeshin qartë. Çdo gjë rreth meje sikur kishte gojë e fliste. Por, për një gjë askush s'më jepte përgjigje: «shokët ku janë?»...

Dola në kodër. Në xhade digjeshin maqina. Tymi i tyre i zi ngjitej lart. Krismat kishin pu-

shuar. Partizanët po grumbulloheshin në një shesh të vogël, Midis tyre dallova komisarin. Diç u thoshte. Vendosa të mos zbrisja! Ku të shkoja pa shokët? Nisa përsëri kërkimin. Këtë herë në drejtim të kthesës, andej nga u duk maqina e parë. Dhe bëra mirë. Ata ishin pikërisht atje. Kishin një copë herë që ma bënë me dorë, që më thërrisnin e unë as i shikoja e as i dëgjoja. As mund ta merrni me mend gëzimin që ndjeva. Ata ishin gjallë! Më pas më treguan se si i kishin pritur dhe vrarë nazistët, që u përpoqën t'i merrnin krahët kompanisë. U habitën kur mësuan se njëri prej tyre vetëm sa ishte plagosur.

... Afër mesditës kolona jonë u nis drejt fshatit, ndanë të cilit kishim kaluar një pasdite më parë.

Veterani nuk foli më. Po edhe të rinjtë s'po ndiheshin. Sakua ndërhyri:

— E po, tani e kini ju radhën, ç'pyetje keni?

Në këtë kohë tek dera u dha nënoficeri i shërbimit. Ai njoftoi se kishte vajtur ora. Shumë nga ushtarët do të merrnin shërbimin.

— Mirë, shokë, ka pyetje? — përsëriti Sakua.

Pastaj ai nisi të numërojë duart që u ngritën.

— S'ka nevojë, foli qetë-qetë veterani. Unë do të vij përsëri. Një herë tjetër...

Ndërsa veterani u nis drejt qytetit, të rinjtë, me këngën partizane në gojë, u rreshtuan për të marrë shërbimin:

*Ne jemi partizanë,  
Atdheut i dalim zot...*



Ditën që u bë takimi me veteranin, komisari me komandantin ishin në shtabin e repartit. Ushtarëve s'u shqiteshin nga mendtë episodet rreth pritës partizane.

— Po si nuk na u dha ta pyesnim për vendin? Kjo na shpëtoi; këtë s'duhej ta linim pa e mësuar! — i thonin një ditë komisarit disa ushtarë.

— Unë e kisha shënuar këtë pyetje, po ku të linte Sakua! — u hodh sakaq Ndrekua, (shënjuet mitralozi) që ishte shpallur «kampion» i kompanisë në kalimin e brezit të kalitjes.

— Edhe unë, mor shok, doja ta dija atë vend, se më vjen sikur kam kaluar atje — foli mendueshëm Qazim.

— Po të kesh kaluar, domethënë se ke qenë partizan. Je i madh në moshë ti — e ngacmoi një tjetër.

— Ama, ç'na the!... Po ne nuk kemi kaluar nga kthesa e xhades, kur bëmë stërvitje.

— S'e ke keq, Qazim. Atje duhet të ketë edhe lapidar, — ndërhyri Sakua.

— Më thuaj, të lutem, shoku sekretar, ku nuk ka lapidar?

Sekretari u zu ngushtë. Ndërhyri komisari:

— Kjo është një çështje që zgjidhet; bile qysh tani: ja numri i telefonit të shtëpisë së veteranit. Shko, Sako, ndoshta është aty dhe pyete!

Përgjigja nuk vonoi. Vendin ku ishte bërë prita e autokolonës gjermane e mësuan të gjithë. Ai ndodhej disa km. larg, po jo tek kthesa e xhades.

— Jo, tha Qazimi, atje s'kam qenë.

— Fundja, pse të mos shkojmë, — foli Ndreku. — Stërvitjen taktike, disa ditore; do të ishte mirë ta zhvillonim në atë rajon.

— Vëri pikë, Ndreko!

— Ju shfaqët një mendim interesant! — vërejti komisari pas pak. — Po, po, këtë çështje do ta diskutojmë kolektivisht në mbrëmje, — përfundoi ai.

...Në krye të javës, në një ditë që frynte dhe shiu binte me rrëmbim, kompania u ndodh ndanë pyllit, atje ku ishte mbledhur dikur kompania partizane. Veçse kompania e brezit të ri nuk e vazhdoi marshimin. Detyra ishte e tillë, që duhej të qëndronte. Megjithatë ushtarët u porositen që, me sinjalin më të parë, të linin punën për hapjen e pozicioneve dhe të qëndronin në gatishmëri për nisje. Ndoshta nëpër rrugën që kishin kaluar partizanët! Ky urdhër u dha shumë vonë, atëhere kur të gjithë i kishin humbur shpresat e nisjes...

Moti ishte qetësuar. Shi nuk binte. Nëpër qiell retë vraponin sikur shtynin njëra-tjetrën. Aty-këtu, nëpër copat e qiellit xixëllonin yjet. Kolona marshonte me shpejtësi. Në krye ecte komisarari. Komandanti ishte nisur një orë më parë për në shtab. Prej andej, ai kishte njoftuar që kompania të fillonte marshimin e sforcuar. Të gjitha këto i dinin ushtarët. Por ata akoma s'po e kuptonin nëse po ndiqnin ose jo rrugën që kishin bërë partizanët. Komisarari, si të kishte qenë në mendjen e tyre, aty ku mbaroi e tatëpjeta, dha urdhër të mbledhesh kompania. I fundi u fut në



rresht Qazimi. Shokët i bënë vend. Komisarit nuk i shpëtuan pa dëgjuar fjalët e Ndrekos:

— Kur të hedhim përroin, qëndro pas meje!

— Mirë.

— Të dhemb?

Qazimi nuk u përgjigj. Mori drejtqëndrim dhe shikoi komisarin në sy. Ishte errët dhe s'e dalloi dot mirë, po e kuptoi se komisari diç donte të pyeste me atë shikim. Me vete tha: «Ata ishin pa ngrënë, zbathur dhe s'e dhanë veten, po unë që...»

— Mos je i pamundur, Qazim?

Zëri i komisarit ja ndërpreu mendimet. U zungushtë. S'dinte si t'i përgjigjej. Ndërhyri Ndrekua:

— Pak më lart u pengua dhe ka vrarë këmbën. Rrëshqiti keq... Sidoqoftë, ma ha mendja se mund të ecë.

— Po, po! Ashtu. Unë mund të eci, ja!... Dhe bëri dy hapa... S'më dhemb...

Komisari e vuri re se ushtari, kur bëri hapin e dytë, shtrëngoi nofullat.

Kodrat, përfund të cilave kalonte rruga automobilistike, u morën me sulm. Në orën e caktuar komandanti i kompanisë njoftoi shtabin epror. Atje ishte komisari i njësisë.

— Le të mbliidhet kompania tek kthesa, porrositi ai. Më pritni!

I gjeti të rreshtuar. Bashkë me të zbriti nga maqina dhe një burrë, që ushtarët e njohën menjëherë. Ata thanë:

— Veterani!

Po, ai ishte. Ecte në krah të komisarit dhe nuk ua ndante sytë ushtarëve. Shumicën ua mba-

nte mend fytyrat. Veçse, sikur s'ishin më ata të dhomës së kulturës. Duke qenë në rresht, me helmata në kokë, me pushkët në krahë e ato kapota të hedhura kular, atij i dukeshin si më të rritur, me tipare më burrërore.

— Shiko, ç'djem që janë. Pishë e kanë synët! — tha.

Komisari pohoi me kokë dhe bëri më përpara, që të merrte raportin nga komandanti i kompanisë.

Aty, tek kthesa e xhadesë, komisar i dhe veterani mësuan nga ushtarët se si kishin vepruar gjatë stërvitjes, si e kishin kaluar gjatë marshimeve, duke mos lënë këtu pa përmendur punën e Qazimit.

— Mos është ai, që u nis për në spital para se të fillonte sulmi? — pyeti komisar i.

— Po!

— Si, ore?... M'u desh të ndërhyja edhe vetë, që të shkonte. «Ja, gjurin e mjekova, pse të vete kot në spital» — thoshte. Donte të ishte patjetër këtu, me ju. Siç duket e kuptoi që shoku Ramo do të vinte t'ju takonte... Meqë erdhi fjala, po ju them se shoku Ramo ka ardhur posaçërisht për t'ju treguar këtu, në vend, pozicionet e partizanëve gjatë pritës, pozicionin e tij, atë të dy shokëve të plagosur...

Atë ditë ushtarëve ju duk sikur i dëgjuan edhe një herë tingujt e borisë partizane. Ajo sikur i thërriste edhe ata për t'u hedhur në sulm...



## SHTIGJEVE PARTIZANE

15 shkurt

Nuk mund t'i shkruaj dot të gjitha. Koha sikur po fluturon. Ne atë nuk e ndjejmë. Është ditë me tension, plot gaz, ditë jo e zakonshme. Nesër më 16 shkurt 1966 fillojmë marshimin, nise-mi drejt shigjeve partizane. Nesër ne do të quhem partizanë të Brigadës së parë sulmuese. Ja burimi i emocioneve tona.

...Kolonat e të rinjve dhe të rejave futen në oborrin e gjerë të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve «Enver Hoxha». Ngado gjallëri, lëvizje, këngë. Shkolla ndërron pamje. Ajo shkëlqen jo aq fort nga dielli i ngrohtë, jo aq fort nga faqja e bardhë e ndërtesave. Atë e zbukurojnë, i japin shkëlqim të veçantë njerëzit që sapo futen: qindëra të rinj e të reja të ardhura nga të katër anët e atdheut. Të duket sikur këtu sot është grumbulluar i gjithë gazi, hareja, gjithë rinia. Të duket sikur thith aromën e fushave e freskinë e maleve, ndjen të rrahurat e çikrikëve të kombinatit e zhurmën e uzinave. Aty sikur e prek me dorë marshimin socialist të atdheut.

Shikoj me radhë fytyrat e të rinjve, ndjek nga afër lëvizjet, bisedat e tyre, dëgjoj këngën vlonjate apo atë shkodrane, ndjek me ëndje bisedat plot zjarr, shakatë e bukura. Qëndroj një copë herë atje ku merren rrobet për marshim dhe shpërndahen armët. Këtu është rreshtuar një kompani dhe komisari tregon diçka. Tek secili sheh entuziazmin, vrullin revolucionar, vendosmërinë e guximin për të kryer me nder marshimin e gjatë në ato shtigje, ku kaluan e vepruan trimat partizanë të Brigadës së parë sulmuese.

Ja tek përzihen me të rinjtë e të rejtat të ardhura nga rrethet edhe kursantët e shkollës. Fillojnë përsëri takimet e përzemërta. Dikush, në këto çaste, thotë: «Dhe hajde dalloji tani se cili është kursant, cili është civil».

Dhe vërtet nuk dallohen, ata kanë të njejtën uniformë, ata të gjithë mbajnë pushkë në krah, ata do të përshkojnë të njejtën rrugë. Para së gjithash, ata kanë zemrën njësoj: zemër të fortë, zemër prush, të ndezur nga partia jonë. Ata të gjithë janë ushtarë, të gjithë barutin e mbajnë të thatë.

Këta, të gjithë së bashku, nesër do të nisen... Dhe në këto çaste, më bëhet sikur shoh partizanët... Ja tek rreshtohen... Komandanti del përpara. Flet. Një përgjigje gjëmon si ortek i fuqishëm: «Përpara!» Po, përpara, vetëm përpara ecën heronjtë dhe e mposhtën urinë, lodhjen, urren vdekjen, çanë rrethimet armike; çanë dëborën e maleve e dolën fitimtarë, dolën të fortë...

Nesër ne do të nisemi në këtë rrugë. Armiq s'do kemi përpara, do kemi fshatrat e lira, nje-



rëzit e lirë e të lumtur. Po vështirësitë do të jenë. Ne do t'i kalojmë.

— Po, se ne jemi bij të partizanëve, ne kemi zemër partizani — thotë një ushtar mortaist.

— Po, po, — thonë shokët e tij, Ziguri, Shkëlqimi, Adipi.

— A kishte pengesë për partizanët? — Jo! Edhe për ne nuk ka, ne nuk do të prapsemi, do të dalim fitimtarë si paraardhësit tanë — thotë një kursant.

Se mos vetëm ai! Ç'shpreshin sytë e Ismailit, Shabanit, Aliut?! Po të Marikës, bijë e partizanit të Brigadës gjashtëmbëdhjetë sulmuese, Qazimit; kushëriri i dy dëshmorëve të Brigadës parë, të Dhimitrit e Bajramit, Theodorit e Hakiut, të qindëra e qindëra marshuesve të tjerë? Vendosmëri, shpirt të lartë luftarak, gatishmëri për të ecur në gjurmët partizane, në shtigjet partizane.

Pasdite e gjithë brigada rreshtohet. Komandantët bëjnë kontrollin e armëve, veshmbathjes, të gjithshkaje. Këtu vjen edhe sekretari i parë i Komitetit Qëndror të Rinisë shoku Agim Mero. Ai kalon sa në një grup, në tjetrin, takohet me shumë nga të rinjtë, i pyet për gatishmërinë, për ekskursionet e marshimet që kanë bërë. E ata njënjëzëri shpreshin gëzimin, që marrin pjesë në inkursionin e Brigadës së parë S dhe që do të quhen partizanë të saj.

Kur nata filloi të ndejë krahët, të gjithë marshuesit mbushën sallën e kinemasë së shkollës. Aty jehuan sërishmi këngët partizane, këngë të fuqishme luftarake. Aty të rinjtë njohën së afërmi ish-komandantin e Batalionit të parë të

Brigadës, shokun Ndreko Rino; u njohën me rru-  
gën historike të përshkuar nga brigada...

### 16 shkurt

Të dy batalionet e brigadës rreshtohen. Tani ajo është një masë kompakte, si një trup i vetëm. Janë çaste pritjeje. Heshtja që ishte vendosur pak minuta, u prish. Në tribunë zë vend kandidati i Byrosë Politike të KQ të Partisë, shoku Petrit Dume si dhe shumë shokë të tjerë që kanë ardhur t'u urojnë marshuesve rrugë të mbarë... Sheshi ushton nga «urra» të fuqishme. Shoku Petrit u thotë marshuesve se që nga ky çast reparti do të quhet «Brigada e parë sulmuese» dhe pjesëtarët e saj: «Partizanë të Brigadës së parë sulmuese». Sa çaste prekëse këto! Sa nder i madh i bëhet secilit pjesëmarrës! Është krenari të jesh partizan i kësaj Brigade legjendare, që u bë tmerr për armiqtë dhe shpresë për popullin. Sheshi oshëtin nga brohoritjet.

Brigada fillon marshimin, duke i rënë mes për mes kryeqytetit. Në të dy anët e rrugës, që nga Shkolla e Bashkuar e Oficerëve «Enver Hoxha» kanë zënë vend mijëra qytetarë. Të shumtë janë ata që përshëndesin nga dritaret e balkonët e apartamenteve.

Këtu një parantezë: Sapo kaloi kolona në redaksinë e gazetës «Luftëtari» — siç na thanë, shkoi me lot në sy një grua e thyer në moshë dhe e mallëngjyer pyeti:

— Ç'janë këta djem me shami të kuqe në qafë, me pushkë në sup dhe me veshje ushtarake, që



ecin me bandë përpara e me këngë në gojë? Ku venë? Reparte ushtrie janë?

— Jo, nënë, nuk janë reparte ushtarake. Është rinia jonë, që niset për marshim partizan në rrugën e Brigadës së parë sulmuese. Po ju, kush jini? — e pyetën.

— Llambrini Manastirliu, nëna e dy dëshmorëve, Kleanthit e Dhionisit, — tha ajo dhe shtoi:

— Mos m'i vini re lotët. Nuk janë lot hidhërimi. Janë lotët e një zemre që humbi djemtë e saj, por nuk humbi amanetet e tyre. Besomëni, të gjithë ata që parakalojnë me shami të kuqe në qafë e këngë në gojë, janë Kleanthët, Dhionisët e mi... Dua t'i them nja dy fjalë shokut Enver e Ministrit të Mbrojtjes, shokut Beqir, se me këto që shoh e që po bëhen, jo vetëm rinia, por edhe ne pleqtë jemi mbushur me zjarr.

Këto kishte thënë nënë Llambrinia. Po sa nëna, sa motra, shokë e vëllezër e ndjekin kolonën tonë me entuziazëm dhe i urojnë: «Rrugë të mbarë!»

...Kolona partizane ecën përpara. Në afërsi të Vaqarrit jepet sinjali për pushimin e parë. Kalojnë midis partizanëve. Buzë një ledhi janë ulur një grup të rinjsh dhe të rejsh. Ata janë nga Lushnja, pothuajse të gjithë të frontit bujqësor. Është duke folur Kristavgjia:

— Dëgjoni këtu, do t'ju lexoj... — dhe të gjithë dëgjojnë mbi disa rregulla gjatë marshimit. Afër saj njohim Dritën, punëtore në NGSH-në «29 Nëntori».

Ja dhe ndërlihdësit. Ata duhet të jenë sa të aftë në specialitet, aq dhe të fuqishëm fizikisht.

Në çdo kohë ata duhet të kontrollojnë gatishmërinë e teknikës. Për këtë arsye Mersini kujdeset që radisti të hyjë në lidhje.

— Gjithshka në rregull — raporton ai.

Ngado që të kthehesh, ngado që të hedhësh sytë, sheh fytyrat e gëzuara të partizanëve, dëgjon këngët e tyre. Në minutat e pushimit, grupi i të rinjve të rrethit të Tiranës studjon itinerarin e lëvizjes. Në atë grup njihemi me një traktorist, që punon për llogari të vitit 1970...

Përsëri lëvizje. Rruga është e gjatë, por jo e vështirë. Sidoqoftë, djersët kanë filluar të rrjedhin. Në orën 15<sup>00</sup> ndodhemi në Pezën e Madhe, në një shesh, midis të cilit ngrihet një lapidar. Partizanët lexojnë:

«Në kujtim të partizanëve të Pezës dhe të Brigadës së dymbëdhjetë sulmuese» dhe vazhdojnë emrat e partizanëve të Pezës, të rënë gjatë Luftës nacionalçlirimtare. Lexojmë emrat: heroi i popullit Kajo Karafili, dëshmorja Myrvete Peza, Mihal Duri, Maliq Muço, Mystafa Lleshi... Më poshtë janë emrat e partizanëve të Brigadës së dymbëdhjetë sulmuese.

Në krye të sheshit ndodhen disa shtëpi. Në njërin prej tyre partizanët lexojnë pllakën për-kujtimore:

«Me iniciativën e Partisë Komuniste Shqiptare më 16 shtator 1942 në Konferencën e Pezës u hodhën themelet e bashkimit të popullit shqiptar në luftën për çlirimin e atdheut dhe për pushtetin popullor.»



## 17 shkurt

Në mbrëmjen e ditës së dytë të marshimit s'munda të shënoja dot asgjë në blok. Na u desh një kohë e gjatë sa të thanim teshat pranë sobës së një pezjani, sa të çlodheshim e të mblidhnim veten. Dhe kështu, marshimi i ditës së parë na detyroi t'i mbyllnim sytë shpejt...

Dhe ja, mëngjezi i ditës së re, i freskët. Pas pak do të nisemi. Na pret Shkumbini. Por unë akoma jetoj me ngjarjet e mbrëmshme dhe pyes veten: kur do t'i shënoj? Po nuk e bëra këtë sot, është rrezik që edhe t'i harroj një pjesë. Çdo orë, çdo ditë sjellë gjëra të reja. Ka shumë episode, njëri më i bukur, më interesant se tjetri. Tek ne, që marshojmë shtigjeve partizane, jeta rrjedh më ndryshe, ajo është plot larimi, plot ngjarje, që rrallë ndodhin në kushtet e jetës normale...

Ecim pas një pezjani, mesoburrë. Ai qëndron shpesh, por asnjëri nuk i thotë gjë, asnjëri nuk e ndërpret tregimin e tij. Them tregim, pasi çdo episod i tij ka vetëm një linjë, çdo episod i tij bie erë barut. Flet për luftën partizane. Ja ku ndaloi përsëri dhe përsëri episod nga lufta. Këtë herë flet për xhaxhanë e tij, që pikërisht në këtë vend vrau shtatë gjermanë. Ne shikojmë me sytë tanë pozicionin e plakut trim, shikojmë edhe vendin që kishin zënë nazistët dhe ku lanë kockat.

Pranë një shtëpie, i gjithë Batalioni i parë qëndron. Aty do të shpërndahet nëpër baza. Pezjani, duke u ndarë nga ne, na thotë:

— Çdo kodër, përrua, shtëpi ka historinë e saj. Kudo këtej është derdhur gjak, kudo ka gjur-

më partizane... Ju do t'i gjeni ato edhe në familjet, që do të kaloni natën.

Ne jemi tetë shokë, që nisemi për në Grecë, e pikërisht në shtëpinë e Demirit. Nuk do të shënoj gjë për mikpritjen (ajo ishte pritje e përzemërt, siç u bëhej partizanëve nga populli, pritje shqiptare), po do të ndalem në diçka tjetër.

Jemi ulur rreth sobës dhe po ngrohemi, po thajmë teshat. Na u desh të kalonim disa herë përruan e Pezës dhe u lagëm. Bisedat pasojnë njëra-tjetrën. Foli edhe Demiri. Ai na tregoi për kooperativën, për njerëzit e familjes së tij, për shumë gjëra të tjera. Pastaj filluan historitë e luftës. Demiri përsëri e mori fjalën... Ai është një burrë që nuk i ka më tepër se 35 vjet, por flet shtruar, me zë të qetë, si të jetë i mocëm.

... — Në këto anë kishte kohë që vepronte Bab Myslimi me shokët e tij trima. E një ditë fashistët u sulën që të na «shfarosnin». Po s'mundën. Për t'u hakmarrë na plaçkitën, na dogjën, na rrëmbyen njerëzit e zemrës, na i vranë... Dyzet burra. Edhe babën tim, Sejdinin e dy kushërinj, Kasemin e Hasanin, i futën në dhomën e një fshatari dhe atje i lanë të lidhur, pa bukë, i lanë të vdisnin, t'u kalbej mishtë...

Demiri heshti. Dhembja dhe urrejtja shpreheshin në sytë e tij.

— Edhe nëna ka vuajtur shumë — vijoi pas pak. Edhe atë e kanë shtyrë, e kanë përplasur për tokë, i rrëmbyen plaçkat e trupit... Të gjithë kemi vuajtur: shtëpinë na e dogjën, strehë për ne u bënë pyjet, shpellat.

Sot, në mëngjes, para se të ndaheshim me De-



mirin e vëllezërit e tij, dëgjuam edhe nga goja e tij ato që na tha pezjani mbrëmë:

— Kudo këtej është derdhur gjak...

Kujtojmë të kaluarën e hidhur, për të ndërtuar e mbrojtur jetën e re.

Vazhdojmë udhëtimin drejt përroit të Pezës. Duhet edhe pak që t'i ngjitemi një të përpjete. Unë eci pranë një ish-partizani të Brigadës parë sulmuese, Sotirit. Ai u tregon dy të rinjve se si në qafën ku do të dalim, qafa e Kallmit, është bërë një luftë e rreptë, u tregon për trimëritë partizane. Por ja, Sotiri e pret fjalën në mes. Ai qëndron një hop, pastaj me zë të ulët:

— Sa i ngjan! — Pasi hedh përruan, ne e shikojmë tek i afrohet një vajze.

— Ludije!

Vajza kthen kryet. Në ballin e saj kanë filluar të duken bulëzat e djersës. Ish-partizani i bëri përshtypje kur vajza ktheu kokën. Mos e quajnë vërtet Ludije?

— U lodhe?

— E po, si të them, jo dhe shumë.

— Si të quajnë? Mos e kini...

— Jo, po unë njoh një grua që e quajnë Ludije. Ajo është pensioniste dhe...

— Ju e njihni!? A e dini që atë e kam patur në skuadër? Ç'vajzë trime ka qenë, ç'luftëtare!... Ju i shëmbëlleni shumë.

— Ne ndryshojmë vetëm nga emri, më quajnë Dafina. Siç e shihni, edhe unë jam partizane e Brigadës parë sulmuese e pikërisht e Batalionit të parë...

Dhe veterani, qysh nga ai çast, nisi t'i flasë

asaj vajze me emrin e luftëtares së skuadrës së tij: «Ludije».

Punën e «pagëzimit» të Dafinës me një emër të ri e mësuan edhe shumë të tjerë, Ja, tek jemi ulur, pushojmë, pasi i jemi ngjitur të përpjetës së qafës së Kallmit. Një kursant i afrohet asaj dhe i lutet.

— Ludije! Më trego diçka për atë Ludijen tjetër, për partizanen trime!...

... Ora është 11.10. Kolona e Batalionit të parë (Batalioni i dytë ndodhet larg nesh) duket si një shirit i gjatë, i larmë. Tani kemi hyrë në kooperativën e bashkuar të malësisë së Rrogozhinës. Një grup kooperativistësh po hapin një tokë të re. Përfund arës, që posa e kanë hapur, kalon kolona «partizane».

— Puna e mbarë, shokë!... Për patate e hapni?

— Jo, ato i mbollëm. Kjo është tokë për misër. ...Në mbrëmje arrijmë në fshatin «Përparim».

### 18 shkurt

Shiu pushon vetëm kur arrijmë në fshatin Shezë. Ndalojmë në sheshin para shkollës 8-vjeçare. Në dritaret e klasave shohim fytyrat kurrështare të fëmijëve. Ata na vështrojnë me njëfarë habie. Kanë dëgjuar për partizanët, po kurrë s'i kanë parë. Mësuesja e klasës së katërt vendos të bëjë pushim. Fëmijët turren përjashta dhe përzihen me partizanët, u prekin atyre, pushkët, trobet e lagura...

Skena të tilla ne kemi parë dhe në vende të



tjera. Kështu, në Belsh, një burrë pak i thyer, me thinja, ka zënë vend ndanë rrugës. Partizanët e Batalionit të parë ecin njëri pas tjetrit, dhe burri i kundron të gjithë me radhë... Kur ja, përqëndrohet vetëm tek njëri, thërret:

— Petrit!

Djaloshi ktheu kokën. U mendua një hop dhe:

— Mësuesi im i parë — foli Petriti.

— Sa je rritur! Qenke bërë dhe partizan...

Eh...

### 19 shkurt

Çdo ditë ndodhin ngjarje të reja, çdo ditë shtohen vështirësitë. Sot do të kalojmë Devollin. Lumi është i rrëmbyer, fryn dhe një erë e fortë. Megjithatë duhet kaluar, se edhe partizanët e kanë kaluar atë. Po ne a nuk jemi pasardhës të tyre?

Batalioni i parë dhe një kompani e batalionit tjetër rreshtohen në zallin e lumit.

— Do të jetë i ftohtë.

— U, sa thellë qenka atje!

— Po sikur të pengohesh?...

Në krye vihet vetë komandanti e pas tij flamuri i kuq, gjithë kolona. Vau është i gjerë, duhet lëvizur herë drejt, herë nga e majta... Gjithsejt disa dhjetëra metra, disa minuta në ujë. Megjithatë jehon kënga, kënga partizane... Në orën 10.40 komandanti, shoku Vehbi Hoxha urdhëron radistin:

— Njofto: Devolli u kalua!

Fillon ngjitja drejt kodrave të Sulovës. Mbi to, për afër shtatë orë rresht, u ndie hapi partizan. Në hyrje të Topojanit, komandanti i brigadës ndalon. Ai e tret shikimin mbi një kurriz kodrash,

që duket sikur i kanë rrënjët në Devoll, sodit një copë herë kooperativistët që hapin tokë të re dhe pastaj thotë:

— Pasojeni: këtu hyjmë në zonën nga ka kaluar Brigada e parë sulmuese.

Këto fjalë, gojë më gojë, shkojnë gjer në fund të kolonës dhe i japin gjallëri asaj...

Ra nata. Sa mban Tunja prej këtej, sa orë rrugë do bëjmë gjer atje, në këtë natë të errët? Ne vetëm dimë se duhet ecur akoma, se duhet të derdhim akoma djersë, të «vrapojmë» drejt Tunjës, e pastaj në Dardhë...

Është e përpjetë. Rrugë e ngushtë. Baltë, Shkoza kocaqe, ndonjë dëllinjë, degë lisash. Duhet të kesh mendjen.

Shoku që kam pas më pyet:

— Çfarë je ti, byrazer?

— Partizan.

— E di, e di, po këmbësor a... — S'e mbaron fjalën. Rrëshqet. Ngrihet. Pështyn përtokë me inat. Pastaj përsëri:

— Apo artiljer?

— Partizan!

— Kujdes, mos biesh!...

Unë bëj një hap... dy... pengohem në një rrënjë peme dhe humbas ekuilibrin. Instinktivisht zgjas krahun. Dua të mbahem. Po ku? Megjithkëtë nuk bie. Një dorë, dora e shokut më mban, ajo s'më lë të rrëzohem. Dua ta falënderoj. Ai ma kthen:

— Ama errësirë. Po ç'dreq rruge kjo!

Një zë i njohur:

— U lodhe.

— Jo!



— Do ujë?...

S'pata kohë t'i përgjigjem. Shoku përpara u pengua, i rrëshqitën këmbët. Vrau gjurin në kasetën e municionit.

— Të dhemb?

— Do kalojë... kemi edhe shumë?

— Edhe pak. Kreu doli në qafë...

Komandanti që udhëheq në krye ndalon:

— Ne, partizanët, edhe në kësi vendesh kalonim, bile edhe më keq. Prandaj...

Dhe kolona marshon shtigjeve të rrezikshme, shtigjeve partizane. Atë s'e ndal errësira, s'e ndal asgjë...

Pas 12 orësh marshimi arrijmë në Tunjë. Jemi të lodhur, gjithë djersë. Megjithëse ora po shkonte 24.00, në Tunjë s'ka qetësi. Që së largu ndihen tingujt e fizarmonikës. Nëntë orë kanë të rinjtë e të rejat e Gramshit që presin për t'u takuar me ne. Shokët tanë u flasin atyre për marshimin.

Ndërsa brigada partizane u shpërnda nëpër baza, një tjetër, ajo e të rinjve të Gramshit natën nisi rrugën drejt qytetit. Sa bukur! Kolonat janë gjithnjë në ecje!

## 20 shkurt

Marshimi nga Tunja në Dardhë nuk na lodhi, na u duk i shkurtër.

Hamiti ka qëndruar përkundruall një shtëpie të vjetër me mure të gurta. Rri mendueshëm. Është keq t'i ndërhysh njeriut në këto raste, po ç'të bësh, s'të lë kureshtja! Dhe ja, te i afrohen dy të reja partizane, Kristina me Lirinë.

— Ç'kini kështu, shoku Hamit?

Ish-luftëtari i përgjigjet:

— Kërkoj një shtëpi, shtëpinë ku jam gëdhirë shumë vjet më parë... Po s'e mbaj mend.

— Pse nuk pyetni njeri!

Ajo shtëpi ndodhet prapa një kodre të vogël. Po njerëzit e saj s'janë aty. Ata kanë shkuan pas djalit të madh, oficer i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sidoqoftë, ai donte ta shihte atë shtëpi. Ajo do t'i përtërinte një të kaluar aq heroike. Por s'pati kohë. Ndërsa bisedonte me vajzat, aty pranë kalon një mesoburrë i hequr në fytyrë. Hamiti thotë me zë të ulët:

— Diku e kam parë. Po ku?

Tjetri, si të lexonte mendimet e oficerit, foli i pari:

— Më njihni?

— Për këtë po vras mendjen.

— Kam qenë partizan i Batalionit të dytë.

— I Brigadës së parë?

— Po! Sherifi.

Kështu u takuan miqtë e shokët e vjetër të luftës pas më tepër se dy dekadash. Të dy ja fillojnë shtruar. Ata kujtuan Çausht Senën e Idriz Qehajajn, dy luftëtarë të tjerë të Brigadës së parë sulmuese të fshatit Tunjë, që dhanë jetën në fushën e burrave. Emrin e Çaushtit sot e mban shkolla 8-vjeçare, atë të Idrizit kooperativa. Akti i tyre kujtohet e nderohet me respekt.

...Sot Tunja po bëhet vendi i takimit të luftëtarëve të vjetër. Ja, komandantit i del përpara Neimi:

— Më lejoni t'ju takoj — i thotë — më mbani mend? Kam qenë partizan i kompanisë së dytë, i kompanisë që komandonit ju!



Janë prekëse këto çaste. Mënjanë shikon luftëtarin e vjetër partizan, të përqafohet me shokun e tij, e në anën tjetër fytyrat e qeshura, të gëzuara të të rinjve e të rejave, që mbajnë në qafë shaminë e kuqe, fytyrat e partizanëve të rinj.

...Ecim për në Dardhë. Në krye të kolonës vrapojnë disa kursantë.

— Ç'ka ndodhur? — pyesim.

Pas pak, dëgjohen tri batore pushkësh. Të gjithë e kuptojnë shkakun: përpara është një lapidar. Cili do të jetë vrrarë këtu, në malin e Jançes?

...Ishte një ditë e nxehtë qershori. Partizanët hidhen në sulm të furishëm, në sulm për jetë a vdekje. Ja dhe drejtimi që ka ndjekur ai: midis dy lisave, drejt kodrinës së zhveshur. E aty, përpara llogoreve gjermane, midis dy mitralozëve, mbetet i vrrarë komandanti i kompanisë së parë të Batalionit të dytë...

## 21 shkurt

Sot ne fillojmë itinerarin që ndoqi brigada për të përmbushur misionin e madh, të lavdishëm, që i ngarkoi partia, shoku Enver. Kujtimet e atyre ditëve ne i gjejmë të gjitha në zemrat e njerëzve të Dardhës, e këtyre njerëzve të thjeshtë, mikpritës.

...Në Qafë Dardhë bëhet një ceremoni e shkurtër. Brigada rreshtohet. Aty rikujtohet misioni që kemi, rruga e vështirë që do përshkojmë. Të gjithë janë gati.

Kolona vihet në lëvizje.

## 22 shkurt

Edhe sot unë qëndroj me Batalionin e parë. Shkaktar bëhet një nga ish-luftëtarët e vjetër të Brigadës së parë Sulmuese, Sotiri. Ja si ndodhi:

Dje, kolona jonë një pjesë të rrugës e bëri me disa fshatarë tomorricarë, që ktheheshin nga Berati. Unë u ula me njërin prej tyre në një vend të sheshtë për të shënuar vargjet e kësaj kënge:

*Atje lart tek bregu, ku është një ulli,  
Lule Laze Shkoza, lule djal'i ri,  
Plumbi i mallkuar të hyri në gji,  
Lule Laze Shkoza, lule djal'i ri,  
Tri ditë qëndrove në erë e në shi,  
Lule Laze Shkoza, lule djal'i ri,  
Me gjerman' luftove syngji për syngji,  
Lule Laze Shkoza, lule djal'i ri,  
Vendin ç'e vadite me gjakun e ri,*

.....

Këtë këngë ua lexova pastaj shumë të tjerëve. E dëgjoi edhe Sotiri. Ai më pyeti:

— Ç'brigadë ka qenë?

— Ai është dëshmor i fshatit Kovaçan. Kaq më tha plaku që ma kallëzoi — ju përgjigja.

Sotiri, kur dolëm në një vend ku dukej Shëmbërdhenji, nisi të tregojë një ngjarje të jetuar në vitet e luftës.

...Pas një sulmi të furishëm mbi gjermanët, që kishin zënë vend përballë Shëmbërdhenjit, mбетet i plagosur një partizan. Ai e kishte marrë në krahë, e nën breshërinë e plumbave e kishte çuar në një vend të mbrojtur. Por, partizanit i kishte



pushuar zemra së rrahuri. Gjaku i tij kishte rrjedhur në tokë, në rrobet e shokut. Diku u varros ai partizan, diku në tokën që vaditi.

— Eh, ç'djalë që ishte!..

— Si e quanin?

Heshti. Më pas foli:

— S'e mbaj mend. Kanë kaluar shumë vjet. Ndoshta, në fshat atij i këndojnë këngë, ashtu si edhe Laze Shkozës.

Së bashku zbritëm deri në lumin e Tomorricës. U lagëm keq. Patëm dhe të ftohët. Unë prisja që ai të nisej për në Dobrenj, po nuk shkoi. Arësye e mësova vetëm në Çerricë. Atje arritëm vonë. Kryetari i këshillit dhe shokët e komandës filluan ndarjen e partizanëve nëpër baza.

Sotiri pyeti të parin njeri që takoi:

— Ku e ka shtëpinë Bedriu, si është?... — Përgjigja e gëzoi pa masë.

— E njihni?

— Posi, shumë mirë, bile! Kam ardhur kastile për të, dua ta takoj, dua ta kaloj atje natën...

— Dhe përsëri u nisëm së bashku.

Atje na prisnin. Kjo na habiti. Ç'është e vërteta, lajmin se në fshat do të vinin të rinj e të reja partizane. Bedriut ja kishte dhënë e shoqja.

— E po dëgjo, moj grua: po qe se ka ndonjë partizan të vjetër të Brigadës së parë, sot e kemi këtu... Dëgjomë mua ti, s'e harrojmë shoku-shokun ne.

Në këto fjalë, ne u dhamë te dera:

— A pranoni miq?

Dhe e toku Sotiri, e tokëm me radhë. U zbatëm e zumë vendet.

— A më mban mend, Bedri? — Filloi të flasë ish-partizani.

— Nga zëri më dukesh... Dale, a jemi shokë lufte?

— Po!

— Të thashë, moj grua... Tani, më lërë të të shikoj... Dhe ai e nguli vështrimin në fytyrën e hequr të Sotirit, si të kërkonte të zbulonte në të diçka të fshehtë. Ne po prisnim. Dhe pritëm disa minuta, pastaj:

— A ke qenë në Batalionin e parë?

— Po!

— Tani, ma jep edhe një herë atë dorë. Ashtu! Hajde të puthemi, o shoku Sotir, të puthemi buzë më buzë!

Të dy u përqaftuan. U puthën me mall, të dy shokët e vjetër të luftës, të inkursionit. Filluan pastaj të kujtojnë ngjarje, shokë, vështirësi.

Unë, Balliu, Veledini, Faiku, Tefiku, Xhevde-ti, Kristaqi mbajmë vesh. I shikojmë të dy shokët të përqaftohen përsëri. Sa interesante është të ndodhesh midis dy luftëtarëve, që e kanë përshkuar me trimëri rrugën që kemi nisur të bëjmë edhe ne! Është me të vërtetë një rast i bukur!

Në bisedë e sipër, Bedriu na drejtohet neve.

— E dini ju, që unë jetën partizane e kam fituar me inkursionin? — Dhe ai vazhdon:

— Isha për dru. Kur vij në shtëpi, pyes për vëllanë, Sulon. «E thirrën në këshillë» më thanë. E mora me mend se do të kishin ardhur partizanë. E ai duhet të ishte atje, se ishte kryetar i këshillit. Partizanët duhej të ndaheshin nëpër baza, siç ju ndanë edhe ju, o partizanë të rinj. Dhe ashtu



ndodhi. Paskeshin qenë partizanët e Batalionit të parë të Brigadës së parë sulmuese. Në shtëpinë tonë erdhi shoku Mehmet Shehu me disa të tjerë dhe qëndroi dy ditë. Kur u nisën për inkursion, ika dhe unë me ta...

Qëndruam shumë vonë. Edhe djemtë e Bedritut: Bilbili, Asqeriu, Mojsiu dhe e shoqja, Tatushja, nuk u larguan. Edhe ata mbanin vesh. Herë pas here Tatushja thosh:

— Ky, kur kujton Brigadën e parë, sikur përtërihet.

— Po, ashtu është, moj grua, nga e kemi jetën unë, ti, djemtë, vajzat, këta miqtë që na nderuan sonte? Nga partia, që krijoi brigadat partizane e na çliruan...

...Ngjitemi në Zhepë. Në shkollën e fshatit takojmë sekretarin e organizatës bazë të partisë të Çërricës. Ai dëshiron që Sotiri t'u tregojë nxënësve për misionin tonë. Luftëtari i vjetër zhvilloi një bisedë të shkurtër... Me sa vëmendje e ndoqën nxënësit fjalën e tij!

Në orën 11,30 ndodhemi në Gurin e Prerë, në vendin e betejave të përgjakshme të operacionit të qershorit të vitit 1944. Në një shesh rrethuar me pisha, na foli komandanti për ato ditë heroike. I tërë batalioni mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për dëshmorët e Brigadës së pestë sulmuese dhe të Batalionit të pestë të Brigadës së parë, të rënë në këto beteja.

Në të thyer të ditës morëm drejtimin për në Moglicë. Aty, të pritur me përzemërsi nga familjet fshatare, kalojmë natën e shtatë të marshimit.

### 23 shkurt

Kemi qëndruar mbi Moglicë, përballë malit të Lenies. Partizanët, grupe-grupe, janë mbledhur prapa një muri për të zënë era. Disa kanë rrethuar fizarmonicistin dhe këndojnë. Të tjerët merren me rregullimin e pajimeve. Një pjesë pas-tron pushkët. Gjithshka këtu të kujton jetën partizane.

Pak më lart janë mbledhur komunistët e batalionit. Flet komisar i brigadës, shoku Andon. Ai u tregon atyre se tani fillojnë vështirësi të reja dhe bën thirrje që të mbajnë lart frymën luftarake, të japin shembullin personal në kalimin e çdo pengese, të mbajnë të ndezur në zemrat djalosha-re të të rinjve e të të rejave partizane hovin revolucionar partizan...

Sot Batalioni i parë u nis pas atij të rinisë.

Unë ndaloj për një kohë me mortaistët. Dua të shkruaj për ta disa radhë. Po për cilin të flas më parë? Në grupin e këtyre të rinjve ushtarë zor se mund të bësh dallim. Ata janë një nënrepart kompakt. Për tetë ditë me radhë s'janë shkëputur nga kolona, s'kanë pyetur për lodhje e vështirësi, megjithëse mbajnë mbi shpinë një ngarkesë më të madhe se të tjerët. Ata janë treguar më të fuqishmit. Dhe kjo ka një bazë: janë mjaft të përgatitur nga ana fizike.

Më tërheq vëmendjen një ushtar me dorë të lidhur. Ai ecën pranë një shoku që mban në sup grykën e zjarrit. Vetë ka dy pushkë. Interesohem. Dora i është ënjtur gjatë marshimit. Mjeku



e këshilloi të kthehej, por Namiku i ishte përgjigjur:

— Partizanët kanë luftuar edhe me një dorë. Unë s'mund t'i le shokët. Kjo është njësoj si të tërhiqesh përpara betejës. — Dhe ai vazhdon të udhëtojë. Në qoftë se tani për tani s'mund ta mbajë grykën e zjarrit, e lehtëson shoku duke e ndihmuar. Ja, i tillë është ky mortaist, që nesër, si i kanë thënë, do të operojë dorën. Po se mos është ai vetëm. Kujtim Basha më tregon një të ri me trup të shkurtër, Flamurin. Është njeri me vullnet, s'mbetet kurrë prapa. Edhe kur lodhet, nga goja e tij s'del kurrë një ankim. Njoha edhe sa e sa të tjerë, të gjithë djem petrita.

Ndërkohë kolona vazhdon të ecë.

Fryn erë. Moti po prishet. Pasi lemë Strelcën dhe pionierët entuziaztë të shkollës 8-vjeçare, që na pritën me aq përzemërsi, në orën 16.00 arrijmë në Selcë. Ka filluar të bjerë shi, e aty pak më lart dëborë. Në portën e një shtëpie ka qëndruar një grua pak e thyer në moshë. E quajnë Beje. Ajo kishte kohë që rrinte aty, qëkurse kaloi batalioni i rinisë për në Velçan. Kur merr vesh se do vemi në shtëpinë e saj, gëzohet. Na përqafton me radhë. Flet e mallëngjyer.

— U, mor bijtë e nënës, rrofshi! Ju shoh e më kujtohen partizanët. Ja, kështu ecnin dhe ata, varg... Kjo kohë ishte atëhere. Dita në të thyer. Binte shi e më t'na u mbush, ja, kjo dhomë. Kështu u ulën rreth vatrës, si ju, i zgjatën këmbët nga zjarri.

— Ç't'ju sjell për të ngrënë? — u thashë.

— Bukë e kripë, nëno, s'duam gjë tjetër — ma

pritën. — E ua shtrova sofrën, vura bukë misri, një tas me fasule e një me arme. Hëngrën bijtë e nënës, fjetën, ja këtu në atë anë. Atëhere Kudretin dhe Selimin i kisha të vegjël. Tani, i shikoni: u bënë burra, i presin vetë partizanët... Merrjani një kënge, bijtë e mi.

Dhe Selimi, sikur të priste këtë «urdhër», ja filloi.

#### 24 shkurt

Sot kemi rrugë të gjatë, rrugë të vështirë. Do vemi në fshatin Çezmë të Mokrës. Ngrihemi herët. Në orën 7.00. nisemi. Deri në Selcë kemi bërë rreth 187 kilometra marshim.

Me ne është një vajzë e re, punëtore nga Elbasani. Ka ditë që ndrydhi këmbën. I thanë të kthehej, po nuk dëgjoji. Dhe ka rezistuar mirë. E ndjek kolonën, është bërë pjesë e saj, entuziazmi i përgjithshëm, që përshkon kolonën partizane, është bërë për të burim force. Sot komisar i tha të hipi në kalë. Nuk deshi, Po e detyruan shokët e shoqet e saj. E Afërdita u bind, po këtë e bëri sa për të mos u prishur qejfin. Ajo përsëri vazhdoi të ecë më këmbë, me zor, por pa u shkëputur...

Në të hyrë të fshatit Velçan na priste një djallë. Ai mbante në dorë një copë letër. E hapim. Është një poezi. Lexojmë vargjet e para:

*Ju në Selcën time,  
Kudo që po shkoni,  
Ngjallni plot kujtime,  
Zemrat po na zgjoni.*



*Dhe më poshtë:*

*Të parën Brigadë  
Ju e përtëritë,  
Rroftë Parti' e Punës.  
Ç'rini që po rritë!..*

Në fund të poezisë nuk është shënuar emri i autorit. Djali që e solli iku. Nuk e pyetëm kush ja dha. Sa keq! Në çast m'u kujtua kënga që kënduan mbrëmë Selimi me kursant Arqilenë. Në fund i pyeta:

— Kush e ka bërë këtë këngë?

Asnjëri s'u përgjigj, të gjithë shikuan njëri-tjetrin në sy. U muar vesh se autori i saj është një nga bijtë e popullit dhe populli i përcjell këngët gojë më gojë.

Në fshatin Osnat ishin mbledhur të gjithë kooperativistët, burra e gra. Aty bëmë një ndalesë të shkurtër; u takuam me kooperativistët. Një grup grash futën midis tyre një partizane, Kristinën. E për çfarë nuk e pyetën?.. Një plakë, kur mori vesh se një vajzë nga Fieri kishte nëntë ditë që udhëtonte, duke e përçafuar, i tha:

— Ti dukesh si ato partizanet e atëhershme me këtë pushkë, moj bijë!..

Ndërkohë, një vajzë tjetër, partizane, kur pa kooperativistet ju drejtua disave prej tyre:

— A ka njeri prej Niçe?

— Po, sa të duash, pse?

— Unë jam këtej, nga Niça, po punoj si mami në një ambulancë fshati, në Lushnjë.

— Dale, dale, mos je ti, moj Vjollcë?..

— Po!

Dhe Vjollca u takua me bashkëfshataret e saj. E ato e vunë në mes vajzën partizane, filluan ta pyesin. E ftuan në shtëpi...

E lamë Osnatin në valën e entuziazmit që shkaktoi kalimi i kolonës partizane. Batalionet u nisën në dy drejtime: i pari drejt Çezmës, dhe tjetri drejt Kalivaçit. E përpjeta për të dalë te Guri i Kamjes na nxori shumë djersë. Por patëm dhe një gëzim: shkelëm në dëborë, dëborë e parë për kolonën e re partizane.

Nga qafa pamë Mokrrën, Mokrrën partizane, Mokrrën e Reshit Çollakut. Tokën e saj ripa-ripa të duket, sikur e ka qëlluar njeri me hanxhar. Drejt një shpati zbresin dy fëmijë. Shpejtojnë që të na shikojnë, të na dalin përpara. Nga këto shpate kanë zbritur dikur shqiptonjat partizane. Atje i kishin foletë e tyre. Këtyre shpateve po zbresim edhe ne. Në Dunicë s'qëndrojmë, por lapidarin e ngritur në krye të një sheshi s'mbetet njeri pa e parë, pa i lexuar ato që janë shkruar në të: «Më 7 mars 1944, forcat e Brigadës së parë sulmuese dhe të Batalionit «Reshit Çollaku» asgjësuan e kapën rreth 500 ballista, me gjithë krerët e tyre».

Shiu bie me rrëmbim. Po erret. Ka dhe mjegull. Rruga për në Çezmë na kujton Tunjën. Mbërrijmë në orën 19.00, pas 11 orë e 30 minuta marshim!...

## 25 shkurt

Sot, dita e dhjetë. Kemi pushim. Të dy batalionet u grumbulluan në Çezmë. Fshati mori një



pamje tjetër: u gjallërua si në dasmë. Deri në mbrëmje jehuan këngët e gëzueshme, këngët partizane, këngët e punës. Kaloj sa nga njëri grup, tek tjetri. Të rinjtë flasin për marshimin që kemi bërë. Por, të gjitha s'mund të shënohen. E atëhere u drejtohem disave të më japin për pak kohë ditaret personale. Kështu e pata më lehtë të njihesha dhe të shkruaja në bllokun tim shumë mendime interesante. Ja, kam në dorë fletoren e Maksimit. Ai shkruan: «Gjithë ditën nuk e hoqa nga supi mitra-lozin e rëndë. Dhe për çudi e ndjej veten mirë. Pyeta një shokun tim se si mund të ndodhë kjo. Ai m'u përgjigj: «Nesër do të ndjehesh akoma më mirë: po kalitemi fizikisht, vëllaçko». Kjo është e vërtetë, ne çdo ditë kalitemi...».

Por në ditaret e inkursionistëve pasqyrohet dhe një e vërtetë tjetër: dashuria e popullit për ushtrinë, për të rinjtë që ecin në rrugën e parardhësve, pasqyrohet mikpritja shqiptare. «Në shtëpinë që isha mbrëmë, tek Neshati (sa keq që nuk ja mësova mbiemrin) gjeta ngrohtësinë e familjes sime, gjeta dashurinë prindërore» — shkruan Xhelali. Ndërsa Ademi thotë: «Kudo na presin si partizanë të vërtetë...» Një vajzë, në njërin nga faqet e ditarit, ka shkruar këto fjalë: «Nëna ime më thotë bijë. Po kështu më thërriti edhe një plakë në Selcë... Sikur m'u largua pak malli që më kishte pushtuar».

S'kanë nevojë për koment këto shprehje të inkursionistëve. Ndjenjat e tyre janë shumë të qarta, kuptimplote.

Në mbrëmje vonë, Çezma, vendi ku tre ba-

talioneve të Brigadës së parë Sulmuese ju ngarkua misioni i rëndësishëm, ra në qetësi...

### 26 shkurt

Rreth orës 15.30 kolona partizane vihet në lëvizje drejt Qukësit. Moti vazhdon të jetë i mirë. Në qiell s' duket asnjë re. Natë, një natë me hënë e plot yje. Dhe ne udhëtojmë, udhëtojmë...

### 27 shkurt

U gëdhimë përjashta, në faqen e një kodrine të mbuluar me lisa. Zjarret partizane ndritën për disa orë rresht. Akoma pa u ndezur mirë agimi, shkojmë në pikën ku Brigada e parë sulmuese kaloi rrugën Elbasan-Korçë. Nuk jemi të parët që arrijmë. Atje na prisnin shumë nxënës nga Prrenjasi, dhe Elbasani. Oshëtijnë këngët, brohoritjet. Midis nesh ndodhet shoku Mehmet Shehu, ish komandant i Brigadës së parë sulmuese. Kalojmë çaste prekëse, çaste të paharruara. Kryetari i Këshillit të Ministrave pyet disa partizanë për rrugën që kanë bërë, për vështirësitë që kanë hasur, interesohet për shëndetin e tyre. Në fjalën e tij shoku Mehmet Shehu theksoi se, duke ndërmarrë këtë inisiativë, inkursionistët kryejnë dy detyra: kaliten dhe njëkohësisht përjetësojnë traditat e Luftës nacionalçlirimtare. Ai porositi që rinia jonë të kalitet fizikisht, të përgatitet të përballojë çdo situatë dhe me atë heroizëm që i përballoi rinia gjatë Luftës nacionalçlirimtare. Kjo çështje të bëhet sistem pune për edukimin e rinisë. Shoku Mehmet Shehu tregoi se etapa tjetër e marshimit



do të jetë më e vështirë, më e rëndë, do të ketë një lodhje pesë herë më tepër. Pyetjes së tij nëse janë në gjendje t'i kalojnë ato inkursionistët, ata ju përgjigjën njëzëri me «po» të fuqishme.

Një e re, pjesmarrëse në inkursion, i dhuroi shokut Mehmet Shehu shaminë e kuqe, ndërsa ai u shpërndau disa të rinjve tesarën e anëtarit të BRPSH dhe na uroi rrugë të mbarë.

Kolona partizane u vu përsëri në lëvizje më e vendosur, më entuziazte.

Përballë na del një natyrë e ashpër, rrëpira, vende të veshura me dushk e dëllinjë. Në të djathtë, Shebeniku i mbuluar me dëborë. Ujërat e shkumëzuara të përroit të Bushtricës gulçojnë poshtë këmbëve tona. Është i rrëmbyer. Për t'u ulur gjer te shtrati i tij na duhet plotë një orë, e për t'u ngjitur në faqen e përtejme dy orë. Ja, në një terren, të tillë është vendosur një pjesë e fshatit Skroskë. Aty, Brigada e parë sulmuese u rrethua nga nazistët e ballistët. Atëhere edhe dimri ishte i egër, si vetë armiqtë. Ngado syri të zinte dëborë. Atëhere, partizanët nuk zbritën si ne gjatë rrugës gjithë dredha. Ajo s'dukej. Ata më shumë rrëshqitën mbi dëborë, sipër dushqeve.

Ndërsa vazhdon ngjitja drejt së përpjetës thikë, dëgjohen disa të shtëna pushkësh. Ndokush do të pyeste: Ç'është kjo vallë? Ne nuk habitemi. E kuptojmë që jemi të «rrethuar» nga të gjitha anët... Kështu filloi imitimi i ngjarjeve të atyre viteve, të asaj dite të vështirë në të cilën u ndodh Brigada e parë. E gjithë lugina e thellë filloi të ushtojë nga krismat e pushkëve e mitralozëve.

Ndjek më kujdes veprimet e kompanisë së

Andon Llacit. Djem të rinj, të fuqishëm, djem në lulen e rinisë. Që në krismat e para, megjithëse të lodhur, tërë kompania hapet në formacion dhe shpejton drejt një kodre dominuese. Midis tyre janë dhe tre bij ish partizanësh të Brigadës parë: Qemali, Përparimi, Gëzimi. Ja te vrapojnë, përmbi kaçubet e gjelbëra, te hapin zjarr drejt «armikut». Kështu kanë vepruar edhe etërit e tyre atëhere, kështu kanë sulmuar.

Ora është 14.00. Ndodhemi në vendin që quhet Varri i Plakës. Për të kemi dëgjuar shumë, por prapë njerëzit bëhen kureshtarë, pyesin:

— Ku luftonin partizanët?

— Po mbledhja në cilin vend u bë?

Dhe për një kohë, me tërë qenjen tonë ne je-tojmë ato çaste të vështira, na duket sikur kemi përpara partizanët që luftojnë në kodër e thyejnë sulmet e nazistëve.

### 28 shkurt

Së bashku me ne, në Stanet e Dragoshtunit erdhi edhe një njeri me paterica, Çota. Atij lufta i rrëmbeu këmbën e djathtë. Këtë rrugë ai e bënte edhe atëhere kur përcillte partizanët e *Brigadës së parë* për në Stanet e Dragoshtunit. Dhe ja, përsëri, me pasardhësit e tyre. Kjo sikur ja shton forcat, sikur e bën të harrojë gjymtimin që i la lufta. Ai duket si i ri midis të rinjve. Ngjarjet që dëgjojnë inkursionistët nga goja e tij e freskojnë heroizmin e atyre ditëve të zjarra.

Në Stanet e Dragoshtunit ne kaluam çaste pre-këse, na pritën me përzemërsi shumë të rinj e të



reja të Librazhdit e të fshatrave përreth. Me ta kaluam disa orë të gëzuara, me ta rikujtuam atë natë të paharruar që kaluan atëhere partizanët: pa bukë, pa zjarr, të zhveshur, por gjithnjë të gatshëm për t'u përleshur me armikun.

Kur ra errësira, në qafën e Shapkës veshur me dëborë, në Stanet e Dragoshtunit flakërinë zjarret partizane...

### 1 Mars

Qafën e Shapkës e lemë në orën 5.00. Ecim nëpër dëborën e bardhë, të ngrirë. Errësira po thyhet. Yjet zbehen në qiell e dalëngadalë shuhen. Dy vetë kalojnë anash kolonës. Pothuajse vrapojnë. Njëri prej tyre, Osmani, mban radion në shpinë. Dëgjohet një zë:

— Hapni rrugën radistëve!

— Posi!

Dikush i pyet:

— Hytë në lidhje?

— Jo, or byrazer, nuk na lenë malet! — përgjigjet Sadiku. Dhe të dy vazhdojnë t'ja arrijnë kreut të kolonës. Pas pak dikush, para nesh, rrëshqet:

— Ej, s'të ka dalë akoma gjumi?

Mua më shkon mendja tek dy radistat. Mos është rrëzuar ndonjëri prej tyre?.. S'më besohet. Se mos është hera e parë që radistët tanë, në kohën që të tjerët pushojnë, ngjiten majë kodrash për të hyrë në lidhje? Se mos është hera e parë që ne i shohim të na kalojnë anash dhe të dalin në krye? Unë i kam parë ata gjithnjë të gatshëm të

plotësojnë detyrën e vështirë, gjithnjë të gatshëm të dalin atje ku mund të hyjnë në lidhje, edhe pse do t'u duhet të bëjnë një rrugë më të gjatë. Dhe janë si njëri e tjetri: të fuqishëm, të sakrificës. Mund të flasësh për Osmanin, po s'ka se si të mos thash fjalët më të mira edhe për Fitimtarin, Fatmirin, Mersinin.

Ja edhe Qarrishta midis maleve të larta, ja shtëpitë, që ngjajnë si kuti të bardha në të dy anët e një përroi të thellë. Ja edhe fshatarët, që kanë dalë të na presin. Na duket vetja sikur kemi hyrë në një «kazan». «Shumë nga ne s'e marrin dot me mend se si mund të ketë kaluar këtej Brigada, si mund t'i jetë ngjitur malit të thepisur të Qarrishtës, në dimrin e egër të vitit 1944. Me ne janë ish-partizanët. Ata ruajnë shumë kujtime nga ky vend. Dikush na tregon shtëpinë ku kërkoi një copë bukë, një tjetër — vendin ku u vranë partizanët e praparojës, një tjetër — drejtimin e rrugës nëpër shpatin e malit apo shtegun ku ishte zënë prita... Ata na tregojnë gjithshka, veçse në përfytyrimin e tyre shpati i malit ka mbetur i mbuluar nga dëbora.

Megjithëse jo në kushtet e atëhershme, nuk është lehtë t'i ngjitemi malit të Qarrishtës, përmes një rruge ku edhe dhitë e kanë vështirë, nuk është lehtë t'u ngjitemi shkallëve të gurta, që po t'u dalësh përsipër e të shikosh poshtë të merren mendtë. Po ne tanimë e quajmë veten të aftë të kalojmë vende edhe më të vështira.

Përpara kam një djalosh që ecën me lehtësi majë gurëve të mprehtë. Ai, herë pas here, përsërit si me vete:



— Ku këto male, me ato që kam shkelur unë...

— Kini qenë kufitar?

— Po, në alpe — thotë pa e kthyer kokën.

— A u takove me kufitarët në Qarrishtë? Kishin dalë të na prisnin!

Djaloshi, siç duket, u bë kurioz të më njihte, pasi ndaloi dhe u pamë sy në sy. Si përgjigje, tundi kokën. Unë vura re një buzëqeshje plot krenari. Hajredini është krenar që ka shërbyer në kufi. Krenarë janë edhe të rinjtë e tjerë shkodranë. Pas Hajredinit vjen Leci, vjen dhe një vajzë, Marija. Ajo është punëtore në Uzinën e fermentimit të duhanit. Shokët e shoqet e thërresin alpiniste.

— Nji, kena me e pa te shkalla.

Dhe, me të vërtetë, Marija doli në krye të grupit.

— Prina, si në Veleçik — thanë njëzëri.

— Ah, atje kishte borë, kurse këtu... — «Alpinistja», me pushkën e çantën në shpinë, filloi të ngjitej. Në hapat e saj ndjehej siguria, kuptohej se ajo s'e kishte për herë të parë të udhëtonte në terren të tillë...

Më tej, takoj edhe të rinj vlonjatë e skraparlinj, elbasanas e burrelas, kursantë të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve «Enver Hoxha». E që të gjithë njëri pas tjetrit «sulmojnë» malin e Qarrishtës. Tani kolona ecën pikërisht në atë vend, ku dikur nën tingujt rrëqethës të borisë komunistët, komandantët, komisarët u hodhën të parët në sulm, duke dhënë shembullin e lartë të guximit e

burrërisë për tërë partizanët. Ata, heronj legjendarë, e kanë rrethimin e armikut.

Pasdite, përshkuam malet e Letmit dhe natën e kaluam në Gollobordën mikpritëse, në Llëngë e Zabzun.

## 2 mars

Në orën 14.30 ndodhemi përballë Prodanit (Okshtun). Nga fshati na ndan një përrua i thellë. Ne dëgjojmë shkoqur të rrahurat e daulleve dhe cyrlat. Shikojmë një kolonë, që niset nga sheshi në drejtimin tonë. Pra, shpejt do të takohemi me ta, me okshtunasit zemërbujarë e trima. Ndërsa të dy kolonat i afrohen njëra-tjetrës, na kujtohet Haki Stërmilli, që në pak radhë ka kalitur tablo të gjalla të atyre ditëve të zjarrta, tablo nga marshimi i Brigadës së parë, pas gjithë atyre vështirësive.

Okshtunasit na pritën krahëhapur, na pritën me këngë partizane, siç pritën dikur partizanët heronj të Brigadës së parë. Ata gjenin rast e na shprehnin ndjenjat, që u buronin nga zemra...

Më kanë rrethuar tre pleq dhe disa të rinj. Pleqtë i patën pritur partizanët në vendin ku na pritën edhe ne sot. Të tre ata kishin shqepur çarçafët e jorganëve dhe u kishin lidhur këmbët partizanëve.

— Sa mirë bëni, mor bir, që na i kujtoni ato kohëra — thotë xha Murati.

— Mor, po s'u kanë lënë gjë atyre — ndërhyjnë një tjetër, Mehmeti.

— Unë s'di si t'i nxjerrë ato që kam në zemër, or bir. Sot më kini mallëngjyer. Rroftë kjo Parti,



që po ju rrit! — kështu tha Islami. Ndërsa Arifi shtoi:

— Partia po ju bën ashtu siç na do edhe neve zemra: partizanë trima!

### 3 mars

Marshojmë drejt Martaneshit. Përpara kemi Kaptinën. Është një veprim i vështirë, por edhe një detyrë e domosdoshme për të çarë midis malit të egër, të mbuluar me dëborë. Atë e kanë kaluar partizanët me këmbët tërë gjak e të uritur e jo ne, që jemi të veshur, të mbathur, të ushqyer...

Kolona ecën përpara e shtyrë nga një forcë e çuditshme, forca e ndërgjegjes revolucionare... Është pikërisht kjo, që e gjithë kolona e kaloi atë pengesë natyrore me guxim, pa u ndalur...

Pasditja na gjen në Martaneshin e Baba Fajës, ku u pritëm me përzemërsi.

### 4 mars

Dita e 17 e marshimit na gjen në Gurabardh. Dikur edhe ky fshat ka ndarë me partizanët e Brigadës së parë kafshatën e gojës. S'mbeti njeri pa dalë të na presë.

— Mirë se ardhët, shokë partizanë!

— Mirë se ju gjetëm, shokë!

Këtu, në Gurabardh, në metingun që u organizua, shpërtheu edhe njëherë gëzimi, entuziazmi për partinë e shokun Enver, shpërtheu hovi revolucionar i partizanëve, popullit dhe ushtarëve të garnizonit, që na prisnin aty...

## 5 mars

Bie shi. Ftohët. Shpejtojmë të dalim në qafën e Murrizit. Ky vend na tërheq si magnet. Po i afrohem Tiranës. Një gëzim i përgjithshëm e përshkon kolonën.

Aty, në qafë, radistët, me Sadikun në krye, kanë kohë që kanë hyrë në lidhje. Ata janë të parët që njoftojnë se kolona jonë marshon drejt Selitës. Edhe diçka: Sadiku i afrohet me nxitim komisarit të batalionit:

— Shokët e Radio-Tiranës kërkojnë të bisedojnë me ju dhe me ndonjë nga inkursionistët.

Pas pak, nga kolona shkëputet një vajzë. Atë e njohin të gjithë. Ajo është Kristina. E për çfarë t'u tregojë më parë dëgjuesve? 18 ditë marshim kanë lënë gjurmë të thella në zemrën e saj, këto ditë sikur e kanë rritur në shtat, e kanë bërë më burrëreshë, i kanë mësuar shumë gjëra... Kristina flet, dhe sytë s'ja ndan kolonës së gjatë, ajo tashmë është bërë pjesë e pandarë e saj. Duke përshkuar shtigjet partizane, ajo e ndjen kalitjen, e ndjen se ka të drejtë të quhet partizane. Në supet e saj, pushka me bajonetë të ngritur ngjan si stoli e rrallë në këto male të ashpra. Ja, për të gjitha këto flet punëtorja, komunistja fierake...

## 6 mars

Nisemi drejt Shëngjergjit, drejt vendit ku partizanët e Brigadës parë heroike i dhanë fund dhe përmbushën me sukses misionin e vështirë, por të lavdishëm... Edhe ne jemi krenarë që kemi për-



shkuar një rrugë të gjatë, që shkelëm në gjurmët e paraardhësve tanë dhe më në fund arritëm në Shëngjergj.

7 mars

Është mëngjez. Inkursionistët, grupe-grupe, grumbullohen në vendin e caktuar. Midis tyre ndizen biseda të gjalla. Të gjithë kanë në gojë mikpritjen e shëngjergjasve, të gjithë filasin me admirim për dashurinë e treguar nga banorët...

Plaku Riza, duke dëgjuar për këto, u thotë disa të tjerëve.

— Si mund të ndodhë ndryshe, bijtë e mi? Ne ju pritëm ashtu siç pritëm atëhere partizanët, me gjithë zemër.

Përpara zyrave të lokalitetit, me Batalionin e parë, organizohet një mbledhje e shkurtër për t'u lënë lamtumirën kooperativistëve, për t'u uruar atyre suksese në punë, në jetë. U ndamë si miq e shokë të vjetër. Nga shëngjergjasit morëm me vetë kujtime të bukura, dashurinë e përtërirë partizane.

...Sot do të bëjmë shumë rrugë, do të ecim, do të ecim gjer në mbrëmje. Është dita e para-fundit e marshimit, dita e njëzetë. Secili nga ne e ndjen se çdo orë, çdo minutë që i rrëmbejmë kësaj dite afron mbarimin e inkursionit. Ndoshta kjo është arsyeja që nuk duam t'ja dimë lodhjes. Edhe dhjetë minuta pushim na duken të gjata. Ne duam vetëm të ecim, të ecim që të arrijmë fitimtarë.

Edhe sot më takon të bisedoj me shumë njerëz, të eci sa në krye, në mes e në fund të kolo-

nës. Tanimë, të rinjtë e të rejat kanë një pamje tjetër, fytyrat e tyre janë thekur nga dielli malor, janë regjur nga era. Ata e ndjejnë veten më të rritur. Në ndërgjegjen e tyre sikur buçet më fort fryma revolucionare. Eci në krah të Vasilikës, vajzës nga Vlora, që për disa ditë me radhë e vranë këpucët. Nuk u përkul Vasilika, nuk hoqi dorë nga marshimi. Gjatë marshimit ajo gjente forcë tek shembulli i partizanëve trima, në gjurmët e të cilëve ajo kaloi. I tillë është edhe një durrsak, Shpëtimi, që fill pas operimit u rreshtua në kolonë. E ç'mund të them për Qemalin, për Ndrecën, Neimin, Lejlanë, Lirinë dhe Fiqireten, për qindëra të rinj e të reja, që po kryejmë së bashku kilometrat e fundit? Ky marshim nxori në pah edhe një herë forcën, vrullin revolucionar të rinisë sonë.

Kolona vazhdon të lëvizë, gjithnjë e freskët. Mbrëmja na zë në Bërzhitë e Mullet. Këtu do të kalojmë natën e fundit të marshimit të paharruar.

### 8 mars

Shpesh, fjalët nuk e kanë atë forcë, që të shprehin emocionet që ndjejmë në zemër, e sidomos sot, kur ne e përmbushëm detyrën me sukses, kur ne kthehemi në kryeqytet ballëllartë. Ne kemi sjellë me vete kujtime dhe mbresa, që s'do të na shlyhen kurrë, që do të na shërbejnë në jetë si frymëzim, si forcë për të ecur gjithnjë përpara.



## DREJT KALITJES

Ai ecën, dhe fytyra, sytë, qafa, i djegin nga djersët. Valixhen ja kalon dorës tjetër. Është lodhur, po nuk ndalet, çan mes fushës së gjerë.

Kur dielli ju afrua perëndimit, ai mbërriti në nënrepartin që do të komandonte. Sapo e toku me nënoficerin, u lehtësua.

«Mbërrita më së fundi», — belbëzoi me vete.

## URDHËRI I PARË

Që atë mbrëmje u njoh me të gjithë ushtarët. Bile disave nisi t'u flasë edhe në emër. Megjithatë, i druhej shikimit hetues të tyre, matej para se të çilte gojën. E ndjente se diç fshihej në heshtjen që pllakoste herë pas here. Patjetër diç thonin vështrimet kurioze të ushtarëve. «Ata më venë në kandar, më peshojnë», mendonte.

Nuk e dha veten, kur pa se njëri prej tyre i ra shokut me bërryl, as kur nisi t'i pëshpëriste në vesh. U mundua të hapte një bisedë, që ta gjallëronte ambientin, të shmangte, të paktën para syve të tij, çdo murmuritje vesh më vesh.

— Ç'po na thoni?

Disa mblodhën supet, disa të tjerë buzëqeshën. Qerimi hapi krahët. Kjo ishte përgjigja. «Sa i pazoti që jam!» — tha atëhere me vete dhe e ndjeu që u skuq, ndjeu në zemër një boshllëk, atë boshllëk që u ndjejnë zakonisht ata njerëz që e humbasin fillin. Ju kujtuan fjalët e komisarit: «Mundohu t'u hysh në zemër vartësve, t'i duash ata...»

— Të themi të drejtën, shoku komandant, foli ushtari që i ra shokut me bërryl, këtu... shkurt hesapi, këtu është vend i mërzitshëm. Besoj se edhe ju e kuptoni...

— Jo, asgjë s'kuptoj! E kini fjalën vetëm për vendin, apo edhe për ndonjë gjë tjetër?

— Për vendin, për...

Ushtari e ndërpreu fjalën përgjysmë. Shikoi shokët, si të kërkonte prej tyre njëfarë aprovimi: të vazhdonte, apo ta linte me kaq. Për çudinë e tij, asnjëri nuk e përkrahu. Oficeri i ri po e ndiqte me vëmendje këtë skenë, përpiquej të mos i shpëtonte asgjë. Mendonte: «Pse nuk e lënë të vazhdojë? Pse nuk gjejnë aprovim fjalët e tij? Diçka do të ketë në këtë mes, patjetër!» Po ai nuk mendoi t'i shkonte menjëherë në fund kësaj çështjeje. Kaluan rreth njëzet minuta dhe pastaj e solli fjalën me kujdes:

— Për çfarë, tjetër?..

Në vend të ushtarit foli nënoficer Nazifi.

— Ehu, Jorgos i pëlqen fort rehati. Mirë, po këtu s'para i ecën «klima».

U bë heshtje. Pas pak nata mbështolli në na-pën e saj edhe garnizonin e vogël ushtarak. Posta e shërbimit ndezi fenerët. Koha kishte kaluar pa u vënë re. Oficeri u ngrit. U ngritën edhe ushtarët.



Qerimi rreshtoi nënrepartin, pastaj ju drejtua epro-  
rit... Komandanti i ri dha urdhër të hahej ushqi-  
mi. Ky qe urdhëri i parë.

Për të fjetur ra në një kohë me ushtarët.

## NJË LETËR

Të dielën e parë, pas marrjes së detyrës, pjesën  
më të madhe të ditës Filua e kaloi midis ushtarëve.  
Jeta kolektive po e tërhiqte. Kur ndodhej me ushta-  
rët, e ndjente veten më të lehtësuar. Po megjith-  
atë shpejt u largua nga fusha e aktiviteteve dhe  
nuk u duk tërë pasditen. Ushtarët s'e dinin hallin  
e tij, ku i rrihte çekani...

Çdo gjë e kishte menduar që më përpara, pran-  
daj s'i mbetej gjë tjetër veçse të fillonte të shkru-  
ante. Dhe filloi. Por, pa mbaruar rreshtin e parë,  
e la penën mënjanë dhe u krehd përsëri në men-  
dime.

Qëndroi ashtu disa minuta. Edhe një orë mund  
të rrinte, po të mos i thërriste një zë i brendshëm:  
«Ej, mbli dhe veten! Ç'ke që po e humbet? Do t'i bësh  
letër komisarit se e ke vështirë, se mungojnë shu-  
më gjëra, se Jorgua, ai që nuk i ecën «klima», theu  
disiplinën? Mirë, bëne, kush të pengon?! Por... pa  
thellohu pak. Si i kupton ti vështirësitë? A bën të  
ngresh duart para tyre? Jo, djalosh, ki besim në  
veten tënde, ki besim tek vartësit e tu, ecë pa u  
drojtur përpara, përpiqu të ndeshesh, jo t'u biesh  
anës vështirësive, t'i kalosh ato si i ka hije një  
oficeri, të fitosh mbi to, dhe do të fitosh po u mbë-  
shtete tek kolektivi, tek organizata e rinisë. Ne,

komunistët, do të na kesh pranë... Pa pyete njëherë vetëveten! «Vërtet, s'ka kënd sportiv, s'ka dhomë kulture, s'ka bibliotekë, as vegël muzikore, as vend për banjon e ushtarëve, s'ka... Shkurt, shumë gjëra mungojnë e, mbi të gjitha, dje Jorgua ja ktheu nënoficerit para teje. Po ti, Filo, që të kanë dërguar komandant, ç'mund të bësh vetë, me forcat e kolektivit, për këto?..»

Brofi në këmbë. Zëri i ndërgegjes kishte tingëlluar i fortë. Mendoj: Ashtu është. As që jam mënduar gjatë këtyre ditëve se ç'mund të bëj, as që jam kujtuar t'i bëj këto probleme të kolektivit, por vetëm regjistro këtë, regjistro atë dhe... dhe tani dua t'i shkruaj komisarit se: «në këto kushte s'punohet!» Ah, Filo, Filo! Sa përciptë e ke kuptuar detyrën!.. Hej, shoku komandant i kompanisë, pa përvishi njëherë mëngët, pa shtroju punës dhe lëri mënjane këto, se s'të kanë hije, pa qëndro më afër ushtarëve, se ata kanë forca të atilla, sa të bëjnë mrekulli. Edhe ai, Jorgua, ai që i fole aq rëndë, është i zoti të bëjë shumë gjëra, vetëm...

E qortoi rreptë veten. Rrëmbeu nga tryeza penën, fletët dhe desh t'i hidhte tej. Po shpejt u qetësua. U ul e përsëri nisi të shkruajë. Këtë herë e çoi letrën deri në fund. Ajo i drejtohej nënës, vëllezërve në Vlorë...

## KËTË S'DUHEJ TA KISHTE HARRUAR

Kaloi një, dy javë dhe... «Sa ngadalë ecet, sa me vështirësi i kuptojnë mësimet. Jo, s'është punë kjo!» — grindej shpesh me vete. Edhe natën vonë, kur paloste kapakët e rregulloreve para se



të flinte, përsëriste të njëjtën gjë: «Ç'duhet bërë?»

Mëngjez. U dha sinjali për fillimin e stërvitjes. Oficerit i bëri përshtypje diçka, që herët e tjera s'e kishte vënë re. Ndërsa Qerimi nisi nga mësimi, skuadra e Myrtezait qëndronte akoma në kazermë.

— Ç'po ndodh me ju, shoku komandant i skuadrës?

— Ja, sa të nxjerrim mitralozin... U nisëm.

— Pa shikoni orën?

Myrtezai, megjithëse i zënë në faj, pa të keq foli:

— Fundja, s'u bë qameti.

Filos nuk i erdhi mirë, por u përmbajt. Puna ishte se nënoficeri po manifestonte një qëndrim jo të drejtë dhe ky s'qe i rastit. U bind për këtë, sidomos kur ndoqi stërvitjen. Ushtarët nuk e kishin mendjen te shpjegimi i tij, ai ishte i papregatitur. Atëhere oficeri ndërhyri, por ishte vonë. Ushtarët kishin boshllëqe edhe në temat e tjera. Në pushim ai i tha Myrtezait:

— E kuptoni se me një pregatitje të tillë s'mund të dilet para ushtarëve?

— Po! Veçse... — Më tej nuk vazhdoi. Uli kokën i turpëruar. Edhe oficeri nuk e zgjati më. I tha vetëm kaq:

— Qerimi është më i kujdesshëm!

Rasti i këtij nënoficeri e bëri të mendohej thellë, të pyeste veten: Ç'kam bërë unë për ta? Si i kam ndihmuar? Kur mendohej kështu, nxirrte si përfundim se e kishte hequr vëmendjen nga ndihmësit më të afërt të tij, nga ata që drejtonin stërvitjen. Pra, a nuk ishte kjo një nga shkaqet që

pengonte mbarëvajtjen? S'kishte si e kundërshton-  
te këtë konkluzion. Punën me nënoficerat s'duhej  
ta harronte e ta linte pasdore. «Duhet vepruar sa  
s'është vonë!» — tha i vendosur.

## GËZIM NË KOMPANI

Në komandën eprorë ai ishte takuar me sek-  
retarin e organizatës së partisë dhe me shefin e  
shtabit. Me ta bisedoi hollësisht për shumë çështje.  
U kthye në nënrepart plot gëzim. Dhe efektiv,  
ku u mblodh, e vuri re menjëherë gjendjen shpir-  
tërore të komandantit. Në këto raste ata bashko-  
heshin me ndjenjat e tij pa e ditur akoma shka-  
kun, gjallëroheshin si ai.

— Ju menduat se e ndërtoam kot fushën e fut-  
bollit, vendin për veglat e fiskulturës, dhomën e  
vogël të kulturës. Por ja, nesër do të na vijnë to-  
pat, një hekur, një paralele, një raft bashkë me  
disa libra, do të kemi letër për stenda. Kështu, pra,  
mundimi nuk na shkoi kot. Tani nënreparti do të  
marrë një pamje tjetër, do të bëjmë një jetë më  
aktive. Si thoni?

— Poooo!

## «KU JANË?»

Kishte përgatitje për qitje në poligon. Për  
arësye se rregulloi disa dokumenta, u nis pak me  
vonesë. Mori rrugën më të shkurtër. Pjesën më të  
madhe të saj e bëri me vrap. Po kur arriti atje,  
nuk pa asnjë ushtar. Shikoi orën. Duheshin edhe  
dhjetë minuta. «Pse kaq ngadalë?! Ku janë? Kjo



kohë mund të shfrytëzohej këtu, në poligon». E, ndërsa tha kështu, u nis në drejtimin nga do të vinin ushtarët. Sapo kaloi kthesën karshi, u ndodh para një skene të tillë: Qerimi kishte hapur në një vijë kompaninë dhe jepte komandë pas komande, për të rënë barkas, për t'u çuar, për të hapur zjarr në ecje. Oficeri nuk ndërhyri. Këto veprime u kryen deri në poligon. Atje ai pa përsëri orën. Kishin mbërritur pikërisht në kohën e caktuar.

— Ju lumtë! — kaq tha dhe i shikoi nënoficerat dhe ushtarët me një ndjenjë respekti të thellë.

### TREGIM PËR BABANË

E ndjente Filua se duhej bërë edhe diçka.

Po çfarë? Edhe një ditë e ndante nga stërvitja taktike. Ishte përgatitur më së miri. Ja kishte bërë të qartë detyrën secilit e, megjithatë, s'ishte i kënaqur. «Mirë mbledhja e rinisë, ja edhe një bisedë. Vetëm kaq? Jo, duhet edhe diçka tjetër para se të nisemi...» Këto fjalë i përsëriti disa herë, disa herë solli në mend ç'kishte lexuar dhe gërmonte në kujtesë për ndonjë tregim që kishte të bënte me luftën, me... Ndali në vend. Nxori nga xhepi një blok të vogël dhe shënoi: «Tregim për babanë tim». «Po, t'ua tregoj, ashtu siç ma ka treguar nëna. Ajo më ka porositur ta kujtoj, domethënë të marr shembull nga ai, ta kryej detyrën si ai. Bukuri! Këta janë ushtarë si unë dhe u kërkohet ta kryejnë detyrën, ashtu siç ditën ta kryejnë partizanët».

Të gjitha këto i mendoi aty për aty. Duke

shkuar për në klasë takoi sekretarin e organizatës së rinisë dhe dy anëtarë byroje. U tregoi ç'kishte menduar. Mendimi i tij u prit me entuzizëm nga sekretari dhe shokët e byrosë.

Dhe u tregoi ushtarëve historinë që kishte dëgjuar një mbrëmje pranë sobës nga goja e nënës së tij. Ai ua tha ashtu si e pat dëgjuar:

«Atëhere ishe fare i vogël, nëntë muajsh. Nëna të mbante në gji. Mënd më shqyeje gjoksin. Doje të pije.

Dielli akoma s'kishte perënduar, kur shoh disa burra që hynë në fshat. Ata diçka mbanin në sup. Oh, biri im! Të hoqa nga gjiri e të lëshova mbi një rrobë të vjetër. Ti klithe, po unë s'ta vura veshin. Gjëmë më ndillte zemra. Dhe u sula drejt atyre burrave. Ata qëndruan duke më vështruar në heshtje. Nga sytë e tyre kuptova gjithshka: Yt atë nuk rronte më. Atë e mbanin të vdekur ndër duar. Desha të thërrisja, të ulërija, por e mblodha. Sytë e atyre burrave më thonin: «Mbahu, ra siç dinë të bien trimat, në krye të detyrës». U mbajta.

Ju mbetët pa baba disa muaj pas çlirimit. Armiqtë u tërbuan nga fitoret tona. Liria i verboi. Ata që mbetën gjallë, silleshin ferrave si ujç të tërbuar. zinin pusi, vritnin. plaçkitnin. Për lirinë, për luftën e shenjtë yt atë s'i kurseu forcat. E njihja atë, e njihja mirë, ashtu siç mund të njihet njeriu më i afërt i zemrës. Kaluam jetë me brenga, jetë të hidhur. E kjo na njohu më mirë... Ai lëvizte shumë atëhere, sa në një çetë, në tjetrën; ku e zinte mbrëmja, s'gëdhihej, ku dreka, jo darka. Edhe pas fitores s'u kursye... Atë ditë ai u nis që herët në mëngjez, se do të shpinte disa dokumenta



në rreth. Ju puthi të gjithë me avash, se mos zgjoheshit. E pastaj doli, iku... E ndoqa me sy sa më humbi në kthesë, dhe u ktheva pranë jush. Tani s'ja kisha frikën, s'besoja se mund ta humbisja, t'ju linte jetimë. Por... harroja se lufta kundër armiqve s'kishte mbaruar... Ata, tre ballistë, që i kishin lyer duart me gjak gjatë luftës e i fshihe-shin drejtësisë, i dolën në mes të rrugës. Njëri nga ata kishte thënë:

— Ndalo aty, Manxhar! Tani s'na shpëton dot. Na dorëzo ç'ke me vete!

— Jo, kurrë! — ishte përgjigjur yt atë.

Kriminelët u tërbuan, thirrën:

— Bëhu gati të vdesësh, këtej s'kalon i gjallë!  
— Dhe s'e lanë të fliste... E vranë! Ai ra si njeri që e donte fort lirinë, atdheun,artinë, ra në krye të detyrës. Ja çfarë dha ai për detyrën, bir i nënës, jetën... Ju s'mbetët jetimë, jo. Nënë, kaluar nënës, dhe babë u bë partia! Ajo po ju rrit, po ju edukon. Asaj dhe jetën t'i kushtoni, po qe nevoja, kudo që të jini. Mos u kurseni. Manxharin s'e pashë kurrë të lodhur!..»

— Këto më ka treguar nëna, shokë. Këto më frymëzojnë, më japin forcë. Ja pse këtë episod jua tregova sot. Si babai im kanë dhënë jetën me mijëra partizanë. Ata janë ndeshur me armiq të egër e barbarë dhe kurrë s'u trembën, s'u prapsën. Ata luftuan siç dinë të luftojnë trimat.

## NJË ÇAST

Ushtarët qenë rrafshuar përtokë. Zjarri i «armikut» s'të linte të ngrije kokën. Filua ndiqte me

kujdes çdo veprim të vartësve. Në çastin e volitshëm dha sinjalin. Ushtarët u sulën me shpejtësi përpara. Por ja... një kënetë e vogël që shtrihej përpara e ngadalësoi lëvizjen e skuadrës së mesit. Kristaqi mori djathtas e bashkë me të edhe dy të tjerë. Po të ishte luftë, ç'do të ngjiste?

Menjëherë dha urdhër të prapsoheshin veprimet. Nënreparti u rreshtua. Djersë në fytyrë, njolla pluhuri, gërvishje në duart e Kostës. Këtë i zunë sytë. Kostën e nxori para rreshtit.

— Ferra nuk e pengoi të sulmonte. Ai i ra mes për mes asaj... Po nuk u veprua kështu nga të gjithë, s'e kemi kryer detyrën. — Dhe i hodhi sytë kënetës. Edhe ushtarët shikuan andej. Komandanti desh të vazhdonte të fliste, por... «Jo, s'mjaftojnë fjalët, duhet diçka tjetër, mendoj me vete. Në këto e sipër rrëmbeu mitralozin dhe i dha komandë vetes për sulm. E çau kënetën me ujët që i vinte në gju, doli matanë, u shtri barkas e hapi «zjarr». Pastaj u kthye te ushtarët. S'qe nevoja të fliste. Ata e kuptuan...

Në mbrëmje nënreparti u kthye në kazermë. Lodhja s'mundi të frenonte gëzimin e suksesit që shprehej në këngët, të cilat buçitën gjer vonë në garnizonin e vogël ushtarak.

\* \* \*

Rrjedhin muaj, vite, rrjedhin pa u ndalur, të vrullshëm si lumenj malorë. Kështu rrjedh vetë jeta jonë. E njerëzit kaliten në kudhrën e kësaj jete, ndryshohen. Filua flet para moshatarëve, shokëve, kolegëve të tij. Tregon pa i zbukuruar gjërat, ashtu siç kanë ndodhur, si i ndjen. Ai nuk e di se sa



mund të ndikojnë fjalët e tij, sa mund t'u shërbejnë të tierëve ato. Një gjë ka të qartë, e kupton se s'është më ai i ditëve të para.

Kur mbaroi së foluri në një takim me oficerat e rinj, ku ai u tregoi atyre përvojën e fituar, shokët i shtrënguan dorën, e përqafuan. Këto shtrëngime duarsh, përqafime, ai i kishte provuar dhe disa ditë më parë, kur u nda nga ushtarët, nga ata që i deshi dhe e deshën aq shumë, nga ata që i mësoi dhe mësoi prej tyre... Ai u caktua në një detyrë të re, më të rëndësishme. Rruga drejt kallitjes vazhdon. Ajo është e gjatë.

## «ATJE JAM I TEPËRT»

Mori një vendim të prerë: «Do të bisedoj me Xhevatin, të shoh ç'do të më këshillojë ai». Dhe u nis. Ushtar Xhevatin, një shokun e tij të ngushtë, e gjeti pranë planshetit.

— Ke kohë të lirë?

— Po, disa minuta. Ç'e mirë të solli?

Qemali u ul në karrigen pranë.

— Nga parku? — pyeti Xhevati.

— Po!

— Kastile për mua?

— Habitesh? Kam ardhur të këshillohem me ty. E di përse? Po ta them menjëherë...

Qëndruan vetëm pak minuta. Pastaj Qemali doli dhe trokiti në një derë, që ndodhej disa metra më tej. U fut brenda. Këtë herë u ndodh ballë për ballë me komisarin. Ç'është e vërteta, nuk njiheshin. Komisari kishte vetëm pak ditë që kishte ardhur në nënrepart. Por Qemali nuk u drojt nga kjo; ai shkoi me besim tek ai. Komisari e priti ushtarin me buzë në gaz; i tha të ulej dhe t'i tregonte ç'nevojë kishte. E dëgjoji me vëmendje deri në fund.

Qemali, në fillim me drojtje por pastaj i sigurtë në ato që thoshte, i tregoi:



— Ne jemi tre vetë në karroofiginë, veç nën-officerit. Unë jam tornitor dhe axhustator, Sherifi axhustator, ndërsa Fatmiri është shofer dhe tornitor. Kemi kohë që punojmë së bashku, jemi njo-hur e miqësuar njëri me tjetrin. Të them të drejtën, jemi në një vend që ndokush do ta lakmonte. Ne s'para na lag shiu, as era nuk na rreh. Ne nuk e ndjejmë aq shumë lodhjen fizike. Punojmë brenda, pranë tornos, riparojmë ndonjë vegël dhe... Punë në torno kemi pak. Bëjmë bokula, bulona, dado, etj. Meqenëse karroofigina lëviz rrallë, Fatmiri vjen shpesh e punon në torno. Kur një punë e kam unë në dorë, ai rri e më bën sehir. Po kështu ndodh kur fillon ai i pari. Në një rast të tillë, — e theksoj se kjo është pothuaj e vazhdueshme, — çfarë të bëj unë? Në më të shtesë Sherifi të punoj, mirë, s'më la, unë zbres nga maqina dhe shkoj prapa parkut. Atje është një ledh gjithë bar. Shtrihem dhe ngrohem në diell. Këtë e kam bërë nja dy tri herë. Një ditë thashë me vete: «Qemal, s'je në rregull. Si të rrihet, mor djalë, pa punë?..» U ngrita dhe shkova te shokët. Ata kishin mbaruar punë. U them:

— U lodhët?

— Jo dhe aq.

— Kështu do vazhdojmë?

— Për të tre, këtu s'ka front pune, or shokë!  
— tha njëri.

Kaluan dhe disa ditë. E njejta gjendje. Por, ama, ndërgjegja më brente përbrenda. Një zë më thosh: «Njëri nga ju, ti, Qemal, je i tepërt aty. Pse s'kërkon të shkosh në një punë tjetër? Ç'pret?» Dhe ja, shoku komisar, unë, pasi u këshillova me një shokun tim, erdha te ju, t'ju kërkoi të më caktoni në një punë tjetër, ku mund të jap edhe unë

ndihmën time për rritjen e mëtejshme të gatishmërisë së nënrepartit. Atje jam i tepërt...»

Komisari, që kishte një copë herë që e shikonte në heshtje ushtar Qemalin, u ngrit më këmbë, e përqafoi dhe i foli:

— Të lumtë! Ky është një qëndrim revolucionar, një shembull i lartë. Ti, Qemal, edhe ne na ndihmove, na dhe një mësim të mirë, që ta shikojmë më nga afër punën e karrooçinës. Tani mund të shkosh. Kërkesa jote do të plotësohet menjëherë.

Ndërsa Qemali vrapoi për në park me zemër të lehtësuar, komisarri vazhdonte të përsëriste me vete: «I mirë, i ndërgjegjshëm, xhevahir djalë, ky Qemali!..»



## JETË KUFITARE

Është diçka e bukur të shkruash për kufitarët, për jetën e tyre, por jo edhe e lehtë. Ke të bësh me njerëz të thjeshtë, zemërbardhë e, njëkohësisht, të rreptë dhe trima, me njerëz që kryejnë një detyrë heroike. A do të mundemi vallë, të pasqyrojmë qoftë dhe disa aspekte të kësaj jete? Me këto mendime shkelëm në truallin e postës.

## ÇAST SOLEMN

Erdhi dhe nata. Një natë vere, e freskët. Dulja ndez dritat dhe merret me përgatitjen e njisiteve. Në postë filloi lëvizja. Edhe komandanti është i zënë me punë. Herë shfleton një blok, herë i flet dikujt në telefon. Pastaj pyet Dulen:

— Gati?

— Po! Mund të vijmë?

— Menjëherë, është koha!

Dhe, pas këtyre fjalëve oficeri ngrihet më këmbë. Në zyrë, njëri pas tjetrit, hyjnë kufitarët, të veshur me kapota, të armatosur, të pajisur me gjithshka të nevojshme për shërbim. Janë tre nga ata, që i takuam pak më parë: Estrefi, përgjegjës

njësitë, Beluli dhe Izeti. Të tre janë të rinj në moshë. Tani që janë bërë gati për shërbim, fytyrat e tyre kanë diçka më burrërore, në zërin e tyre ndihet një tingull tjetër, më pak melodioz, por më i prerë, më i vendosur. Vështrimi i tyre është më i mprehtë.

Në dhomë dëgjohej zëri i Estrefit:

«Shoku komandant. Njësitë kufitarë i përbërë... është gati për ruajtjen e kufirit shtetëror të Republikës Popullore të Shqipërisë!»

Ky është një çast solemn në kufi. Pas këtij çasti fillon jeta e vërtetë e kufitarit: vështirësitë, sakrificat, fillon prova e madhe për secilin.

Oficeri i kontrollon me radhë, i pyet për instruksionet dhe më së fundi u cakton detyrën e re. Qartë dhe shkurt flet ai. Qartë dhe shkurt përgjigjen kufitarët. Pasi bindet se çdo gjë është kuptuar, komandanti urdhëron njësitin të niset. Pas pak vijnë njësitë të tjera, e tek të gjitha vëren të njejtën ndjenjë, gatishmërinë e lartë për kryerjen e detyrës.

Kalon një kohë fare e shkurtër dhe komandanti merr njoftimin e parë nga njësitet. Ata janë të gjithë në krye të detyrës në sektorët përkatës.

## NJË KËNGË

Koha ecën pa u ndjerë. Së bashku me komandantin dalim përjashta. Nata është e qetë. S'ndihet asnjë lëvizje, asnjë zë. Çdo gjë duket sikur fle, prehet, pas gjithë atij të nxehti të ditës. Por në të vërtetë vetëm në kufi nuk ka prehje, nuk ka



gjumë. Aty heshtja shpesh fsheh shumë ngjarje. Këtë e di mirë oficeri, e dinë të gjithë kufitarët. Po ku janë ata në këto çaste? Ai ngul vështrimin e tij në faqen e një kodre, që zbret deri poshtë në luginë. Të jep përshtypjen sikur vështrimi i tij çan nëpër errësirë, sikur ai i shëh kufitarët. Ata duhen parë e kontrolluar në vend. Dhe ja ku niset qetë-qetë, me automatik në krah.

Të gjithë njësitet i gjeti në rregull, në vendet e tyre. Raportimet e përgjegjësve qenë të shkurtëra, të qarta. Tek Estrefi qëndroi më gjatë, jo se ai i raportoi ndonjë gjë të veçantë, po diç e tërhoqi, diç kapën veshët e tij të stërvitur. Së largu vinin zëra, zëra të kooperativistëve, që vaditnin tokën e përvëluar nga dielli. Pas pak u ndie edhe melodja e një kënge. Diku ja kishte marrë një bari. Njerëzit edhe natën punojnë të qetë, të gëzuar. Ai dhe kufitarët u bëjnë roje këtyre njerëzve, i bëjnë roje punës, gazit të tyre. Dhe ky është burimi i krenarisë së kufitarit.

## «TANI KAM KOHË TË MENDOJ EDHE PËR TË»

Të nesërmen i takuam përsëri kufitarët që ishin në shërbim, Estrefin, Belulin e shumë të tjerë. U përpoqën të mësonin nga Vasili, sekretar i organizatës së rinisë, se çfarë u tregonte të rinjve, që u grumbulluan rreth tij.

— Megjithatë — i thotë ai Vasilit — kishit mundësi të kalonit mbi shkurre, po ju nuk e vutë re mirë rrugën.

U kuptua se ai e kishte fjalën për mjeshtë-

rinë kufitare, për kujdesin në shërbim. Nga goja e tij mësuam, pak më vonë, këtë ngjarje.

«...Ramë të flemë, ose më mirë të pushonim pak. (Neve na qëllon që ta bëjmë gjumin me copa). Atë natë binte shi. Pasi kishin kaluar disa orë u hap me vrull dera e fjetores. Kufitarët, si të ishin të gjithë të zgjuar, nuk pritën asnjë komandë, po u hodhën nga krevatet dhe filluan të vishen. «Alarm!» Në çast hyri komandanti, si gjithnjë i qetë, gjakftohët. Ai priti sa u rreshtuam dhe thërriti emrat e tre vetëve.

— Ju të tjerët qëndroni të gatshëm — tha, dhe doli. Pas tij dolën dhe tre kufitarët me Dulen në krye. Jashtë shiu s'kishte të pushuar. Ishte shumë errët. Pikërisht në një mot të tillë njësitit ju caktua një detyrë e vështirë, dhe ai u nis me të shpejtë për ta kryer atë. Neve të gjithëve na ka qëlluar të kryejmë detyra të vështira, sepse e tillë është vetë jeta në kufi, por rasti i asaj nate ka diçka të veçantë... Siç e shikoni, vendi është i veshur plot shkurre. Edhe ditën vështirë ta dallosh rrugën. Merrni me mend se ç'mund të ndodhë në një natë të errët me shi. Por, a mund të quheshi kufitar, po nuk dite të veprosh në kushte të tilla?.. Kështu, pra, njësitit «humbi» midis shkurreve pa e lajthitur drejtimin që i ishte caktuar. Kishte raste që edhe rrëzoheshin, se u shkisinin këmbët, por asnjë çast nuk u ndalën. Njërit prej tyre, Estrefit, ju mbushën këpucët me ujë dhe filluan ta pengonin. Kufitari s'e bëri të gjatë. Me shpejtësi i hoqi ato nga këmbët dhe filloi të ndjekë shokët. Ecën kështu, thujse me vrap, më shumë se njëzet minuta. Arritën në vendin e caktuar përpara kohës. Dulja, pasi dha udhëzimet e nevoj-



shme për vendosjen e njësitit nëpër pozicione, kontrolloi imtësisht shtegun dhe, si u bind se s'kishte asgjë të dyshimtë, lajmëroi në postë:

— Mirë, kthehuni! — urdhëroi oficeri, pasi e dëgjoi Dulen deri në fund.

— Siurdhëron! — Kaq tha përgjegjësi i njësitit dhe s'kërkoj sqarime. Moti vazhdonte punën e tij dhe kufitarët morën rrugën drejt postës të lagur, të çjerrë nga shkurret. E pse gjithë kjo? Mos ndoshta komandanti desh të provonte gatishmërinë e tyre? Ne gjithnjë jemi syhapur, të gatshëm. Por... Çdo gjë ka një qëllim të caktuar në kufi. Në qoftë se atë natë në vendin që shkuan kufitarët kishte kaluar një kafshë e egër, të nesërmen mund të kalonte një «egërsirë» tjetër, një armik. Pra, veprimet duhen kryer njësoj në çdo rast.

Ata qenë lagur si asnjëherë. Por vëmendjen e shokëve, të komandantit, e tërhoqën këmbët e Estrefit. Ato kullonin gjak.

— Pse i hoqe këpucët? — Këtë pyetje ja bënë të gjithë. Kufitari u përgjigj me thjeshtësi e me buzën në gaz:

— Në kohën që duhej kryer detyra, unë s'mund të mendoja për këmbët. Tani kam kohë të mendoj edhe për to.

## SHTEGU I ZI

Kur komandanti dëgjoi përgjigjen e kufitarit, e pushtoi me mall si djalin e vet. Edhe atë, dikur, kur ishte ushtar si Estrefi, kështu e kishte pushtuar komandanti. Dhe solli në mend një rast, kur ishte

përgjegjës njësitit. Detyrën për mbylljen e një drejtimi, ku dyshohej se mund të kalonin spiunët e UDB-s, ua dha komandanti i postës. Ai i porositi: «kujdes krahun e majtë!» Kjo i habiti. Ata e njihnin vendin, dhe krahun e majtë s'mund të kalohej. Si t'u kishte kuptuar mendimet, komandanti ngulmoi: «Është shteg i rrezikshëm, sidomos për t'u kaluar natën, por, sidoqoftë, kujdes!» Kaluan një natë të ftohtë. Veriu sikur i shponte.

Ishte nata e katërt që merrnin po atë rrugë, zinin po ato vende, ndjenin në trup po atë thëllim. Para se të arrinin afër një shpelle, përgjegjësi i njësitit u bëri shenjë shokëve të afroreshin.

— U lodhët? — Këtë pyetje ua bëri sa për të çelur bisedën, sepse e dinte që edhe të ishin lodhur, nuk do ta shprehnin. Ishin djem që u bënë ballë me guxim vështirësive.

— Ç'ne! — foli njëri prej tyre.

— Ç'mendon, Selo?

— Po ja, të ecim më shpejt se, ndoshta, këtë çast, te shtegu i zi ka nxjerrë kokën ndonjë «ujk» dhe zgjedh rrugën për të kaluar. Kjo mund të ndodhë tani, pas dy orësh, afër mëngjezit, natën tjetër ose pas një jave. Puna është që çarku duhet të jetë gjithmonë i ngrehur. Ja, këto mendoj.

— Po, çarku duhet mbajtur ngrehur...

Aty nga mesi i natës malin e mbuluan retë. Nisi të fryjë. Errësira u shtua. Pritej të binte shi. Vrojtimi po vështirësohej. Përgjegjësi i njësitit u afrua te Selua. Ai i foli me zë të ulët:

— T'i afrohem më pranë shtegut. Ndoshta këtë natë kanë pritur «ujqërit».

S'e bënë të gjatë. Lëvizën me kujdes. Që-



ndruan në një vend nga mund të vrojtonin më mirë. Shtegu i zi dukej më i zi nga ç'kishte emrin. Era s'i linte të dëgjonin. Qëndruan gjatë. Shiu nuk po fillonte, por as retë s'po e lironin malin.

Nasi që ishte nga e djathta e përgjegjësit të njësitit i dha shenjë. Diç i kishin kapur veshët. «Sikur lëvizi një gur» — i tha. Drejtimi, sipas tij, ishte andej, nga faqja e malit. «Po sikur...» Selua nuk e la përgjegjësin e njësitit ta çonte arësytimin deri në fund. E njoftoi se nga Shtegu i zi ishte ngritur një shpes, kishte ndjerë rrahjen e krahëve të tij. Ndoshta ishte thëllëzë. Ato tremben dhe shkaktojnë zhurmë. Me sa kuptohej, spiunët duhej të ishin ndarë në dy grupe, e të dy grupet kishin zgjedhur drejtime të ndryshme. Të kalonte, kush mund të kalonte.

Kufitarët tanë ishin tre, po ata? Pastaj, ga cili krah ishin më shumë? Përgjegjësi i njësitit mori një vendim: urdhëroi Selon të qëndronte aty ku ishte. «Ata s'do të zbresin dot nga shtegu, i tha, ka mundësi të ndjekin këtë drejtim».

Vetë, së bashku me Nasin u zvarritën deri afër shpatit. Ndanë detyrat. Qëndruan në pritje. Gjithshka si më parë: errësirë, erë, mali i mbuluar me re. Me Selon s'mbanin dot lidhje. Ai ishte mjaft larg. Veçse pozicioni ishte i përshtatshëm. Ata mund t'ja mbronin shumë mirë krahët njëri-tjetrit.

Papritur u dëgjuan krisma. Dy granata shpërthyen afër. Përsëri krisma automatiku dhe pushke. Selua po ndeshej. Po ata s'arritën të lëviznin nga vendi. Disa hije po vraponin drejt pozicioneve të tyre. Tani gjithshka u bë e qartë. Armiqtë qëlli-

misht ishin, ndarë në dy grupe. Ata kishin menduar se në kohën kur njëri grup do të ndeshej me njësitin, tjetri do të kalonte pa u diktuar, po s'u doli ashtu. Kufitarët hapën zjarr. Vërvitën granata. Dëgjuan të shara, mallëkime, klithma. Pastaj edhe një breshëri automatiku. Edhe Shtegu i zi gjëmonte. Atë e mbronte Selua. Ata dëgjonin vetëm krisma, s'dinin asgjë tjetër për shokun. Armiqtë që kishin përpara e mblodhën veten dhe hapën zjarr më të dendur. Situata ishte e vështirë. Me sa u kuptua, përpara kishin tre vetë. Po Selua? Sa armiq kishte përpara shoku i tyre?...

Përgjegjësi i njësitit lëvizi nga pozicioni dhe bëri më djathtas. Nuk qëlloi. Vetëm Nasi hapte zjarr me pushkë. Siç duket, armiqtë menduan se ai mbeti vetëm. Gjithë zjarrin e automatikëve e drejtuan kundër tij dhe filluan të sulmojnë. Por derri doli në shteg. Përgjegjësi i njësitit i dallonte mirë hijet. Automatiku e bëri punën e tij. Njëri prej armiqve ra dhe s'u ngrit më. Tjetri bërtiti: «amani, mos!..» I treti i dha një plumb atij që bërtiti dhe s'u pa më.

S'donin t'u besonin veshëve. Ngado ra përnjëherë heshtja. Sikur edhe era s'frynte më. Ku ishte Selua, ç'bënte ai? Përgjegjësi i njësitit i tha Nasit të kishte mendjen te kufomat që ishin disa metra më tej, dhe vetë u nis drejt pozicionit të shokut. Kur u afrua, thërriti:

— Selo, o Selo!

Ndjeu rënkime, por sytë s'i shikonin gjë. Eci dhe disa metra dhe shtangu. Para tij qëndronin të shtrirë dy trupa. Njëri nxirrte një rënkim të thellë. E njohu, ishte Selua. Ai kishte marrë një plagë në



shpatull. Gjaku që rridhte i ngrohu dorën. Zemra ju ngroh, kur pa se ai jetonte.

— Ç'u bë Nasi? — kishte folur kufitari trim. . .

Pas pak minutash, te Shtegu i zi mbërritën shokët dhe komandanti. Selua i tregoi se si njëri nga të dy armiqtë i ishte hedhur përsipër, por s'kishte mundur t'i ngulte thikën, sepse Selua ishte prapsur dhe i kishte zbrazur në gjoks automatikun. Në atë kohë, armiku tjetër kishte hapur zjarr dhe një plumb e kishte marrë Selon në shpatull. Por ishte mbajtur, kishte vërvitur granatën. Pastaj . . . «Më tej s'di ç'u bë», — tha ai, duke përballuar dhembjen e plagës.

— Të gjithë ju qëndruat si burrat, si kufitarë trima! — kishte folur komandanti. — Ju e kryet detyrën siç ju ka hije. Asnjëri nga armiqtë s'mundi të kalojë. Tre prej tyre po hanë dhé. . .

Ndërkohë komandanti i kishte pushtuar me radhë kufitarët. Përgjegjësi i njësitit s'e harroi kurrë atë shtrëngim në gjoksin e komandantit, bile as tani që është bërë vetë komandant. . .

Në orën e caktuar kufitarët u rreshtuan dhe komandanti filloi mësimin.

Nisën veprimet praktike në terren. Tani mund të provosh njohuritë, mjeshtërinë e kufitarëve, zgjurësinë e mprehtësinë e tyre. Pika e vrojtimit duhet kapur në mënyrë të maskuar, në fshehtësi.

Oficeri cakton njësitin që do të veprojë. Atë e udhëheq Vasili.

— Jepni detyrat! — thotë oficeri. — Ju, të tjerët, dëgjoni, në fund bëni vërejtje. Vasili është i sigurtë për atë që thotë, i vendosur në vetë-

vete. Dhe këtë nuk e arriti sot. Mjeshtëria kufitare s'fitohet në një ditë apo dy, por me një punë këmbëngulëse e të vazhdueshme. Dhe nuk është vetëm Vasili që bën përpjekje të tilla. Ja, le të ndjekim për disa çaste Pjetrin, që mori komandën e njësitit. Ai është nga Dukagjini. Truplartë, shpatullgjerë. Në tiparet e tij duket diçka si e gdhendur me dorë, si e skalitur, në sytë e tij duken tiparet e një malësori krenar, të zgjuar, të shkathët.

Pjetri ka zënë vend pas një shkurreje dhe vrojton me kujdes rrugën që do të përshkojë. Përpara ka një rrëke të vogël. Kufitari, që lëviz pranë tij, i afrohet atij vendi dhe ndalon. S' di ç'të bëjë. Kjo tregon se nuk e ka zgjedhur rrugën që më parë. Pjetri jep sinjalin të ndërpriten veprimet. Kufitarët fillojnë diskutimet. Oficeri dëgjon dhe vetëm në fund ndërhyt.

— Po, rruga e kalimit duhej caktuar aty, ku ka zënë vend Pjetri. Afrohuni... Shikoni se ç'pamje. Tani shkojmë te vendi ku ishte kufitar Çaça. Shtrihuni barkas! Ashtu! Çfarë ju del përpara?... Majat e mareve e asgjë tjetër, apo jo? Për të gjetur drejtimin, duhet të çohesh. Por një veprim i tillë do të thotë të zbulosh veten, njësitin, do të thotë të rrezikohesh. Prandaj Pjetri veproi drejt kur e zgjodhi vrojtimin disa metra më tej.

Dhe kështu, duke u ndalur në çdo hap, duke kritikuar këtë ose atë veprim të gabuar, duke u përpjekur të shfrytëzohet terreni, u zu pika e vrojtimit. Atë ditë, njohurive të tyre, mjeshtërisë kufitare, ju shtuan dhe shumë dije të tjera.



## KUFITARËT E VEGJËL

Pranë postës është dhe një ndërtesë tjetër, ku rrinë familjet e oficerëve. Të gjithë atje e quajnë veten kufitarë, pjesëtarë të kolektivit të postës. Edhe Nesheti, Lirimi apo Salija e vogël, tre fëmijët e oficerit e heqin veten kufitarë. Ata, tani që shkollat janë mbyllur, në çdo çast i gjen me kufitarët, gjithnjë në postë, duke imituar veprimet e tyre. Ata shpesh u luten kufitarëve t'u tregojnë episode, të prekin ose të hedhin në krahë pushkët e tyre.

Në këto çaste ata po luanin në oborr. Nesheti, si më i madhi, ishte vënë në rolin e përgjegjësit të «njësitit». Në kohën që Salija u bë gati të njoftonte të vëllanë se «diçka kishte zbuluar në vijën e kufirit», i vanë sytë tek porta e hyrjes.

— Erdhi, erdhi! — bërtiti ajo duke përplasur duart dhe u lëshua si flutur. Të dy vëllezërit, që u hutuan një çast, u bashkuan me gëzimin e së motrës dhe ja nisën vrapit duke thirrur:

— Erdhi Zeneli, erdhi Zeneli!

Ata ju varën në qafë kufitarit që kthehej nga leja. Ai i ngriti peshë. Po nuk i mbajti gjatë sepse, sakaq, veç Salijes, dy djemtë u larguan. Kufitarët që ktheheshin nga stërvitja, i dëgjuan qartë thirrjet e tyre:

— U kthye Zeneli!

Kështu ndodh gjithmonë kur kthehet ndonjëri nga leja. Postën e mbuloi një gëzim i përgjithshëm. Këtë ndjenjë e ka shprehur bukur dukagjinasi, ose poeti i postës, siç e quajnë Pjetrin.

— Na kena një zemër, prandaj duhemi kaq fort!

## SHOKËT

Kishin kaluar muaj nga dita e marrjes së zotimeve, për ta bërë baterinë shembullore. Oficer Zeneli vërente me kënaqësi, se ushtarët punonin me këmbëngulje për të mbajtur fjalën e dhënë. Kjo e gëzonte. Por, gjatë ditëve plot tension kishte raste që qetësohej. Ai ishte i bindur se tani ata të stacionit do ta kapnin shenjën në kohë. Po sidoqoftë provën konkrete e priste me padurim. Ajo fitore do të tregonte se sa përpara kishte ecur kolektivi.

Ngjarjet e disa muajve më parë nuk i ndahehin nga përfytyrimi. Ç'kishte ndodhur atëhere?

Në bateri u dha sinjali i gatishmërisë luftarake. Njëri pas tjetrit, komandantët e topave, të aparateve, raportonin: «Gati!» Pas disa minutash filloi drejtimi i zjarrit me shenja reale. Gjithë vëmendja e komandantit të baterisë u përqëndrua në një drejtim: te stacioni.

Duke pritur raportimet, ashtu siç ishte ulur ju kujtua se kështu kishte ndodhur edhe atëhere. Ishte dhënë sinjali, ishte raportuar gatishmëria dhe kishte nisur drejtimi i zjarrit. Herë pas here nga komanda eprore pyesnin:

— E kapët shenjën?

— Jo! — kjo përgjigje ishte përsëritur kushedi



sa herë, dhe Zenelit i bëhej sikur po i merrnin flakë veshët, fytyra. Më së fundi u komunikuan të dhëna të reja. Ndoshta këtë herë do t'ja arrinin qëllimit.

— E kapët? — këto fjalë ja preu fillin e mendimeve si me sëpatë. U përgjigj:

— Jo!

Stacioni përsëri nuk e kishte kapur shenjën. Bateria ra në një gjendje të vështirë, bile të turpshme.

Që atë pasdite u mbledh efektiv. Oficeri foli, në fillim ngadalë, por pastaj gjithnjë e më rrëmbyer.

Si është e mundur të ndodhë kjo? Hajde, pra, shokë, ta gjykojmë së bashku këtë punë.

Një ushtar tha i drojtur:

— Ç'faj kemi ne, kur s'e kapi shenjën stacioni?

— Po, po, ashtu është! — pëshpëriti një tjetër.

Të gjithë filluan të lëviznin. Shikimet kryqëzoheshin dhe pastaj, si t'i komandonte njeri, ndeshnin mbi Selmanin. Ai s'e ngrinte kokën. E dinte se edhe oficeri për të e kishte fjalën. Si t'ja bënte? Të ngrihej dhe të mbronte veten? Jo! Ishte operator i parë, pra shkaktari që s'u kap shenja ishte ai. Të merrte zotim? Edhe këtë nuk mund ta bënte. Bateria e kishte dëgjuar fjalën e tij. Por, ama, edhe të heshte, s'bënte. Duhej të thonte diçka. Po çfarë?... U ngrit. Shokët i drejtuan sytë nga ai. Selmani tha vetëm këto:

— Po, unë jam fajtori! — dhe u ul.

Pas tij nuk e mori njeri fjalën. Komandanti i

baterisë urdhëroi të vazhdohej zbatimi i orarit të stërvitjes. Vetë qëndroi i mbyllur në zyrë për një kohë të gjatë. Ishte një çështje që duhej zgjidhur. Selmani po bënte disa muaj që kishte ardhur në bateri. Ai ishte një nga nënoficerët më të rregullt. Nga shkolla e instruksionit kishte dalë shkëlqyeshëm. Kjo i kishte gëzuar të gjithë. Bile, kur ai mori zotim në mbledhjen e baterisë lidhur me kushtet për «Bateri shembullore», pati nga ata që e thanë hapur se fjala e tij s'vihej në dyshim. Por ja, pas një muaji dukej sikur fjalët i kishte marrë era. Në fillim komandanti mendoi se shkakun kryesor i kësaj gjendjeje qëndronte në punën e dobët që ishte bërë në bateri për të gjallëruar emulacionin socialist, se format që ishin përdorur për këtë qëllim, siç dukej, nuk kishin ndihmuar aq në edukimin e njerëzve. Megjithatë, ai u bind shpejt se kjo nuk ishte e gjithë, se nuk mjafton ky shikim i përgjithshëm i punës në bateri. Ai akoma nuk kishte në duart e tij një çelës tjetër; shumë të rëndësishëm: s'ishte futur në botën e brendshme, në ndërgjegjen e njerëzve, veçanërisht të Selmanit.

Një pasdite u ndodh vetëm për vetëm me të. «Çudi, thosh duke e këqyrur me kujdes, ku do ta ketë hallin? S'mund të ve në dyshim aftësitë e tij, as vullnetin e tij. Ai e njeh stacionin për bukuri. Praktika, po, i mungon! Po pse, pak ishin pesëmbëdhjetë ditët e stërvitjes që bëri me operatorët e reparatit? Pastaj, edhe stërvitjet që ka bërë në bateri ja rritin stazhin e praktikës. Po atëhere?»

Çështja nuk ishte e thjeshtë. Një bahçevan në lulishten e vet ka qindëra lule. Por, ndërmjet tyre njëra nuk i gjallërohet, nuk i çel. Ai i bën



njëqind shërbime, tregon njëqind kujdesje. Por jo, ajo nuk lulëzon. Më në fund bahçevani e kupton: në fletët e bimës kanë zënë vend mikrobe. Ah, po, një mikrob i rrezikshëm, një mbeturinë e së kaluarës nuk i linte punët të shkonin mirë në stacion.

Ja si u zbulua kjo:

Komandanti ishte në zyrë. Trokitën në derë. Ishte Marku, sekretari i organizatës së rinisë.

— «Ndërmjet një grupi ushtarësh — tha ai — u hap një diskutim interesant. Si shkak u bë Hamiti. «Më mori malli njëherë të kapim shenjën, që, pastaj, ju, topçinjtë ta asgjësoni!» kishte thënë. — Shokët në fillim nuk u dhanë rëndësi këtyre fjalëve, po pastaj njëri tha:

«E, o vëlla, ti më vafsh shëndoshë, se të gjithë cekanët rrahin mbi Selmanin.

«Po të isha unë operator i parë, do binin mbi mua! — u përgjegj Hamiti. U duk sikur kjo bisedë kaq e pat. Por ja, përsëri një tjetër:

«Ti, Hamit, mos e hiq veten të larë, se fundi edhe mua që jam prurës më skuqet faqja kur ju s'e kapni shenjën!

«Ç'do të thuash me këtë?» u nxeh operatori.

«Në qoftë se ti e kupton se ku çalon puna, pse nuk e ndihmon? A e ke të qartë se këtu s'punojmë: O mete, për vete?»

Hamiti, megjithëse nga natyra është i qetë, foli rrëmbyer:

«Ai është nënoficer, operator i parë... Unë nuk mund t'i dal përpara... Kjo do të ishte një sjellje jo e mirë nga ana ime».

Diskutimi vazhdoi gjatë. Unë s'pç i them të

tëra, pasi thelbi për mendimin tim është ky: midis operatorit të parë dhe operatorit të dytë mungon bashkëpunimi reciprok, ndihma reciproke shoqërore. I pari nuk do ta ulë hundën, ndërsa i dyti pret që ta thërresin për ndihmë. Në qoftë se do të kishte mundësi, shoku komandant, të bënim një bisedë lidhur me ndihmën dhe bashkëpunimin shoqëror. Ç'është e vërteta, ne e kemi ngritur këtë problem, por shumë në përgjithësi. Si ky rast, mendoj se mund të ketë dhe të tjera. Pra, do të ishte në kohë ta bënim këtë. Kjo, jo vetëm do t'u tërheqë vëmendjen njerëzve, por, ajo më kryesorja, do të ndihmojë shumë në rritjen e mëtejshme të gatishmërisë luftarake.

Komandanti e pëlqeu shumë mendimin e sekretarit të organizatës së rinisë dhe ju lut që këtë bisedë ta pregatiste ai vetë. Veç kësaj, së bashku me oficer Nasin, duke diskutuar lidhur me ato që i tha sekretari, arritën në disa konkluzione: Selmani, njeri me vullnet, që e kuptonte se me njohuritë që kishte marrë në shkollë nuk mund t'ja dilte në krye, nuk shtrohej e t'i kërkonte ndihmë ushtar Hamitit. Dukej se kjo vinte nga sedra e tij e sëmurë. Dhe kjo sëmundje duhej mjekuar. Po me ushtar Hamitin, si qëndronte puna? Në qoftë se tek i pari ishte sedra e sëmurë, në ndërgjegjen e tjetrit kishte, si të thuash, një dozë egoizmi, që nuk e lejonte të shikonte (para së gjithash) interesin e kolektivit, të baterisë. Ai mbyllej me «unin» e tij, pa menduar thellë se një qëndrim i tillë çonte në uljen e rezultateve të stërvitjes së baterisë. Gjithashtu ata arritën dhe në një konkluzion tjetër të rëndësishëm: para së gjithash, duhej bërë punë



e përditshme, e diferencuar edukative me njerëzit.

Këto konkluzione u dhanë mundësi oficerëve, kolektivit, organizatës së rinisë të merrnin masa për të rritur nivelin e punës ideologjike, për të rritur ndërgjegjen e njerëzve nëpërmjet luftës kundër mbeturinave të huaja, kundër koncepteve që pengonin mbarëvajtjen e punës.

Dhe kështu nisi zgjidhja. Pas një pune të kujdesshme individuale, Selmani nuk vuan më nga mendjemadhësia, por e vlerëson dhe e dëgjon fjalën e shokut. Hamiti, nga ana tjetër, çdo ditë e më shumë nisi të kuptojë se, duke i vënë dijet e tij në shërbim të shokëve, ai i shërbente atdheut. Midis komandantit e vartësit u forcua shoqëria. Asnjë nuk kish vënë re të Hamiti shenja të egoizmit e mendjemadhësisë. Shoqëria me nënoficerin e bëri më të kujdesshëm në çdo veprim.

Këto përfytyronte komandanti atë mëngjez, kur do të jepej prova e re e baterisë. «Nuk do të përsëritet e kaluara», mendonte ai me buzën në gaz dhe plot bindje. Dhe kjo bindje kishte baza të shëndosha. Selmani, duke e patur çdo ditë në krah Hamitin, kishte filluar jo vetëm t'i dallonte shenjat, por edhe t'i shoqëronte për bukuri. Sidoqoftë, ai priste çastin e provës. «Dua t'u tregoj të tjerëve! — i fliste ai Hamitit, — se ajo kohë, kur ne i qëndronim ftohët njëri-tjetrit ka kaluar».

Dhe prova erdhi. Selmani dhe Hamiti i zbuluan dhe i shoqëruan të gjitha shenjat... Ata janë shokë të vërtetë dhe të tillë u bënë midis kolektivit.

## TAKTI

Me Ezanin, komandantin e baterisë ne biseduam gjatë. Ja ç'na tregoi ai në mënyrë të përmbledhur:

...Kisha disa orë që punoja në zyrë për të përgatitur dokumentat e stërvitjes taktike, që do të zhvilloja ato ditë me baterinë. Pra, gjithë vëmendjen e kisha aty dhe nuk ndjeja lodhje. Por, pasi përfundova punën në hartë dhe nisa diçka tjetër, dikush trokiti në derë. Ishte Safeti.

— Si është puna? — e pyes.

— Shoku komandant, ushtar Tajari përsëri!..

Sapo zuri në gojë emrin e ushtarit, mendova: «E mbushi kupën dhe ky Tajari. Po, po, e mbushi!» U ngrita më këmbë. Safeti akoma nuk kishte mbaruar së foluri.

«Do ta ndëshkoj!» — thashë me vete. Gjaku më hipi në kokë. Por, s'di se si, në ato çaste m'u kujtua se dikush më kishte thënë që, nëraste të tilla, është më mirë të numërosh deri në dhjetë, ose, po që nevoja, edhe deri në njëqind e pastaj të vendosësh. Ndeza një cigare, e hoqa dy-tri herë dhe foli me vete. «Domethënë Tajari akoma s'na ka kuptuar?»



— Nuk durohet më, shoku komandant! — tha Safeti, pa e ditur se ç'mendoja.

— Pse?

— Po ja, është i vetmi në tërë baterinë që...

— Këtu qëndron puna — e ndërpreva. — E kemi pyetur ndonjëherë veten a është e mjaftueshme ajo që kemi bërë?

Ai mblodhi supet dhe nisi të më numëronte sa herë kishte biseduar me të, sa herë e kishte nxjerrë para gjithë shokëve apo e kishin kritikuar në organizatë. Tajarin e kishte thirrur edhe byroja e rinisë.

— E, megjithatë, ai s'ka ndryshuar! — thashë unë.

— Jo! — shoku komandant.

— Pse ndodh kjo?

— Jo vetëm unë, por të gjithë habiten me atë njeri! — m'u përgjigj.

— Mos ndoshta edhe ai habitet me ne të gjithë, se?!

— S'ka se si! — foli me të drojtur Safeti.

— Mirë — i thashë, — po të pyes: Pse e theu disiplinën sot?

— U justifikua duke thënë se është i sëmurë!

— A nuk ndodh kjo?

— Po. Veçse këtë ai e ka në majë të gjuhës.

— Kini shkuar së bashku te mjeku?

— Jo!

— E kini pyetur nga se vuan?

— Njëherë ankohet për barkun, njëherë për kokën... Ee, është i vetmi për justifikime ai!..

E kuptova se, megjithëse edhe vetë isha

marrë disa herë me atë ushtar, nuk kisha mundur të bëja atë që kërkohet nga një komandant, nga një komunist, për të bindur e edukuar ushtarin. E kuptova se sa e vështirë është t'ja arrish kësaj, sa durim dhe takt duhet...

Mbarova punë vonë. Kur dola nga zyra, baterinë e gjeta të rreshtuar pranë topave. Kontrollova një për një gatishmërinë e teknikës dhe bazën materiale. Mbeta i kënaqur. Ushtarët, si përherë, kishin punuar mjaft mirë. Kur dhashë urdhër për pushim, shumë ushtarë u mblodhën rreth meje. Nisi kështu një bisedë e ngrohtë. Më ra në sy se aty ishte edhe Tajari. Kjo ndodhte rrallë. Ai nuk e hapi asnjëherë gojën, veçse dëgjonte të tjerët dhe qeshte. «Diçka e mundon» — thashë me vete dhe u përpoqa ta ndërroja temën e bisedës.

— I lemë këto. Pa të pyesim Tajarin si e ka synë për qitjet. Se ja, erdhi dita.

Të gjithë i drejtuan shikimet nga ai.

— Unë, për hesapin tim, them se jo keq, — u përgjigj Tajari pa u turbulluar.

— Po pse «për hesapin tënd?» — ja priti dikush.

Ushtari ktheu kokën pas. Një tjetër shqiptoi me zë të lartë:

— Ne e kemi synë pishë, por, ama, për hesap të baterisë!

Kjo e preku shumë Tajarin, dhe ai foli me zjarr:

— Po unë, ku ha bukë?!

Unë ndërhyra.



— Të gjithë punojmë e derdhim djersë që bateria jonë të jetë gjithnjë e gatshme, vigjilente, të meritojë vendin e nderit në njësi.

— S'do mend ajo — nisi të flasë Tajari me rrëmbim, — por ka disa që hiqen sikur vetëm ata punojnë për «hesap të baterisë...»

— Po, e pamë sot sa bukur punove ti, — ja priti një nga të skuadrës së tij.

...Biseda vazhdoi gjatë. Të them të drejtën, aty mësova një gjë interesante, që kishte lidhje me karakterin e Tajarit. Mësova, si të thuash, «sëmundjen» e tij. Cila ishte kjo? Që në përgjigjen që i dha shokut vura re se ai prekej shumë shpejt në sedër, qoftë edhe kur kishte faj. Çdo fjalë që prekte personin e tij nuk e duronte dot. Kjo e bënte që shpeshherë të grindej për hiç gjë me ndonjë shok, t'u kundërshtonte ep-rorëve e të shkiste në gabime. Por, nga ana tjetër, edhe shokët nuk e mbanin afër, ta këshillonin që të mos binte në gabime. Kështu kishte ndodhur edhe atë ditë. Safeti, duke mos u thelluar, pasi i kishte caktuar detyrën që do të kryente së bashku me shokët, kishte shtuar:

— Shiko, se, po nuk të gjeta aty!..

— Ç'do të ngjasë? — ja kishte kthyer Tajari i nxehur.

— Nisu! — e pat urdhëruar Safeti.

Kur të tjerët u larguan, unë qëndrova të bisedoja me të. Nuk do t'ju tregoj se ç'më tha e ç'i thashë, se do të jetë e tepërt, po ama unë e ndryshova gjuhën. Ja si është puna: Më kishte qëlluar shpesh ta thërrisja në zyrë. Por gjithmonë filloja me rregulloren, bile i lexoja paragrafë të tërë prej

saj. Pasi mbaroja këtë punë, e pyesja: «Je i qartë, ushtar Tajari?» Ai më përgjigjej: «Po!» «Pse vepron atëhere në kundërshtim me rregulloren?»... Kështu fillonte një dialog, të cilin ai kushedi sa herë e kishte bërë edhe me Safetin. Në fund i thoshja: «Vëri gishtin kokës e merr shembull nga shokët! Me rregulloret s'bëhet shaka!» Ai largohej, po unë në ndërgjegje nuk isha i qetë: «A e binda!?!», thoja me vete. Por, megjithatë u desh një kohë e gjatë që unë të kuptoja se si duhej vepruar me të.

Edhe atë ditë ja kujtova rregulloret, por pasi e dëgjova atë deri në fund, pasi më tregoi vetë, pa ja zënë unë në gojë se ç'i kishte ndodhur me nënoficerin, pasi e binda se shokët, edhe pse e kritikojnë, i duan të mirën. Këtë herë, pasi u ndava prej tij, thashë me vete: «Po, ai ka forca. Tajari do të radhitet me shokët!..»

Të nesërmen, në stërvitjen taktike gjeta rastin të ndiqja nga afër veprimet e tij praktike si shenjues. Bile, gjatë një varianti në kapjen e shenjës ai raportoi i pari.

— Shumë mirë, Tajar! — i thashë.

Vura re se këto fjalë i bënë një përshtypje të madhe. M'u duk sikur në ato çaste thoshte: «Po, për llogari të baterisë punoj dhe unë!»

Ishte natë. Të gjithë ushtarët punonin me shpejtësi për hapjen e pozicioneve. Së bashku me një nga oficerët e baterisë kaluam për kontroll, sa në një pozicion, në tjetrin. Kur ju afroam Tajarit, ushtarët nuk na vunë re. Ata punonin në heshtje. Qëndruam. Pas disa çastesh, dëgjuam njërin që thosh:



— Ulu, ore ulu, një minutë, shiko si je bërë, tërë djersë!

— Bah, ç'flet kështu, po pozicioni?

— Ama dhe ti, Tajar, ke një kokë që!...

— Hajde, lëre kokën time ti, po jepi kazmës! Dikush qeshi.

— Kështu si e ka filluar Tajari, do t'i lajmë hallet shpejt me pozicionin.

— E po ç'ti bësh. Ai duhet të plotësojë të prapambeturat, u dëgjua zëri i parë.

Tajari s'foli. Unë e mora me mend se sa shumë i rënduan atij këto fjalë. Por, diç duket, me heshtjen e tij e bëri shokun që të mos fliste më. U larguam që të mos u ndalnim hovin e punës. Pas gjysmë ore, i pari raportoi për hapjen e pozicionit nënoficer Safeti. Ai në fund të stërvitjes, ndër emrat e të dalluarve kishte shënuar edhe emrin e Tajarit.

Kur bëra konkluzionin e stërvitjes, e falënderova. E pashë se si u skuq në fytyrë dhe uli kokën. «Sot, thashë, ai po e ndjen veten më ngushtë se çdo herë tjetër, ndoshta sepse nuk e priste këtë».

Prej asaj dite, jo vetëm unë, por edhe gjithë shokët e tij e mbajtën më afër, e ndihmuan shumë. Kur erdhi dita e qitjeve, atij nuk ju tremb syri si shenjues. Pasi e mbaroi atë me sukses, gjeti rastin e më tha:

— Ju kam kuptuar plotësisht, shoku komandant!..

Këto më tregoi Ezani, një mbrëmje kur ai sapo ishte kthyer nga stërvitja. Ndjehej i gëzuar dhe krenohej për vartësit që komandonte.

## PASQYRA E LËNDËS:

Rritja .....	3
Kënga e këputur... ..	59
Përmes shënjestrës e frengjisë .....	66
Vajzat e kompanisë .....	73
Ushtari dhe pushka .....	78
Komisari, shtëpia dhe detarët .....	82
Takim me veteranin .....	88
Shtigjeve partizane .....	99
Drej tkalitjes .....	135
Atje jam i tepërt .....	146
Jetë kufitare .....	149
Shokët .....	160
Takti .....	166